

IX 9Marks SERIA "SI TË NDËRTOJMË KISHA TË SHËNDETSHME"

DISIPLINA E KISHËS

SI
E RUAN KISHA
EMRIN
E JEZUSIT

JONATHAN LEEMAN

“Leeman nxjerr në pah rrobat e pista të jetës sonë dhe flet se si t'i pastrojmë. Ai futet në fushën e vështirë të zbatimit baritor, e cila me siguri ngjall diskutime të mira, por në mënyrë të përsëritur ky libër më bind edhe më shumë. Nuk mund të mos përfitoni nga ky libër. I shkurtër dhe biblik, plot urtësi dhe praktik - ky është libri që kemi kërkuar e pritur mbi disiplinën e kishës”.

Mark Dever, Pastor kryesor, Capitol Hill Baptist Church, Washington DC

“Shumë pak libra mbi disiplinën e kishës, të cilët janë të bazuar te Bibla dhe kanë ndjeshmëri të lartë baritore, vijnë në shtyp sot. Nuk di të ketë ndonjë libër që është kaq i saktë nga ana ekzegjetike, që ka lidhje të natyrshme me praktikën dhe është i mbushur me raste studimore të jetës reale se si duhet të merren kishat me një shumëllojshmëri të gjerë situatash të zakonshme. Mbi të gjitha këto, Leeman sjell dobi me këtë libër të përmbledhur dhe jashtëzakonisht të qartë. Shumë i rekomanduar!”

Craig Blomberg, Profesor i Dhiatës së Re, Denver Seminary

“Ky libër është një vepër teologjike e jashtëzakonshme, e pashoqe në llojin e vet. Leeman ka treguar se disiplina e kishës është një dimension thelbësor i procesit të bërjes së dishepujve dhe, si e tillë, një rrjedhojë e natyrshme e vetë predikimit të ungjillit. Ai tregon se përqendrimi ynë tepër i ngushtë te ‘numri i vendimeve’ mund të na pengojë rëndë në udhëheqjen e njerëzve drejt pendimit që çon në jetë. Unë besoj se kjo do të jetë vepra përcaktuese mbi disiplinën e kishës dhe pleqtë tanë po planifikojnë ta përdorin si udhërrëfyesin tonë”.

J. D. Greear, Pastor kryesor, The Summit Church, Durham, North Carolina

“Një nga aktivitetet më të shpërfillura në kishë sot është shërbesa e disiplinës kishtarë, e duhet të bëhet me dashuri dhe guxim, por është edhe shpenguese. Ky libër paraqet një vizion të qartë dhe udhëzime praktike për këtë aspekt jetësor të jetës së bashku në trupin e Krishtit. Unë kam parë vetë shumë njerëz të çliruar nga mëkati robërues me ndihmën e kishave që i kanë zbatuar këto parime, dhe lutem që gjithnjë e më shumë kisha do t'i përkushtohen sërish kësaj shërbese ripërtëritëse”.

Ken Sande, President, Peacemaker Ministries

“Jonathan Leeman është bërë një lexues i mprehtë i kishës bashkëkohore. Ai ndërthur të vërtetën biblike me këshilla të urta në këtë libër shumë të nevojshëm mbi disiplinën e kishës. Nëse keni pasur frikë nga kjo temë në kishën tuaj, ose nuk jeni të sigurt se si t’i korrigjoni me dashuri shenjtorët mëkatues, ky libër parashtron argumentin biblik dhe këshillat praktike që ju nevojiten për t’ia nisur mbarë. Ky libër do t’jua ndezë imagjinatën, do t’jua ngrejë shpirtin peshë dhe do t’jua ndriçojë rrugën”.

Thabiti Anyabwile, Pastor kryesor, First Baptist Church of Grand Cayman; autor i *Çfarë është anëtar i shëndetshëm i kishës?*

DISIPLINA E KISHËS

9Marks: Seria "Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme"

Redaktuar nga Mark Dever dhe Jonathan Leeman

Deacons: How They Serve and Strengthen the Church, Matt Smethurst

Corporate Worship: How the Church Gathers as God's People, Matt Merker

Prayer: How Praying Together Shapes the Church, John Onwuchekwa

Biblical Theology: How the Church Faithfully Teaches the Gospel, Nick Roark and Robert Cline

Missions: How the Local Church Goes Global, Andy Johnson

Conversion: How God Creates a People, Michael Lawrence

Discipling: How to Help Others Follow Jesus, Mark Dever

Ungjilli: Si e portretizon kisha bukurinë e Krishtit, Ray Ortlund

Expositional Preaching: How We Speak God's Word Today, David R. Helm

Evangelism: How the Whole Church Speaks of Jesus, J. Mack Stiles

Pleqësia e kishës: Si ta baritoni grigjën e Perëndisë si Jezusi, Jeramie Rinne

Sound Doctrine: How a Church Grows in the Love and Holiness of God, Bobby Jamieson

Church Membership: How the World Knows Who Represents Jesus, Jonathan Leeman

Church Discipline: How the Church Protects the Name of Jesus, Jonathan Leeman

SERIA "SI TË NDËRTOJMË KISHA TË SHËNDETSHME"

DISIPLINA E KISHËS



SI
E RUAN KISHA
EMRIN
E JEZUSIT

JONATHAN LEEMAN

Titulli në origjinal:

Church Discipline: How the Church Protects the Name of Jesus

Copyright © 2012 by Jonathan Leeman

Published by Crossway

a publishing ministry of Good News Publishers

Wheaton, Illinois 60187, U.S.A.

This edition published by arrangement
with Crossway.

All rights reserved.

Përkthimi dhe redaktimi i këtij libri në shqip
u mundësua nga Kisha "Guri i Themelit", Shkodër.

Për më shumë materiale të tjera nga qendra "IGNIS",
vizitoni faqen www.dritez.al

Përktheu: Arben Bushgjokaj

Redaktoi: Linda Bushgjokaj

Arti grafik i kopertinës: Dual Identity Inc.

Imazhet e kopertinës: Wayne Brezinka për brezinkadesign.com

Përshtatja e faqesjes në gjuhën shqipe: IGNIS

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla ABS
1991-1994, përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.)

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet,
të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre
elektronike, mekanike, fotokopjimi, incizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër, pa marrë
leje me shkrim nga botuesi.

9Marks ISBN: 979-8-89218-152-5

Shtypur në shtypshkronjën "Vision Printing shpk", Tiranë 2025.

PËRMBAJTJA

Dy fjalë për serinë	9
Parathënie: Rrëfenja e dy ungjijve	11
Parashtrim: Një kornizë për disiplinën	17

PJESA 1: KRIJIMI I NJË KORNIZE

1 Bazat biblike të disiplinës	27
2 Një kornizë e ungjillit për të kuptuar disiplinën	35
3 Kur është e nevojshme disiplina?	47
4 Si e ushtron disiplinën kisha?	67
5 Si ndodh rimëkëmbja?	81

PJESA 2: ZBATIMI I KORNIZËS: RASTE STUDIMORE

6 Kurorëshkelësi	91
7 Ai që ka varësi	95
8 Shkelësi i ligjit që del në lajme	101
9 Kallami i thyer	103
10 Anëtari që mungon	107
11 Një joanëtar që merr pjesë rregullisht dhe është përçarës	111
12 Ai që jep dorëheqje nga anëtarësia për të shmangur disiplinën	117
13 Ai që shpall se është jobesimtar	121
14 Anëtari i familjes	123

PJESA 3: FILLIMI

15	Para se të disiplinoni, mësoni	127
16	Para se të disiplinoni, organizohuni	135
	Përfundim: A jeni gati për të filluar? Lista e gjërave për të cilat pastori duhet të sigurohet.	139
	Shtojca: Gabime që bëjnë pastorët në ushtrimin e disiplinës	141

DY FJALË PËR SERINË

A besoni se është përgjegjësia juaj të ndihmoni në ndërtimin e një kisha të shëndetshme? Nëse jeni të krishterë, ne besojmë se është edhe përgjegjësia juaj.

Jezusi ju urdhëron të bëni dishepuj (Mateu 28:18–20). Juda thotë të ndërtoni veten në besim (Juda 20–21). Pjetri ju thërret të përdorni dhuntitë tuaja për t’u shërbyer të tjerëve (1 Pjetrit 4:10). Pali ju thotë të flitni të vërtetën me dashuri, në mënyrë që kisha juaj të rritet në pjekuri (Efesianëve 4:13, 15). A e dalloni se ku po e marrim këtë ide?

Pavarësisht nëse jeni anëtar ose udhëheqës i kishës, seria e librave *Si të ndërtojmë kishave të shëndetshme* synon t’ju ndihmojë t’i përmbushni këto porosi biblike dhe, si rrjedhojë, të luani rolin tuaj në ndërtimin e një kisha të shëndetshme. Një mënyrë tjetër për ta thënë mund të jetë: “Ne shpresojmë që këto libra do t’ju ndihmojnë të rriteni në dashurinë për kishën tuaj, një dashuri e ngjashme me atë të Jezusit për të.

9Marks planifikon të botojë një libër të shkurtër dhe të lexueshëm për secilën nga ato që ne i quajmë "nëntë shenjat e një kisha të shëndetshme", edhe një tjetër mbi doktrinën e shëndoshë. Kërkoni për libra mbi predikimin shtjellues, teologjinë biblike, ungjillin, kthimin në besim, ungjillëzimin, anëtarësimin në kishë, disiplinën e kishës, dishepullimin, rritjen frymërore dhe udhëheqjen e kishës.

Kishat vendore ekzistojnë për t'ua shfaqur kombeve lavdinë e Perëndisë. Këtë e bëjmë duke i ngulitur sytë tek ungjilli i Jezu Krishtit, duke i besuar atij për shpëtim dhe mandej duke e dashur njëri-tjetrin me shenjtërinë, unitetin dhe dashurinë e vetë Perëndisë. Lutemi që ky libër që po mbani në duar t'ju ndihmojë.

Me shpresë
Mark Dever dhe Jonathan Leeman
Redaktorët e serisë

PARATHËNIE

Rrëfenja e dy ungjijve

Cilit “ungjill” i besoni?

Përgjigjja juaj për këtë pyetje do të ketë një ndikim të drejt-përdrejtë mbi mendimin tuaj për disiplinën e kishës. Prandaj, ia vlen të siguroheni që po flasim për të njëjtin ungjill përpara se të flasim për ndonjë gjë tjetër.

Këtu janë dy versione të ungjillit me ndryshime delikate. I pari ndoshta do të mbyllë çdo bisedë për disiplinën e kishës. I dyti do ta fillojë bisedën.

Ungjilli 1: Perëndia është i shenjtë. Të gjithë kemi mëkatuar, dhe kjo na ka ndarë nga Perëndia. Por Perëndia dërgoi Birin e tij që të vdiste në kryq dhe të ringjallej që ne të gjejmë falje. Kushdo që beson te Jezusi, ka jetë të përjetshme. Ne nuk drejtësohemi nga veprat. Drejtësohemi vetëm prej besimit. Prandaj, ungjilli i thërrret të gjithë njerëzit që “vetëm të besojnë!” Perëndia i dashurisë së pakushtëzuar do t’ju pranojë ashtu siç jeni.

Ungjilli 2: Perëndia është i shenjtë. Të gjithë kemi mëkatuar, dhe kjo na ka ndarë nga Perëndia. Por Perëndia dërgoi Birin e tij që të vdiste në kryq dhe të ringjallej, që ne të gjejmë falje dhe të fillojmë ta ndjekim Birin si Mbret dhe Zot. Kushdo që pendohet dhe beson ka jetë të përjetshme, një jetë që fillon sot dhe shtrihet në përjetësi. Ne nuk drejtësohemi nga veprat. Drejtësohemi vetëm prej besimit, por besimi që vepron nuk është kurrë i

vetëm. Prandaj, ungjilli i thërret të gjithë njerëzit të “pendohen dhe të besojnë”. Perëndia i dashurisë së pakushtëzuar do t’ju pranojë në kundërshtim me atë që meritoni dhe më pas do t’ju aftësojë me fuqinë e Frymës të bëheni të shenjtë dhe të bindur si Biri i tij. Duke ju pajtuar me veten e tij, Perëndia ju pajton edhe me familjen e tij, kishën, dhe ju aftëson ju si populli i tij ta përfaqësoni së bashku karakterin e tij të shenjtë dhe lavdinë e trinisë.

Tani, çfarë po mendoni? Cili nga këta dy ungjij e karakterizon më mirë besimin tuaj tek ajo që Bibla na mëson?

Versioni i parë thekson Krishtin si Shpëtimtar. Versioni i dytë thekson Krishtin si Shpëtimtar dhe Zot.

Versioni i parë tregon për veprën pajtuese e falëse të besëlidhjes së re të Krishtit. Versioni i dytë përfshin edhe këtë, por edhe veprën e ripërtëritjes nga Fryma brenda besëlidhjes së re.

Versioni i parë tregon statusin e ri që kanë të krishterët si fëmijë të Perëndisë. Versioni i dytë përfshin statusin e ri dhe përshtetshmërinë e ri të detyrës që u jepet të krishterëve si qytetarë të mbretërisë së Krishtit.

Versioni i parë tregon për pajtimin e një të krishteri me Krishtin. Versioni i dytë tregon për pajtimin e një të krishteri me Krishtin dhe popullin e Krishtit.

Nëse kuptimi juaj për ungjillin ndalet me versionin e parë, nuk do të keni shumë dobi nga tema e disiplinës së kishës ose nga ky libër. Por nëse përqafon të dytin, atëherë do të bëjmë një bisedë më të gjatë. Përveç se është një mandat i qartë biblik, disiplina e kishës është një bindje që vjen nga versioni i dytë.

Gjithçka e pohuar në versionin e parë është e vërtetë, por ka më shumë se aq. Në vetvete, varianti i parë priret të prodhojë

një besim te hiri që nuk kushton. Unë besoj se varianti i dytë është një tregim më i fortë i ungjillit biblik dhe ka më shumë gjasa të çojë drejt një kuptimi të atij lloj hiri që i fton të krishterët të marrin kryqet e tyre dhe ta ndjekin Jezusin në misionin e shenjtë.

DY PËRGJIGJE NDAJ DISIPLINËS SË KISHËS

Mendimi im është se shumë udhëheqës të kishës gjatë shekullit të kaluar do t'i kishin miratuar elementet shtesë të ungjillit numër 2, të paktën nëse do të plotësonin fletën e përgjigjeve të testit. Por nuk e kanë predikuar këtë gjë nga foltorja. Nuk u kanë thënë këtë gjë zotit dhe zonjës Xhouns kur sollën Xhonin gjashtëvjeçar në zyrën e tyre dhe kërkuan që ai të pagëzohej.

Udhëheqësit e kishës duan t'u qasen të huajve dhe të jashtëmëve, por kjo dëshirë e mirë prodhon një tundim të keq — për ta dobësuar ungjillin, i cili kthehet në diçka përherë e më të dobët. Është mjaft e lehtë të flasësh për hirin, dashurinë e pakushtëzuar dhe besimin te Perëndia. Është e vështirë të flasësh për shenjtërinë e Perëndisë, për Krishtin si sundues të jetës, për një pendim që vjen nga Fryma dhe për realitetin e kishës në besëlidhjen e re. Të gjitha këto gjëra bëhen barrë dhe ngarkesë për një person. Ato prodhojnë nevojën për llogaridhënie. Dhe kur ndërtoni një kishë mbi një ungjill që ka pak kërkesa dhe parashtroon pak përgjegjshmëri, disiplina e kishës thjesht nuk ka kuptim.

Përfytyroni një kishë që është ushqyer me qumështin frymëror «vetëm besoni» dhe «dashuri pa kushte». Mendoni sikur i thoni kësaj kishe se duhet të shqyrtojë shkishërimin e Xhonit të vogël, sepse ai nuk është më gjashtë vjeç, por

tashmë është njëzet vjeç, dhe nuk e ka shkelur derën e një ndërtese kishe që nga mbarimi i shkollës së mesme dy vjet më parë. Jo vetëm që do ta hutoni atë kishë, por do të kundërshtoni kuptimin e tyre për krishterimin. Do të ishte sikur t'i vish ndonjërit me makinë përballë në krahun e gabuar.

“Ju jeni gjykues”.

“Pse një Zot që të do pa kushte do ta disiplinonte dikë?”

“Kjo tingëllon si legalizëm. Ne jemi shpëtuar nga besimi, jo nga veprat!”

“Një herë të shpëtuar, përgjithmonë të shpëtuar.”

Me fjalë të tjera, do t'ju vënë përpara e do t'ju shtypin.

Por, tani, përfytyroni një kishë tjetër udhëheqësit e së cilës u kanë mësuar anëtarëve ungjillin duke përdorur të gjithë këshillën e Perëndisë. Këtyre anëtarëve u është kërkuar t'i bëjnë mirë llogaritë se ç'do të thotë të ndjekësh Jezusin që përpara se të bënin një shpallje të besimit. Ata kanë dëgjuar se mbretëria e qiejve u përket skamësve në Frymë, të pastërve në zemër, paqebërësve (Mateu 5:4–9). Ata kanë dëgjuar se Ati qiellor do të presë prej hardhisë së Krishtit çdo degë e cila nuk jep fryt, sepse ungjilli i vërtetë i ndryshon njerëzit (Gjoni 15:2). Ata kanë dëgjuar për ndryshimin midis pikëllimit sipas kësaj bote dhe pikëllimit prej Perëndisë: i pari duket sikur ndjen keqardhje për veten, kurse tjetri duket si dëshirë e zjarhtë, gatishmëri, indinjatë, frikë, mall dhe zell (2 Korintasve 7:10–11).

Kisha e llojit të dytë ka më shumë gjasa të kuptojë se Perëndia Bir vërtet i bashkon njerëzit me veten e tij dhe me familjen e tij për jetë dhe rritje. Ajo do të kuptojë se Perëndia Frymë krijon vërtet një ekzistencë krejtësisht të re brenda

njerëzve. Do të kuptojë se të krishterët e vërtetë ndryshojnë. Tregojuni këtyre anëtarëve se Xhoni njëzet vjeçar ka mundur për dy vjet. Ata nuk do të ngrenë supet dhe nuk do të psherëtitjnë, “Një herë i shpëtuar, përgjithmonë i shpëtuar” dhe të vazhdojnë me këndimin e këngëve lavdëruese. Do ta marrin në telefon dhe do të përpiqen ta gjejnë Xhonin. Do ta ftojnë për drekë dhe do të kuptojnë se si është. Ata do t’i kërkojnë llogari për shpalljen që ka bërë se është i krishterë. Madje, si një përpjekje e fundit për ta ndihmuar, mund ta shkishërojnë atë. E duan aq shumë, sa që nuk mund të mos e bëjnë këtë gjë. I duan aq shumë edhe miqtë dhe kolegët e tij jo të krishterë, sa që nuk mund të mos e bëjnë këtë gjë.

KRIPË DHE DRITE

Është Fjala e Perëndisë që u jep jetë të vdekurve frymërisht, por Perëndia do që Fjala e tij të jetë themeli i jetëve që ndryshojnë. Jetët që ndryshojnë e bëjnë dëshminë e një kishe të gjallë dhe nxitëse. Bota nuk ka nevojë për një hije të krishterizuar të vetvetes. Ajo ka nevojë për diçka plot dritë dhe shije, diçka të veçantë e ndryshe.

“Ju jeni kripa e tokës; por në qoftë se kripa bëhet e amësht, me se mund ta rifitojë shijen? Nuk vlen për asgjë, veçse për t’u hedhur dhe ta shkelin njerëzit.

Ju jeni drita e botës; një qytet i ngritur në majë të malit nuk mund të fshihet. Po ashtu nuk ndizet një qiri për ta vënë nën babunë, por për ta vënë mbi shandan, dhe t’u bëjë dritë të gjithë atyre që janë në shtëpi. Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej”. (Mateu 5:13–16)

PARATHËNIE

Kripa është e dobishme, sepse është e dallueshme, është ndryshe. Drita është tërheqëse për ata që qëndrojnë në errësirë, sepse është . . . jo-errësirë.

PARASHTRIM

Një kornizë për disiplinën

Qëllimi kryesor i këtij libri nuk është t'ju bindë për disiplinën e kishës. Qëllimi është për të ndihmuar ata që janë tashmë të bindur të dinë se si dhe kur ta ushtrojnë atë. Në këtë rrjedhë mendimi, është e rëndësishme të shohim se si ungjilli i Jezus Krishtit na jep një kornizë teologjike për t'iu qasur disiplinës kishtare. Disiplina e kishës, si formuese ashtu edhe korrigjuese, është një rrjedhojë dhe një zbatim i ungjillit. Do ta kuptojmë më mirë se si t'i qasemi praktikisht disiplinës, nëse kalojmë *përmes ungjillit* për të arritur aty.

Kjo do të thotë se qasja ime ndaj temës së disiplinës së kishës është pak më ndryshe nga qasja që kanë ndërmarrë të tjerët. Shkrimtarët që e kanë trajtuar temën e disiplinës kishtare në shekujt e kaluar, ndonjëherë bënin lista nga Bibla se cilat mëkate kërkojnë disiplinë kishë. Ideja ishte t'u jepej udhëheqësve të kishës një udhëzues bazë për të shqyrtuar krizat e tyre baritore.

Veprat mbi disiplinën nga shkrimtarët në kohën tonë zakonisht i udhëzojnë lexuesit për të ndjekur hapat që parashtoi Jezusi te Mateu 18:15–20. Ata shpjegojnë se si t'i qasen mëkatarit më vete, pastaj me dy ose tre të tjerë, pastaj me kishën. Ata u kushtojnë më pak vëmendje llojeve të ndryshme

të mëkatit dhe qasja e zgjeruar e Mateut 18 trajtohet sikur mbulon gjithçka.

Ka shumë për të lavdëruar të dyja këto qasje, por metoda ime është pak më ndryshe. Shpresoj të krijoj një kornizë teologjike që të përgjigjet për shumëllojshmërinë e qasjeve që ndërmarrin vetë autorët e Shkrimeve të Shenjta. Për shembull, Pali ka një qasje të ndryshme të 1 Korintasve 5 prej Jezusit të Mateu 18. Pali thjesht i thotë kishës që ta përjashtojë mëkatarin pa përmendur fillimisht dhënien e një paralajmërimi. Pse? Disa shkrimtarë kanë thënë se kjo ndodh për shkak se mëkati është “turp publik”. Por kjo duket se shkakton që vendimi i kishës se kush i përket mbretërisë së qiejve të varet nga standardet morale të shoqërisë, të cilat janë gjithnjë në ndryshim e sipër, gjë që më duket e çuditshme. A nuk ka një lidhje teologjike midis Mateut 18 dhe 1 Korintasve 5? Unë besoj se ka, dhe e gjejmë atë duke marrë parasysh disiplinën e kishës nën dritën e ungjillit.

Një qasje me kornizë teologjike i ndihmon edhe udhëheqësit të përballen me shumëllojshmërinë e pafundme të rrethanave dhe mëkateve për të cilat nuk ekziston asnjë rast studimor i saktë në Shkrimet e Shenjta — mëkate që nuk shfaqen në asnjë listë. Nëse keni vite si pastor (ose si njeri), e dini se mëkatarët (si ju dhe unë) janë pafundësisht krijues. Njerëzit nuk ndjekin gjithmonë recetat kur gatuajnë mëkatin e tyre; çdo vëllim me pisllek është e bërë nga vetë personi dhe ka shije pak më ndryshe. Prandaj, qëllimi im në pjesën e parë është të krijoj një kornizë teologjike që i ndihmon udhëheqësit e kishës t’u qasën situatave të ndryshme me të cilat përballen.

PYETJE TË VËSHTIRA

Ne, te shërbesa "9Marks", marrim një sërë pyetjesh për disiplinën e kishës nga pastorë që kërkojnë këshilla. Këtu janë disa që kanë ardhur kohët e fundit në postën time elektronike:

- A mund të disiplinoni një joanëtar?
- Çfarë duhet të bëjmë nëse një nga anëtarët tanë e braktis plotësisht besimin dhe nuk e quan veten të krishterë?
- A duhet të pranojë një kishë dorëheqjen e dikujt që është në mëkat dhe vijon i papenduar?
- Pasi kisha shkishëron dikë, çfarë duhet të bëjmë nëse një anëtar tjetër refuzon të shkëputet nga individ i shkishëruar?
- A duhet të hamë në një festë familjare me një pjesëtar të familjes që është nën disiplinë?
- A e dëmton aktin e disiplinës lejimi i një individ të disiplinuar që të vazhdojë të ndjekë shërbesat e kishës?
- Çfarë duhet të bëjmë në lidhje me një joanëtar që merr pjesë për një kohë të gjatë, i cili është përçarës?
- Po një që është anëtar prej kohësh, por nuk merr pjesë kurrë dhe sjell përçarje?
- A është një shkelje disiplinore kur dikush po mendon të martohet me një jo të krishterë?
- A është grykësia shkelje për t'u disiplinuar?
- A janë anoreksia apo bulimia shkelje për t'u disiplinuar?
- A është besimi te Këndvështrimi i Ri për Palin një shkelje për t'u disiplinuar?
- A ka "nivele" të ndryshme discipline? A duhet që një kishë t'i qaset tradhtisë bashkëshortore ku nuk ka pendesë në të njëjtën mënyrë që i qaset mospjesëmarrjes së vazhdueshme?
- A duhet të disiplinohet kisha anëtarët adoleshentë që kryejnë mëkat të rëndë?
- Në cilën pikë është e nevojshme të disiplinohet një pastor? Dhe kush duhet ta udhëheqë atë proces?

PARASHTRIM

- Cilat janë disa udhëzime të posaçme për mënyrën se si anëtarët e kishës duhet të ndërveprojnë me një person që është disiplinuar?
- Me mëkate më të rënda dhe publike, a është e përshtatshme t'i kërkohet dikujt që të rrëfejë mëkatin e tij përpara gjithë kishës si provë e pendimit të tij?
- Kur e mirëpresim përsëri në përbashkësi një individ të shkishëruar? Dhe si?

Vendosja e një kuadri të mirë teologjik ndihmon për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, madje edhe shumë të tjerave.

Pa dyshim, këto pyetje janë të drejtpërdrejta dhe të kufizuara në shtrirjen e tyre. Shpesh, jeta e vërtetë bëhet më e vështirë kur filloni të hiqni shtresat e shumta të mëkatit dhe të rrethanave. Si do të bëhej me njeriun që në mënyrë të vazhdueshme i mashtron klientët e tij me paratë e tyre pa shkelur asnjë ligj, e nëse falimenton, paditet nga ata klientë, dhe thotë se është penduar, por tregon pak interes për të bërë punën e vështirë të kthimit të parave ndaj atyre klientëve, pasi paratë kanë ikur, dhe ai nuk dëshiron t'i kalojë dhjetë vitet e ardhshme të jetës së tij duke bërë sakrifica?

Po ajo nëna e vetme e tre fëmijëve nga tre burra të ndryshëm, të gjithë të lindur jashtë martese, e cila tani është shtatzënë me një fëmijë të katërt nga një burrë tjetër, dhe që shpërthen në lot në zyrën e pastorit? A tregon e qara e saj nëse është vërtet e penduar?

Po i alkoolizuari, i cili për disa muaj është keq dhe për disa muaj është mirë, dhe më pas arrestohet me akuzën e dehjes në publik? A është më i rëndë mëkati nëse ka pasur një sherr me një punonjës policie? Mandej, po sikur incidenti më i fundit të ishte

shkaktuar nga humbja e punës ose sepse gruaja u nda prej tij? A duhet të jemi më të butë?

Ja një situatë për të cilën më pyeti në telefon një plak kishe, të cilin nuk e kam takuar kurrë: gruaja e kishte tradhtuar burrin me një grua tjetër; ai kërkoi divorcin edhe pse ajo donte që martesë të funksiononte. Ai vetë kishte pasur disa lidhje seksuale, si para divorcit ashtu edhe pas, dhe e gjitha kjo po dilte në dritë tani, dy vjet më vonë, në mes të fejesës së këtij burri me vajzën e pas-torit kryesor të kishës. Çfarë do të kishit thënë në lidhje me këtë?

Shpesh, përgjigjja ime më e mirë është: “Nuk ia kam idenë, por do të lutem për ty”.

Përtej kësaj, unë përdor një kornizë teologjike për të vlerësuar një situatë të dhënë. Qëllimi im në pjesën e parë të këtij libri është ta shpjegoj atë kornizë për t’ju ndihmuar t’i qaseni shumëllojshmërisë së situatave që lindin në kishën tuaj.

FEJA E NGURTË KUNDREJT URTËSISË SË UNGJILLIT

Shpesh në jetë, do të ishte mirë të kishim një libër rregullash që ta bënte gjithçka bardhë e zi: “Kur përballeni me këtë, bëni kështu”. Nëse jeni prind ose pastor, pres që ta kuptoni saktësisht se çfarë dua të them.

Të dish se kur dhe si t’i përgjigjesh mëkatit të bashkëbesimtarëve është po aq e vështirë: “A mund të më thotë dikush me siguri nëse tani është koha për t’i thënë diçka Bobit, apo duhet të vazhdoj të kafshoj gjuhën time?”

Feja e ngurtë, në format e saj më gërryese, duket se është e motivuar nga kjo dëshirë për qartësi. Ajo dëshiron ta ketë bardh e zi në vendet ku Bibla është e heshtur. Kërkon siguri aty ku nuk na jepet siguri.

Pse do t'i linte Perëndia gjërat të paqarta? Ndër të tjera, mendimi im është se ai dëshiron që ne t'i thërrasim atij për urtësi, sepse klithma për urtësi kërkon që njerëz të natyrshëm dhe të vetë-mjaftueshëm si ne, të dorëzohen dhe të mbështeten tek ai. Të gjitha ato zona gri në jetë funksionojnë si terrene trajnimi për besim.

Thënë kështu, Fjala e Perëndisë na siguron udhëzimet ose kornizën e gjerë. Detyra jonë është ta kuptojmë atë kornizë dhe më pas ta zbatojmë me ndjeshmëri nga një situatë në tjetrën, duke ecur gjithmonë me besim, duke kërkuar gjithmonë mënyrë. Këtë e përfaqëson pjesa e dytë e këtij libri. Nuk është një libër i praktikës gjyqësore për një fetar të ngurtë: “Kur përballeni me këtë, bëni atë”. Përkundrazi, është përpjekja ime për të treguar se si kuadri bazë mund të zbatohet në lloje të ndryshme skenarësh, në mënyrë që të keni një ide më të mirë se si duket procesi. Vendimet që janë marrë nuk përfaqësojnë “fjalën e fundit”. Ato përfaqësojnë përpjekjet e mia më të mira, ose të pastorëve të tjerë, për të zbatuar urtësinë e ungjillit. Ato gjithashtu më lejojnë të përdor më shumë nuanca të situatës sesa më lejojnë kapitujt e themelimit të parimeve në pjesën e parë.

Ashtu si me disa nga shembujt e mësipërm, i kam krijuar këto “raste studimore” duke përdorur elementë jashtë situatave të jetës reale me të cilat jam përfshirë ose të paktën kam dëgjuar. Në të gjitha këto situata i kam ndryshuar hollësitë në mënyra të ndryshme.

Pjesa e tretë përfundon librin duke paraqitur këshilla për ta udhëhequr kishën tuaj drejt praktikës së disiplinës formale të kishës: çfarë ju nevojitet për të mësuar kishën tuaj dhe cilat struktura nevojitet të krijoni.

A DUHET TË USHTROJMË DISIPLINË?

A duhet që kisha juaj të ushtrojë disiplinë kishtare? Po. Para së gjithash, disiplina e kishës ka dashuri. Kjo tregon

- dashuri për individin, që ai ose ajo të mund të paralajmërohet dhe të pendohet;
- dashuri për kishën, që delet më të dobëta të mbrohen;
- dashuri për botën që vëzhgon, që ajo të mund të shohë fuqinë jetëndryshuese të Krishtit;
- dashuri për Krishtin, që kishat të mund ta mbajnë lart emrin e tij të shenjtë dhe t'i binden atij.

Nga ana tjetër, kur e shmangim disiplinën, bëjmë sikur jemi më të dashur e më të mirë se Perëndia. Në fund të fundit, Perëndia “ndreq atë që do” dhe “fshikullon çdo bir që i pëlqen” (Hebrenjve 12:6).

Ai e di se disiplina jep jetë, rritje dhe shëndet: Perëndia “na ndreq për të mirën tonë që të bëhemi pjesëtarë të shenjtërisë së tij” (Hebrenjve 12:10).

Po, është e dhimbshme, por shpërblehet: “Çdo ndreqje, pra, aty për aty, nuk duket se sjell gëzim, po hidhërim; por më pas u jep një fryt drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të tij” (Hebrenjve 12:11). A mund t’i përfytyroni fushat rrëzëlluese të drejtësisë dhe paqes? Ky është premtimi që Zoti na jep.

Pra, dashuria duhet të motivojë të gjithë disiplinën e një kisha. A keni dashuri? Atëherë, ushtroni disiplinën. Disiplina nuk është një fjalë që kultura e kupton, dhe kalimi nga dashuria te disiplina është diçka që kultura nuk e kupton aspak. Por Bibla këtë na mëson. A mendoni se është e vërtetë?

Më qartë, kishat duhet të ushtrojnë disiplinë sepse:

PARASHTRIM

- është biblike
- është zbatimi i ungjillit
- nxit dhe ruan shëndetin e kishës
- pastron dhe ndriçon dëshminë e kishës përpara të humburve
- i paralajmëron mëkatarët për një gjykim edhe më të madh që do të vijë
- (më e rëndësishmja) mbron emrin e Jezu Krishtit në tokë.

Jezusi ia ka vënë kishës emrin e tij. Ai na e ka besuar emrin e tij neve. E çuditshme, apo jo? Tani, e gjithë çështja nuk qëndron mbi supet tona përfundimisht. Ai ka dëshmuar gjatë jetës së Izraelit në Dhiatën e Vjetër se Ai bën gjithçka që duhet për ta mbrojtur emrin e vet. Megjithatë, ai u ka caktuar kishave tona një punë për të bërë: të kujdesen për emrin e tij përpara kombeve. Duam apo jo, bota do të nxjerrë përfundimet e saj për Krishtin duke u nisur nga ne.

Në thelb, disiplina e kishës synon të japë siguri që përfaqësuesit e Jezusit në tokë ta përfaqësojnë Jezusin dhe jo dikë tjetër.

Nëse keni nevojë për më shumë bindje për të ushtruar disiplinë në kishën tuaj, ju rekomandoj kapitullin 7 të *Nëntë shenjat e një kishe të shëndetshme* nga Mark Dever. Libra të tjerë të mirë mbi këtë temë përfshijnë *The Transforming Community* nga Mark Lutherbach, *Walking Together* nga Wyman Richardson, *Love that Rescues* nga Eric Bargerhuff dhe *Handbook of Church Discipline* nga Jay Adam. Do të gjeni gjithashtu një numër artikujsh më të shkurtër tek www.9Marks.org.

Shpresoj gjithashtu që korniza e përgjithshme e disa kapitujve në vijim të jetë bindëse. Ajo duhet të tregojë një pamje të popullit të Jezusit që ushtrohen e mësojnë të duken si Jezusi, pikërisht në mënyrë që kombet të mrekullohen.

Pjesa 1

KRIJIMI I NJË KORNIZE

BAZAT BIBLIKE TË DISIPLINËS

Çfarë është disiplina e kishës? Me fjalë të përgjithshme, disiplina e kishës është një pjesë e procesit të dishepullimit, pjesa ku korrigjojmë mëkatin dhe e drejtojmë dishepullin drejt shtegut më të mirë. Ndër të tjera, *dishepullimi* është *disiplinë*. Një i krishterë disiplinohet përmes udhëzimeve dhe korrigjimeve, si në një orë matematike ku mësuesi jep mësimin dhe më pas korrigjon gabimet e studentëve.

Pikërisht për këtë arsye, ka pasur një praktikë shekullore të lidhur disiplinën formuese dhe korrigjuese. Disiplina formuese ndihmon në formimin e dishepullit nëpërmjet mësimin. Disiplina korrigjuese ndihmon në korrigjimin e dishepullit nëpërmjet korrigjimit të mëkatit. Ky libër përqendrohet te disiplina korrigjuese, por mësimdhënia dhe korrigjimi gjithmonë ndërveprojnë së bashku. Kjo është natyra e dishepullimit.

Me terma më specifike dhe formalë, disiplina e kishës është akti i heqjes së një individi nga anëtarësia në kishë dhe nga pjesëmarrja në Darkën e Zotit. Nuk është një akt për t'ia ndaluar një individi të marrë pjesë në mbledhjet publike të kishës. Është deklarata publike e kishës se ajo nuk mund të

DISIPLINA E KISHËS

njohë a miratojë më shpalljen e besimit nga ana e personit, dhe as ta quajë atë të krishterë. Është një qëndrim mospranimi për t'i dhënë një personi Darkën e Zotit. Është shkishërim, ose ndryshe, personi bëhet ish-pjesëmarrës.

Për të qenë i qartë, atëherë, do t'i trajtoj këto terma si sinonime: “të shkishërosh” do të thotë “të përjashtosh nga përbashkësia”, që do të thotë “të heqësh dikë nga tryeza e Zotit”, që do të thotë “të disiplinosh zyrtarisht”. Disa njerëz i trajtojnë një ose dy nga këto gjëra si faza të ndryshme në proces; unë jo.

MËSIMI I JEZUSIT MBI DISIPLINËN

Shumë tekste në Dhiatën e Re tregojnë për praktikën e disiplinës kishtarë. Pjesa më e njohur është ndoshta nga Ungjilli i Mateut. Jezusi thotë:

“Por në qoftë se vëllai yt ka mëkatuar kundër teje, shko dhe qortoje vetëm për vetëm; në qoftë se të dëgjon, ti e fitove vëllanë tënd; por në qoftë se nuk të dëgjon, merr me vete edhe një ose dy vetë, që çdo fjalë të vërtetohet nga goja e dy ose tre dëshmitarëve. Nëse pastaj refuzon t'i dëgjojë, thuaja kishës; dhe në qoftë se refuzon edhe ta dëgjojë kishën, le të jetë për ty si pagan ose tagrambledhës” (Mateu 18:15–17).

Duket qartë se Jezusi ka dy shqetësime: së pari, që mëkatari të pendohet; së dyti, që numri i njerëzve të përfshirë të mbetet aq i vogël sa është e nevojshme për të sjellë pendim. Në themel të këtyre shqetësimeve është bindja e thellë se kisha duhet të jetë ndryshe nga bota — të krishterët nuk duhet të jetojnë si paganë apo tagrambledhës. Audienca hebraike e Mateut e kuptonte qartë se fjala “pagan” përfaqësonte ata që ishin jashtë bashkësisë së

besëlidhjes dhe “tagrambledhës” përfaqësonte ata që e kishin tradhtuar bashkësinë e besëlidhjes (dhe për rrjedhojë ishin edhe jashtë bashkësisë). Anëtarët e kishës duhet të jetojnë ndryshe nga bota. Dhe nëse, pas një sërë paralajmërimesh me hir, nuk e bëjnë këtë gjë, një kishë duhet t’i përjashtojë nga përbashkësia e saj.

Mëkati i përshkruar këtu është një mëkat ndër-vetjak: “kundërjush”. Megjithatë, unë besoj se shpesh e mbitheksojmë rëndësinë e kësaj hollësie. Çështja këtu është nëse individi është i penduar dhe nëse duhet trajtuar si vëlla apo motër në Krishtin. Çështja më e madhe në këto vargje është se kishat vendore kanë autoritetin për të vlerësuar rrëfimin e besimit dhe për të vepruar në përputhje me rrethanat: “nëse dy prej jush bien dakord mbi tokë për çdo gjë që kërkojnë” (Mateu 18:19). Me fjalë të tjera, kishat mund ta përdorin procesin e disiplinës kishtarë të përshkruar në vargjet 15 deri në 17 për t’i trajtuar mëkatet më gjerësisht.

Me pak fjalë, Jezusi po thotë që kishat duhet të luajnë një funksion gjyqësor. Ai e nxjerr shprehjen “dy ose tre dëshmitarë” nga Ligji i Përtërirë 19, një pjesë e Shkrimit ku Moisiu parashtroi rregullat e procedurës për gjykimin e çështjeve penale. Kur përballen me njerëz të cilët me buzët e tyre hiqen sikur përfaqësojnë Jezusin, por jetojnë krejt ndryshe, kishat duhet të peshojnë me kujdes provat dhe të japin gjykimin. “A është ky një pohim i vlefshëm i ungjillit? A është ky person një rrëfyes i vërtetë i ungjillit? Çfarë tregojnë provat?”

MËSIMI I APOSTUJVE MBI DISIPLINËN

Edhe Apostulli Pal bën thirrje për disiplinë kishe te disa pjesë të Shkrimit:

DISIPLINA E KISHËS

Vëllezër, në qoftë se dikush bie në ndonjë faj, ju që jeni frymëror, lartësojeni me frymë butësie (Galatasve 6:1).

Dhe mos merrni pjesë në punët e pafrytshme të errësirës, por më tepër t'i qortoni (Efesianëve 5:11).

Shmangu nga njeriu sektar, mbasi ta kesh qortuar një herë e dy herë (Titit 3:10).

Dhe nëqoftëse dikush nuk i bindet fjalës sonë në këtë letër, shënojeni atë dhe mos u shoqëroni me të, që ai të turpërohet. Por mos e mbani atë si një armik, po këshillojeni si vëlla (2 Thesalonikasve 3:14–15).

Gjoni nxit atë që mund të quhet disiplinë parandaluese, ku kisha nuk duhet ta lejojë dikë të marrë pjesë në përbashkësinë e saj që në fillim:

Kushdo që shkon tej dhe nuk qëndron në doktrinën e Krishtit, nuk ka Perëndi; kush qëndron në doktrinën e Krishtit, ka Atin dhe Birin. Në qoftë se dikush vjen tek ju dhe nuk sjell këtë doktrinë, mos e pranoni në shtëpi dhe mos e përshëndetni (2 e Gjonit 9–10).

Edhe Pjetri na paraqet një shembull të qartë të disiplinës parandaluese (Veprat e Apostujve 8:17–24).

DISIPLINË NË KORINTH

Një pjesë Shkrimi e njohur mbi disiplinën e kishës, e fundit për tani, është 1 Korintasve 5. Pali parashtroi mëkatën dhe reagimin e vet ndaj tij në vargjet e para të kapitullit:

Kudo po dëgjohet se ndër ju ka kurvëri, madje një kurvëri të

tillë që as nuk zihet në gojë ndër paganë, saqë një shkon me gruan e babait të vet. Dhe ju u krekosët e madje nuk vajtuat, që të hiqet nga mesi juaj ai që ka kryer një punë të tillë.

Dhe unë, megjithëse nuk jam aty me trup, me frymë aty jam, dhe, sikur të isha i pranishëm, kam gjykuar tanimë atë që bëri këtë (1 Korintasve 5:1–3).

Ajo që bie në sy në lidhje me këshillën e Palit është se si ajo edhe mbivendoset edhe nuk mbivendoset me këshillën e Jezusit te Mateu 18. Ashtu si Jezusi, Pali e nxiti kishën të luajë një funksion gjyqësor. Ai madje përdor disa herë fjalët “gjykim”, “gjykuar”, gjykoj” ose “gjykues” (1 Korintasve 5:3, 12–13). Ashtu si Jezusi, Pali po trajton një skenar ku dikush që rrëfen se beson te emri i Jezusit mund të hiqet nga trupi i kishës. Megjithatë, ndryshe nga Jezusi, Pali nuk i thotë kishës që ta paralajmërojë njeriun dhe ta ftojë në pendim, siç këshillon Jezusi te Mateu 18. Ai thjesht i thotë kishës që ta largojë atë — pa bërë pyetje. Do të diskutojmë arsyetimin e kësaj pjese në kapitullin 3.

Në vargjet pasuese, Pali përshkruan me kujdes se si duhet të jetë ky akt disiplinimi:

Në emër të Zotit tonë Jezu Krisht, mbasi të mblidheni ju bashkë me frymën time, me fuqinë e Zotit tonë Jezu Krisht, vendosa që ti dorëzohet ky njeri në dorë të Satanit për prishjen e mishit, që t’i shpëtohet fryma në ditën e Zotit Jezus (1 Korintasve 5:4–5).

T’ia dorëzosh njeriun Satanit do të thotë ta trajtosh atë, sipas fjalëve të Jezusit, si një pagan ose tagrambledhës; ta trajtosh atë si dikë që nuk i përket më bashkësisë së besëlidhjes.

DISIPLINA E KISHËS

Kisha, në fund të fundit, është një bazë e mbretërisë së Perëndisë. Prandaj, kushdo që nuk i përket mbretërisë së Perëndisë, i përket mbretërisë së Satanit. Satani është princi i kësaj bote dhe mbretëritë e botës i përkasin përkohësisht atij (Gjoni 12:31; 14:30; Mateu 4:8–9).

Pali më pas vëren se nëse nuk e heqin këtë njeri nga kisha, po vënë në rrezik të gjithë kishën:

Mburra juaj nuk është e mirë. A nuk e dini se pak maja e mbrun gjithë brumin? Hiqni, pra, majanë e vjetër, që të jeni një brumë i ri, siç jeni pa maja; sepse pashka jonë, që është Krishti, u flijua për ne. Prandaj le të kremtojmë festën jo me maja të vjetër, as me maja ligësie dhe keqësie, por me bukë pa maja të sinqeritetit dhe të së vërtetës.

Ju kam shkruar në letër, të mos përziheni me kurvarë, dhe aspak me kurvarët e kësaj bote, ose me lakmuesit ose me cubat, ose me idhujtarët, sepse atëherë duhet të dilni nga bota. Por tani ju shkrova të mos përziheni me atë, të ashtuquajturin vëlla, që është kurvar, ose lakmues ose idhujtar, o shpifës, o pijanec ose cub; me një të tillë bile as të mos hani bashkë (1 Korintasve 5:6–11).

Në vargjet e fundit të kapitullit, Pali përsërit faktin se kisha duhet të luajë një rol gjyqësor në jetën e këtij njeriu: “Sepse a më takon mua të gjykoj edhe ata që janë jashtë? A nuk i gjykoni ju të brendshmit? Por ata të jashtmit Perëndia i gjykon. Prandaj nxirreni të ligun nga vetja juaj”(v. 12–13).

QËLLIMI I DISIPLINËS SË KISHËS

Letra e parë e Korintasve, në kapitullin 5, është veçanërisht e dobishme për të dalluar qëllimet e disiplinës së kishës. Mund të vëzhgojmë të paktën pesë. Së pari, disiplina synon të

nxjerrë në pah. Mëkatit, ashtu si kancerit, i pëlqen të fshihet. Disiplina e nxjerr në pah kancerin në mënyrë që të mund të hiqet shpejt (shih 1 Korintasve 5:2).

Së dyti, disiplina synon të *paralajmërojë*. Një kishë nuk ushtron ndëshkimin e Perëndisë nëpërmjet disiplinës. Përkundrazi, ajo vë në skenë një shfaqje të vogël që paraqet gjykimin e madh që do të vijë (v. 5). Disiplina është një paralajmërim me dhembshuri.

Së treti, synon të *shpëtojë*. Kisha ushtron disiplinë kur sheh një anëtar që merr rrugën drejt vdekjes dhe asnjë nga lutjet e tyre apo paralajmërimet nuk e kthejnë personin prapa. Disiplina është mjeti i fundit për ta sjellë një individ në pendim (v. 5).

Së katërti, disiplina synon të *mbrojë*. Ashtu si kanceri përhapet nga një qelizë në tjetrën, po ashtu, edhe mëkati përhapet shpejt nga një person te tjetri (v. 6).

Së pesti, synon të *paraqesë një dëshmi të mirë* për Jezusin. Disiplina e kishës, e çuditshme të thuhet, është vërtet e dobishme për sytë e atyre që nuk janë të krishterë, sepse ndihmon për të ruajtur veçorinë tërheqëse të popullit të Perëndisë (shih v. 1). Mbani mend, kishat duhet të jenë kripë dhe dritë. Por nëse kripa e humbet njelmësinë e saj ... , Jezusi tha, “Nuk vlen për asgjë, veçse për t’u hedhur dhe ta shkelin njerëzit” (Mateu 5:13).

NEVOJA PËR NJË KORNIZË TË UNGJILLIT

Qëllimi i fundit më sipër tregon nevojën për një kornizë më të madhe teologjike për të ditur se si t’i qasemi disiplinës kishtare.

Merrni parasysh dilemën e ngritur nga tema e disiplinës kishtare. Siç thamë, disiplina e kishës përqendrohet mbi idenë e korrigjimit të mëkatit. Por ungjilli i krishterë, siç do të

DISIPLINA E KISHËS

pajtoheshin shumica, përqendrohet në idenë e *faljes së mëkatit*. Nëse Perëndia e fal mëkatit, pse duhet të shqetësohemi për korrigjimin e mëkatit? Edhe të krishterët janë thirrur t'i falin të tjerët. Atëherë, cili do të ishte qëllimi i korrigjimit të mëkatit të njëri-tjetrit?

Një ungjill i zbehur, i cili flet vetëm për falje dhe dashuri të pakushtëzuar, nuk i ka mundësitë apo themelet për ta trajtuar këtë trysni të rëndë. Si rezultat, mëkati nuk trajtohet dhe kishat fillojnë të bëhen hija e botës.

Megjithatë, një ungjill më i fortë trajton jo vetëm problemin e fajit të mëkatit, por edhe problemin e kalbjes së mëkatit, gjithnjë me premtimin e një natyre të re. Për më tepër, e vendos ungjillin brenda linjës më të madhe të historisë biblike të qëllimeve të Perëndisë që njerëzimi ta përfaqësojë atë.

Perëndia e ngarkoi Adamin të ishte shëmbëllim i Tij duke sunduar mbi krijimin, por Adami dështoi. Kështu bëri edhe Izraeli. Kështu bëri edhe mbreti i Izraelit, Davidi. Por më pas erdhi një që ishte shëmbëllimi i përsosur i Perëndisë. Lajmi i mirë i ungjillit është se Perëndia ka krijuar një rrugë në të cilën ne të rikthehemi tek Ai dhe të qëllimi i Tij fillestar për jetën tonë — duke mbretëruar së bashku me Jezusin mbi të gjithë krijimin. Ai premton falje nga faji nëpërmjet veprës së Birit të Tij si dhe një natyrë të re që i bindet ligjit nëpërmjet veprës së Frymës së Tij. Vetëm brenda këtij kuadri ka kuptim disiplina e kishës, siç e konsiderojmë tani.

NJË KORNIZË E UNGJILLIT PËR TË KUPTUAR DISIPLINËN

Hamendësoni se një lojtar i futbollit amerikan u bashkua me disa miq për një lojë futbollit. Pastaj, në mes të lojës, ai u shtri dhe mori topin e futbollit dhe filloi të vraponte me të. Arbitri pa dyshim do t'i binte bilbilit dhe do të shpallte një faull.

Në këtë pikë, lojtari i futbollit amerikan mund të kthehet ta shikojë gjyqtarin me habi në fytyrë. Pse i bie bilbilit? Pse faull? Ai thjesht po bënte atë që bën gjithmonë — kap topin dhe vrapo.

Si përgjigje, mund t'i shpjegohej futbollistit amerikan se, përveç portierit, futbollistët nuk mund ta prekin topin me duar. Tani, kthehu në lojë dhe mos e bëj më atë gabim.

Ose dikush mund të kalojë pak më shumë kohë për t'i shpjeguar se si zhvillohet loja e futbollit. Futbollit, në thelbin e vet kuptimor, është një lojë për këmbët, jo për duart. Gjëja që e bën futbollin tërheqës për t'u parë është aftësia e lojtarëve të zotë për të ushtruar kontroll mbi topin pa i përdorur kurrë duart e tyre. Nuk është pa arsye që çdo komb në botë përveç

DISIPLINA E KISHËS

Amerikës e quan lojën “futboll”¹. Futbollisti amerikan nuk ka thyer thjesht një rregull; ai ka thyer një rregull që përcakton qëllimin e lojës.

Disiplina e kishës, gjithashtu, mund të përshkruhet në dy mënyra. Dikush mund ta përshkruajë atë si një akt të korrigjimit të mëkatit, si rënia e bilbilit kundër një faulli në jetën e krishterë. Madje, edhe më mirë, dikush mund të përpiqet të kuptojë aktin e fishkëllimës së bilbilit brenda kuadrit më të gjerë të ungjillit, kishës dhe qëllimeve të jetës së krishterë. Vendosja e aktit të disiplinës në këtë kuadër më të madh teologjik — atë që unë po e quaj kuadri apo korniza e ungjillit — do të na ndihmojë të ushtrijmë aftësinë dalluese që kërkohet në mënyrë të pashmangshme mes rrethanave të shumta të mëkatit në kishë.

Gënjeshtra, për shembull, është një “faull”. A do të thotë kjo që e gjithë kisha duhet të përfshihet sa herë që një anëtar gënjen? Sigurisht që jo. Varet shumë nga të gjitha rrethanat që e mbështjellin gënjeshtren ose gënjeshttrat: Sa e rëndë është ajo? A po këmbëngul individi në atë gjë? A është një praktikë e vazhdueshme?

Diku ka një vijë të hollë midis një gënjeshtre që duhet të trajtohet privatisht dhe një gënjeshtre që duhet të trajtohet publikisht. Si e dimë kur ajo vijë kapërcehet? Kjo është sfida praktike e disiplinës kishtare. Pikërisht këtu kërkohet aq shumë mençuri.

Pohimi im është se udhëheqësit e kishës do të jenë më të pajisur për të kuptuar se ku bie kjo vijë nëse ata e kuptojnë

¹ Futboll vjen nga fjala *football*, që do të thotë top këmbë, pra, top me këmbë. Shënim i përkthyesit.

veprimtarinë e tyre korrigjuese brenda një kuadri më të madh të ungjillit. Ungjilli na ndihmon të vlerësojmë se kur duhet të flasim dhe kur të heshtim, kur të veprojmë dhe kur të mos veprojmë.

ÇFARË ËSHTË UNGJILLI?

Krijimi i një kuadri për disiplinën e kishës kërkon që ne të kuptojmë (1) ungjillin, (2) çfarë është një i krishterë, (3) çfarë është një kishë vendore dhe (4) çfarë do të thotë anëtarësi në kishë.

Çfarë është ungjilli? Unë paraqita një përvijim në parathënie. Më lejoni ta plotësoj pak këtu. Ungjilli është një lajm i mirë që vjen në fund të një historie të gjatë rreth qenieve njerëzore që ngrenë krye kundër Perëndisë dhe vendosen në fron mbi botën e tij. Zoti e krijoi njerëzimin sipas shëmbëllimit të tij për të përfaqësuar sundimin dhe karakterin e tij mbi krijimin. Ai i krijoi ata sipas shëmbëllimit të tij, që të mund ta shëmbëllenin Atë. Ai i vendosi të sundonin me bindje, në mënyrë që ata të mund të sundonin siç sundon ai: me mirësi, drejtësi, shenjtëri dhe dashuri.

Por njerëzimi më vete e shpalli se ishte më i mençur se Perëndia dhe njerëzit zgjodhën të sundonin vetë. Ata e përçudnuan natyrën e tyre dhe morën dënimin me vdekje. Historia e Izraelit është qartësisht historia e krijimit dhe e rënies së njeriut. Një grupi njerëzish iu dhanë të gjitha përfitimet dhe përparësitë e ligjit të Perëndisë dhe të pranisë së Perëndisë me qëllim që ta përfaqësonin Atë, por ata bënë të tyren, krejt në kundërshtim me atë qëllim. Kështu Ai i dëboi nga vendi i Tij.

Lajmi i mirë, që vjen në fund të kësaj historie të trishtë, është se një nga bijtë e Adamit dhe Izraelit erdhi për të bërë

DISIPLINA E KISHËS

atë që as Adami dhe as Izraeli nuk mund ta bënin: të sundonin me bindje dhe të fitonin një popull për Perëndinë. Ai që ishte vetë shëmbëllimi i Perëndisë erdhi si njeri dhe krijoi një mbretëri duke iu bindur Atit qiellor deri në pikën e fundit. Ai jo vetëm që krijoi një mbretëri, por edhe fitoi një popull për këtë mbretëri, duke dhënë jetën e tij si një pagesë për fajin e mëkatit, dhe më pas u ngrit nga të vdekurit duke përruar një krijim krejtësisht të ri.

Me pak fjalë, lajmi i mirë është se Jezu Krishti ka fituar shpëtimin dhe sundimin për të gjithë ata që kanë besim tek Ai dhe e ndjekin si Zot. Shpëtimi përfshin faljen e mëkateve, pajtimin me Perëndinë nëpërmjet Krishtit, pajtimin me popullin e Krishtit dhe një zemër të re ku banon Fryma e Tij, zemër e cila tani dëshiron të sundojë me bindje, me qëllim që ta përfaqësojë Jezusin në tokë.

ÇFARË ËSHTË NJË I KRISHTERË?

Çfarë është një i krishterë? Ka disa mënyra për të përshkruar se çfarë është një i krishterë. Si fillim, një i krishterë është dikush që është falur dhe bashkuar me Perëndinë nëpërmjet besëlidhjes së re në gjakun e Krishtit, është dikush që i është dhënë një natyrë e re nga Fryma (shih Ligji i Përtërirë. 30:6–8; Jeremia 31; Ezekieli 36:24–27).

Gjithsesi, një i krishterë është më shumë sesa një status i ri dhe një natyrë e re. Një i krishterë ka një familje të re. Ai ose ajo, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, tani është anëtar i një populli. Të pajtohesh me Krishtin, nga vetë kuptimi i fjalës, do të thotë të pajtohesh me popullin e Krishtit (Efesianëve 3:6). Pali e bën këtë lidhje duke bashkuar gjysmën e parë të Efesianëve 2 me

gjysmën e dytë. Së pari, ai na thotë se jemi shpëtuar me anë të hirit (Efesianëve 1:1–10). Së dyti, na thotë se muri ndarës ndër-mjet hebrejve dhe johebrejve ka rënë, duke krijuar një njeri të ri (v. 11–22). Kur birësohesh nga një nënë dhe baba do të thotë të të jepet një numër i dhënë motrash dhe vëllezërish krejtësisht të rinj. Kështu është edhe me krishterimin. Pavarësisht a ishim të vetëdijsëm se po bashkoheshim me një familje të re apo jo, birësimi ynë në Krishtin është birësim në një familje.

Pra, një i krishterë ka një status të ri, një natyrë të re, një familje të re dhe, së fundi, një përshkrim të ri të detyrës. Një i krishterë është dikush që tani përfaqëson Jezusin, dhe për rrjedhojë, Perëndinë. Ky është pikërisht mesazhi i pagëzimit dhe Darkës së Zotit. Të pagëzohemi do të thotë ta identifikojmë veten me emrin e Atit, Birit dhe Frymës së Shenjtë, si dhe ta identifikojmë veten me vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit (Mateu 28:19; Romakëve 6:4–5). Të marrësh Darkën e Zotit do të thotë të shpallësh vdekjen e tij dhe të qenët anëtar në trupin e tij (1 Korintasve 11:26–29; shih Mateu 26:26–29). Perëndia dëshiron që populli i tij të njihet dhe të dallohet. Ai dëshiron që të ketë një vijë ndarëse midis popullit të tij dhe botës. Ai dëshiron që ne të jemi të shenjtë, sepse Ai është i shenjtë. Të krishterët e përfaqësojnë Atë tani — sot!

E thënë ndryshe, një i krishterë është dikush që mbart emrin e Perëndisë në tokë, që shpall ungjillin e tij dhe që është i bashkuar me popullin e tij. Në thelb, i krishteri është një ambasador — një person, identiteti dhe puna e të cilit shkrihen së bashku. Për një ambasador, sido që është, çfarëdo që thotë dhe çfarëdo që bën, përfaqëson mbretin e tij ose të saj. Kështu është me të krishterët dhe Krishtin.

DISIPLINA E KISHËS

ÇFARË ËSHTË NJË KISHË VENDORE?

Po kisha vendore? Çfarë është ajo? Një kishë vendore është më shumë se një mbledhje e të krishterëve. Dhjetë të krishterë të ulur së bashku në lulishte nuk përbëjnë një kishë. Jezusi u ka dhënë të krishterëve të mbledhur së bashku si një kishë vendore një autoritet mbretërie që nuk ua ka dhënë të krishterëve veç e veç. Në mënyrë të veçantë, Ai u ka dhënë kishave vendore autoritetin për të përdorur çelësat e mbretërisë nëpërmjet dhënies apo mosdhënies së mundësisë për t'u pagëzuar dhe për të marrë pjesë në Darkën e Zotit, duke bërë kështu punën e dallimit dhe veçimit të popullit të Perëndisë nga bota.

Kjo është pamja që gjejmë fillimisht te Mateu 16 dhe 18, dhe më pas te Mateu 28; kjo pamje më pas kthehet në një film në librin e Veprave të Apostujve dhe te Letrat. Jezusi autorizon kishën vendore që të përdorë çelësat e mbretërisë për të qëndruar përpara një personi që rrëfen se beson, për ta marrë parasysh rrëfimin e tij ose saj, për të marrë parasysh jetën e tij ose të saj dhe për të shpallur një gjykim zyrtar në emër të qiellit. A është ky rrëfimi i duhur? A është ky një besimtar i vërtetë? Kisha vendore ndjek shembullin e Jezusit kur e pyeti Pjetrin, i cili deklaroi se Jezusi ishte Krishti (Mateu 16:16–17). Në mënyrë të veçantë, kisha e kryen detyrën e saj nëpërmjet urdhëresave që janë përcaktuar te Mateu 26 dhe Mateu 28: Darka e Zotit dhe pagëzimi.²

² Për interpretimin tim të këtyre pjesëve dhe të përkufizimeve të parashtruara këtu, paraqes një shpjegim dhe mbrojtje më të gjatë në kapitullin 3, tek *Church Membership: How the World Knows Who Represents Jesus*, Wheaton, IL: Crossway, 2012. Një mbrojtje edhe më e plotë mund të gjendet në kapitullin 4 të librit tim *The Church and the Surprising Offense of God's Love: Reintroducing the Doctrines of Membership and Discipline*, Wheaton, IL: Crossway, 2010.

Kisha vendore, me fjalë të tjera, ka autoritetin qiellor për të deklaruar se kush është një qytetar i mbretërisë dhe për këtë arsye përfaqëson emrin e Jezusit në tokë. Jezusi nuk ka autorizuar njerëz të veçuar që të vendosin papritur se janë të krishterë, dhe më pas të dalin përpara kombeve dhe të deklarojnë se përfaqësojnë Jezusin. Populli i Jerusalemit e pyeti Pjetrin se çfarë duhej të bënin për t'u shpëtuar. Ai u përgjigj: "Pendohuni dhe pagëzohuni" (Veprat e Apostujve 2:38). Ata kishin nevojë për pranimin dhe pohimin zyrtar të kishës së Jerusalemit.

Duhet të kujtojmë se fuqia e kishës vendore është pohuese e miratuese. Një kishë nuk e *bën* një person qytetar të mbretërisë, por ajo ka përgjegjësinë për të pohuar se kush i përket dhe kush nuk i përket mbretërisë së Krishtit. Një kishë, pra, është si ambasada e një kombi. Nëse pasaportës suaj i mbaron vlefshmëria gjatë udhëtimit në një vend të huaj, ju bëni kërkesë në ambasadën e vendit tuaj për të ribërë pasaportën tuaj. Ambasada ka një autoritet që ju si qytetar më vete nuk e keni.

Natyrisht, kisha është më shumë se një institucion me autoritet mbretërie. Është edhe një "trup", një "familje", një "grigjë", një "tempull", një "shtyllë dhe mbështetëse e së vërtetës", dhe më shumë. Por ne nuk duhet të anashkalojmë faktin se ajo është edhe *institucioni tokësor i krijuar* nga Jezusi me autoritet për të deklaruar se cilët janë qytetarët ose ambasadorët e tij.

Për ta përcaktuar institucionalisht kishën vendore, atëherë, mund të themi se është një grup të krishterësh që mbledhen rregullisht në emër të Krishtit për të pohuar dhe mbikëqyrur zyrtarisht anëtarësimin e njëri-tjetrit në Jezu Krishtin dhe në

DISIPLINA E KISHËS

mbretërinë e tij nëpërmjet predikimit të ungjillit dhe urdhëresave të ungjillit.

Si të tillë, të krishterët nuk “bashkohen” me kishat ashtu siç u bashkohen organizatave apo shoqatave, por ata u nënshtrohen kishave. Kisha nuk është një autoritet absolut, ashtu si një prind nuk është një autoritet absolut për një fëmijë. Por Krishti dëshiron që të krishterët t’i nënshtrohen mbikëqyrjes së kishave vendore për shkak të nënshtetësisë së tyre në mbretërinë e tij.

A do t’i përdorë kisha vendore çelësat në mënyrë të përsosur? Jo. Do të bëjë gabime, ashtu si çdo autoritet tjetër i vendosur nga Jezusi bën gabime. Kisha vendore është një përfaqësim i papërsosur i asamblesë së madhe me Krishtin në kohët e fundit. Por fakti që bën gabime, ashtu siç bëjnë presidentët dhe prindërit, nuk do të thotë se është pa një mandat autoritar.

Në të gjitha këto, duhet të jetë e qartë se një nga detyrat kryesore të kishës është mbrojtja e emrit të Jezusit.

ÇFARË ËSHTË ANËTARËSIA NË KISHË?

Atëherë, çfarë është anëtarësimi në kishë? Është një deklaratë e nënshtetësisë në mbretërinë e Krishtit. Është një pasaportë. Është një njoftim i bërë në zyrën e shtypit të mbretërisë së Krishtit. Është deklarata se një individ që shpall se beson në Krishtin është një përfaqësues zyrtar i Jezusit, i licencuar dhe i mirëbësuar.

Më konkretisht, anëtarësimi në kishë është një marrëdhënie formale midis një kishe vendore dhe një të krishteri, e karakterizuar nga pranimi dhe mbikëqyrja e kishës për

dishepullimin e të krishterit dhe nga nënshtrimi i tij për ta jetuar dishepullimin e tij ose të saj nën kujdesin e kishës.

Vini re se disa elementë janë të pranishëm këtu:

- trupi i një kishë e *pohon* dhe e miraton zyrtarisht besimin dhe pagëzimin e një individi si të besueshëm;
- premtori ta *mbikëqyrë* dishepullimin e atij individi;
- individi ia *dorëzon* zyrtarisht dishepullimin e vet shërbimit dhe autoritetit të këtij trupi dhe drejtuesve të tij.

Trupi i kishës i thotë individit: “Ne i njohim shpalljen tënde të besimit, pagëzimin dhe dishepullimin në Krishtin si të vlefshme. Prandaj, ne *pohojmë* dhe të njohim publikisht para kombeve si i Krishtit dhe shtrijmë mbi ty *mbikëqyrjen* e bashkësisë sonë”. Në thelb, individi i thotë trupit të kishës: “Përderisa unë ju njoh si një kishë besnike, shpallëse e ungjillit, ia *nënshtroj* praninë dhe dishepullimin tim dashurisë dhe mbikëqyrjes suaj”.

Standardet për anëtarësimin në kishë nuk duhet të jenë më të larta ose më të ulëta se standardet për të qenë i krishterë, me një përjashtim. Një i krishterë është një person që është penduar dhe ka besuar, dhe këtë duhet ta njohë e pranojë kisha si anëtar. E vetmja kërkesë shtesë është pagëzimi. Anëtarët e kishës duhet të pagëzohen, një model që është i njëtrajtshëm në Dhiatën e Re. Pjetri u tha turmave në Jerusalemin: “Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet” (Veprat e Apostujve 2:38). Dhe Pali, duke i shkruar kishës në Romë, thjesht e merr si të mirëqenë se cilido që i përket kishës romake është pagëzuar (Romakëve 6:1–3).

Anëtarësia në kishë, me fjalë të tjera, nuk ka të bëjë me “kërkesa shtesë”. Bëhet fjalë për një kishë që merr përgjegjësi

DISIPLINA E KISHËS

të posaçme për një të krishterë, dhe një i krishterë për kishën. Ka të bëjë me “veshjen”, “mishërimin”, “të jetuarit” dhe “shfaqjen” e anëtarësimit tonë në trupin universal të Krishtit. Në një farë mënyre, bashkimi që përbën një kishë vendore dhe anëtarët e saj është si ajo shprehja “pranoj” në një ceremoni martese, kjo është arsyeja pse disa i referohen anëtarësimit në kishë si një “besëlidhje”.

Është e vërtetë që një i krishterë duhet të zgjedhë të bashkohet me një kishë, por kjo nuk e bën atë një organizatë vullnetare. Pasi ka zgjedhur Krishtin, një i krishterë nuk ka zgjedhje tjetër veçse të vendosë të bashkohet me një kishë.

NJË KONCEPT MË I PLOTË I DISIPLINËS SË KISHËS

Diskutimi i mëparshëm mbi ungjillin, të krishterin, kishën dhe anëtarësimin në kishë përbën kuadrin nëpërmjet të cilit duhet kuptuar disiplina e kishës. Më lejoni të nxjerr katër elementë nga ky diskutim që parashtrojnë qëndrime themelore e të rëndësishme për disiplinën e kishës:

- 1) *Një pritshmëri ndryshimi.* Besëlidhja e re premtan se populli i Krishtit do të jetojë një jetë të ndryshuar rrënjësisht nëpërmjet fuqisë së Frymës. Edhe nëse ndryshimi vjen ngadalë, kishat duhet të presin ndryshim — frytin e dukshëm të hirit dhe Frymës së Perëndisë. Disiplina është përgjigjja e duhur ndaj mungesës së fryteve të dukshme, ose, aq më tepër, ndaj pranisë së fryteve të këqija.
- 2) *Puna e përfaqësimit.* Të krishterët duhet të jenë krishtër të vegjël, që e përfaqësojnë Jezusin në tokë. Koncepti i përfaqësimit varet nga ideja se Jezusi është Shpëtimtar dhe Zot; varet nga fakti se të krishterëve u jepet një status i ri dhe një detyrë e re. Disiplina është përgjigjja e duhur kur të krishterët nuk arrijnë

ta përfaqësojnë Jezusin dhe nuk tregojnë dëshirë për ta bërë këtë gjë.

- 3) *Autoriteti i kishës vendore.* Jezusi i dha kishës vendore autoritetin e çelësave për të pohuar, miratuar dhe mbikëqyrur zyrtarisht qytetarët e mbretërisë së tij. Kishat nuk i bëjnë njerëzit të krishterë. Fryma e bën këtë gjë. Por kishat kanë autoritetin dhe përgjegjësinë deklarative për të bërë shpallje publike para kombeve se kush është dhe kush nuk është i krishterë. Pra, akti i shkishërimit nga një kishë nuk përbën largimin fizik dhe me forcë të individit nga mbledhjet e saj publike, sikur kisha të kishte fuqinë e shpatës së shtetit për të asgjësuar fizikisht njerëzit; përkundrazi, shkishërimi është deklarata publike se kisha nuk mund të garantojë më nënshtetësinë e një individ në parajsë. Shkishërimi është deklarata e një kishë që nuk mund të pohojë më se një individ është i krishterë.
- 4) *Anëtarësimi si nënshtrim.* Të krishterët janë të porositur, si rrjedhojë e bindjes ndaj Krishtit, t'i nënshtrohen miratimit dhe mbikëqyrjes së kishave vendore. Prandaj, kur kërcënohen nga një akt i mundshëm disipline, anëtarët e kishës nuk mund ta shmangin procesin e kishës thjesht me një dorëheqje. Kjo do të ishte njësoj sikur një individ të jepte dorëheqjen e nënshtetësisë së tij kombëtare përpara se gjykata të mund të nxirrte vendimin përfundimtar mbi veprimtarinë kriminale për të cilën ai është paditur.

Kur e shohim disiplinën e kishës përmes këtij kuadri teologjik, fitojmë një kuptim më të plotë. Nuk ka të bëjë vetëm me korrigjimin e mëkatit apo me rënien e bilbilit. Bëhet fjalë për korrigjimin e mëkatit për t'u siguruar që anëtarët e kishës me të vërtetë po e përfaqësojnë Jezusin ashtu si duhet. Ka të bëjë me kërkesën e llogarisë, që ata të jetojnë sipas rrëfimit që kanë bërë.

Prandaj, disiplina sillet rreth pyetjes se kush është i licencuar ose i autorizuar për të përfaqësuar qiellin në tokë. Ta quash veten të krishterë do të thotë të shpallësh se e ke atë të drejtë. Të jesh anëtar i kishës do të thotë të pranohesh zyrtarisht se e ke atë të drejtë. Kisha vendore, institucioni që mban çelësat e Jezusit, garanton besueshmërinë e rrëfimit të një të krishteri përmes pagëzimit dhe Darkës së Zotit. Disiplina e kishës hyn në lojë sa herë që kjo besueshmëri vihet në dyshim. Ajo priret nga një pyetje e vetme: a beson ende kisha se një anëtar që jeton në gabim është me të vërtetë një i krishterë, saqë është e gatshme të vazhdojë ta deklarojë këtë gjë publikisht?

Me pak fjalë, disiplina e kishës ka të bëjë me emrin e Jezusit në tokë. Ajo që vihet në lojë këtu është shumë e shtrenjtë.

KUR ËSHTË E NEVOJSHME DISIPLINA?

Një dishepull i krishterë është një person që ndjek Jezu Krishtin. Dishepullimi në kishën vendore përfshin anëtarët e kishës që ndihmojnë njëri-tjetrin të ndjekin Jezusin. Anëtarët e bëjnë këtë përmes formimit dhe korrigjimit. Ata mësojnë të mirën dhe korrigjojnë të keqen. Ata nxitin njëri-tjetrin drejt rrugës së drejtë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin që të largohen nga rruga e gabuar.

Në këtë këndvështrim, nevoja e një të krishteri për korrigjim duhet të ketë kuptim për ne. Një pjesë themelore e të qenit i krishterë është të pranojmë se jemi të kufizuar dhe mëkatarë. Mund të jemi të pavetëdijshëm dhe të vetë-mashtruar, prandaj kemi nevojë për besimtarë të tjerë që të na ndihmojnë të dimë se kur kemi dalë nga rruga e dishepullimit.

Mbaj mend kur bëra një bisedë për taksat mbi të ardhurat e mia me një plak tjetër në kishën time, Xhemi. Diku në bisedë, Xhemi përmendi diçka në lidhje me pagimin e taksave mbi të ardhurat nga qiraja që merrnim unë dhe gruaja ime nga personi që jetonte në bodrumin tonë. Në çastin kur Xhemi tha fjalët “të ardhura nga qiraja” më erdhi në kokë mendimi: “Prit një

DISIPLINA E KISHËS

sekondë, të ardhura nga qiraja? Më duhet të paguaj taksa për ato të ardhura nga qiraja, apo jo?” Në fakt, kisha vjedhur nga qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe nuk e dija. Unë isha larguar nga rruga e dishepullimit dhe nuk po e përfaqësoja Jezusin, i cili tha se ne duhet t’i paguanim taksat Cezarit. Prandaj, si i krishterë, nuk kisha zgjedhje tjetër veçse të kthehesha dhe të hapja taksat e vitit të kaluar dhe të paguaja paratë shtesë.

Si të krishterë, që e pranojmë se jemi të kufizuar dhe mëkatarë, mund të pranojmë gjithashtu se mund të ketë shumë fusha në të cilat jeta jonë nuk është hap pas hapi me Jezusin. Zgjidhja, pra, është të fillojmë të hapim jetën tonë ndaj anëtarëve të tjerë të kishës. Më pas ata mund të na ndihmojnë të shohim atë që nuk mund ta shohim menjëherë tek vetja. Dhe kjo është disiplina e vërtetë: të ndihmojmë njëri-tjetrin të rritemi në ngjashmëri me Krishtin duke korrigjuar mëkatin. Nuk e di nëse Xhemi donte të më “disiplinonte”, por fatmirësisht, këtë bëri.

Kur do të themi se disiplina kishtarë është e nevojshme? Në përgjithësi, disiplina është e nevojshme sa herë që një dishepull largohet nga rruga e Krishtit duke mëkatuar. Është e nevojshme sa herë që hapet një hendek midis rrëfimit të besimit dhe jetës së një të krishterë, dhe i ashtuquajturit përfaqësues i Jezusit nuk arrin ta përfaqësojë Jezusin.

Më së shumti, disiplina ndodh joformalisht dhe privatisht. Një vëlla ose motër në Krishtin mëkaton dhe një vëlla ose motër tjetër, me dashuri, e trajton çështjen me qetësi, dhe pa bujë.

Nganjëherë, procesi ndodh zyrtarisht dhe publikisht, gjë që njerëzit e kanë në mendje më së shumti kur përmendet

“disiplina e kishës”, dhe sigurisht ajo që ne nënkuptojmë me shkishërim. Disiplina formale e kishës është mënyra e duhur e veprimit sa herë që dështimi i një anëtar i kishës për të përfaqësuar Jezusin bëhet aq karakteristik dhe i zakonshëm, sa që kisha nuk beson më se ai ose ajo është i krishterë. Kisha më pas duhet ta zhbëjë pohimin e saj për besimin e këtij personi. Kjo është qasja e “kuadrit të ungjillit” ndaj disiplinës, të cilën e shqyrtoam në kapitullin e fundit. Nuk ushtrohet në bazë të listave se cilat mëkate kualifikohen për disiplinë. Ajo priret nga pyetja e vetme nëse një kishë mund të vazhdojë ta pohojë publikisht si të besueshëm rrëfimit e besimit të një personi.

Brenda këtij kuadri, a mund të themi diçka më të posaçme se kur është e nevojshme disiplina e kishës?

MËKATET QË PRITEN, MËKATE QË NUK PRITEN

Një çast më parë thashë se ka një vijë të hollë midis mëkateve që mund të trajtohen privatisht dhe mëkateve që kërkojnë që e gjithë kisha të përfshihet. Këtu kemi një vëzhgim paralel: diku ka një vijë midis mëkateve që priten nga të krishterët dhe mëkateve që ju bëjnë të mendoni se personi mund të mos jetë i krishterë. Disiplina joformale dhe private ndodh në të dy anët e vijës, për të qenë të sigurt. Por disiplina ose shkishërimi formal i kishës është i garantuar, në përgjithësi, kur një individ kalon nga fusha e parë në të dytën, nga mëkatet që janë të pritshme te mëkatet që nuk priten.

Ka një ndryshim, për shembull, midis një gënjeshtre rastësore për të cilën personi pendohet, dhe një gënjeshtre mbi të cilën një person ndërton jetën dhe nuk pranon të heqë dorë

DISIPLINA E KISHËS

prej saj. Për shembull, krahasoni gënjeshttrat e dy të krishterëve të ndryshëm që thonë se janë të krishterë. I pari mburret se ka marrë një ofertë prestigjioze pune që nuk e ka marrë kurrë; më vonë, ai e pranon gënjeshtren. I dyti ndërton një karrierë të tërë mbi informacione të falsifikuara; më vonë, ai zbulohet e përballët, por këmbëngul në trillimet e tij. Gënjeshttra e parë është lloji i mëkatit që — sado që do të donim të mos ishte ashtu — mund të jetë e pritshme herë pas here nga të krishterët. “Njeriu i vjetër”, po të përdorim gjuhën e Palit, shfaqet në kokën e një besimtari dhe përpiket të sundojë mbi “njeriun e ri”, por njeriu i ri kundërshton. Gënjeshttra e dytë nuk është diçka që e presim nga një person në të cilin banon Fryma e Shenjtë. Nuk ka asnjë provë betejë midis njeriut të vjetër dhe njeriut të ri. Është vetëm njeriu i vjetër.

Të krishterët, te të cilët banon Fryma e Shenjtë, në përgjithësi, nuk mund të qëndrojnë për një kohë të gjatë në mëkatin e njohur e të bërë publik. Rrjedhimisht, ndihen aq keq, e kjo vjen prej Frymës së Shenjtë, sa që përfundimisht bëjnë gjënë e duhur.

Disiplina ose shkishërimi formal i kishës është i detyrueshëm kur një individ duket se qëndron i lumtur në mëkatin që tashmë është i njohur. Nuk ka asnjë provë që Fryma po e bën atë të ndihet keq, përveç frikës se do të zbulohet. Përkundrazi, bindja ndaj dëshirave të mëkatit është *karakteristike*.

Çdo mëkat është gabim. Çdo mëkat e përfaqëson keq Jezusin. Por disa mëkate ose modele mëkati bëjnë që një asamble e tërë njerëzish të humbasin besimin te rrëfimi i besimit të një personi. Vjen një kohë kur fjalët e një personi e humbasin besueshmërinë. Anëtarit mund të hiqet sikur është “penduar”, ose është “më mirë” ose “nuk po mëkaton aq keq”, por nuk ka më

arsye pse kisha të mund t'i besojë më këto fjalë. Jeta pas këtyre fjalëve është një kundërvënie e madhe. Kështu që kisha e zhbën pohimin e saj publik duke e përjashtuar anëtarin nga Darka e Zotit. I heq pasaportën dhe njoftoj se nuk mund të pohojë a pranojë më zyrtarisht nënshtetësinë e individit në mbretërinë e Krishtit.

NDJESHMËRIA BARITORE DHE SIPAS RRETHANAVE

Qasja ndaj disiplinës së kishës përmes këtij kuadri të ungjillit, një kuadër i drejtuar jo nga listat e mëkateve, por nga pyetja nëse kisha mund të vazhdojë ta pohojë e pranojë rrëfimin e besimit, sjell një ndjeshmëri më të madhe baritore nga situata në situatë. Shkrimi është gjithmonë udhërrëfyese ynë për çka gjykohet si mëkat, por kujdesi baritor nevojitet për të përcaktuar se cilat mëkate kërkojnë disiplinë dhe në çfarë mase.

Dy njerëz të ndryshëm mund të kryejnë të njëjtin mëkat, por një mori rrethanash do të ndikojnë në ndjesinë e një pas-tori dhe të një kishe për domethënien e atij mëkati. Një kontabilist që shmang pagimin e taksave paraqet një problem më të madh se të tjerët që mund të bëjnë të njëjtën gjë në mosdije, sepse një kontabilist e di saktësisht se çfarë po bën dhe e bën qëllimisht. Një çift i pamartuar i kapur në kurvëri për herë të pestë meriton të trajtohet më rëndë në disiplinë sesa një çift i pamartuar i kapur për herë të parë. Dhe nga të krishterët e rinj, në përgjithësi, mund të pritet që të bien në mëkatet e zakonshme më shpesh sesa besimtarët me përvojë.

Sado subjektive të tingëllojë, faktorë të ndryshëm të rrethanave do të ndikojnë tek ajo që *presim* nga një i krishterë. Dhe pritshmëria luan një rol të madh sepse jetojmë në

DISIPLINA E KISHËS

mbivendosjen e epokës së tanishme dhe asaj që do të vijë. Në këtë epokë, të krishterët, siç tha Martin Luteri, janë njëkohësisht mëkatarë dhe të drejtësuar. Ne presim që njeriu i ri dhe njeriu i vjetër të bëjnë betejë kundër njëri-tjetrit dhe e kuptojmë se rrethanat e ndryshme (p.sh., mosha në besim; sasia e mësimi që dikush ka marrë) mund t'i japë përparësi ose njeriut të ri ose njeriut të vjetër në çdo situatë të caktuar. Si e tillë, disiplina e kishës nuk ka të bëjë kurrë vetëm me pyetjen, "Cili mëkat?" a thua se kemi një peshore që mund të na tregojë nëse një mëkat është aq i rëndë sa të kërkojë disiplinë. Përkundrazi, mëkatet peshohen në një peshore, me mëkatin në njërin anë të peshores dhe provat e pendimit në anën tjetër — dhe jo vetëm pendimin për mëkatin e veçantë, por një qëndrim i përgjithshëm pendimi në jetën e personit. Prandaj, vlerësimi i një rasti të mundshëm disiplinor ka të bëjë gjithmonë me vlerësimin e dinamikës midis rrëfimit të përgjithshëm të pendimit nga një person dhe mëkateve që rëndojnë ndaj atij rrëfimi duke e vënë atë në pikëpyetje.

Kërkesa e Jezusit te Mateu 18 për të vendosur mbi një çështje me dy ose tre dëshmitarë përpara se të çohet para kishës, na ndihmon shumë në këtë drejtim (Mateu 18:16). Pjesa e Shkrimit që Ai po e citon, Ligji i Përtërirë 19, tregon se Perëndia donte që izraelitët të kishin shumë kujdes dhe të siguroheshin që hetimi dhe ndjekja penale të bëheshin me kujdes dhe me drejtësi. Edhe Jezusi dëshironte dhe synonte që udhëheqësit dhe anëtarët e kishës të gjykonin çdo çështje me kujdes. Ata duhet të marrin parasysh provat, anët e ndryshme të historisë dhe rrethanat lehtësuese. Nuk duhet të ketë nxitim për

gjykim. Të krishterët duhet të vijnë ngadalë, me mend dhe me dashamirësi.

Matësi me të cilin dy ose tre dëshmitarët (dhe përfundimisht kisha) duhet të matin mëkatën ose modelin e mëkatit është i thjeshtë: a kundërshton personi në mënyrë të përsëritur të pendohet, aq sa rrëfimi i tij për besim të bëhet përfundimisht i pabesueshëm dhe i pamiratueshëm? Pra, a po e shtrëngon ky person mëkatën e tij aq fort sa të hedhë poshtë çdo rrëfim besimi?

Në të njëjtën kohë, një mori elementësh të tjerë të situatës duhet të përfshihen në diskutimet e një kishe:

- Sa kohë ka që është i krishterë?
- Çfarë mësimi ka marrë?
- A e pranon mëkatari se veprimi i tij ishte i gabuar?
- A duket vërtet i pikëlluar për mëkatën e tij, apo ka një ngjyrim bezdisje në rrëfimin e tij?
- A e rrëfeu shpejt, apo u desh t'ia nxirrnin me zor?
- A i nxori menjëherë të gjitha mëkatet e tij, apo duhej t'i gërmnim ato një nga një?
- A ka gjasa që ende po fsheh hollësi?
- A është ky një model? A është diçka karakteristike e tij apo e saj?
- A e mirëpret korrigjimin?
- A e mirëpret këshillën se si të luftojë kundër mëkatit, apo e kundërshton këshillën, i bindur se e di vetë më së miri se si ta trajtojë atë?
- Ndërsa diskutojmë për mëkatën e tij, a ndihet sikur po qëndron në anën tonë kundër mëkatit, apo është në mbrojtje? Me fjalë të tjera, a po thotë, "Po, ke plotësisht të drejtë. Është e tmerrshme. Çfarë duhet të bëj?" Apo po thotë, "Po, mirë. Mirë. Do ta shohim".

DISIPLINA E KISHËS

- A ka faktorë në historinë e tij personale ose familjare që e bëjnë mëkatin jo më pak të gabuar, por pak më të mundshëm?
- A u çua në mëkat nga të tjerë të cilëve u besonte me arsye?

Përgjigjja për secilën nga këto pyetje mund të mos e shtyjë gjykimin e një kishë ose të një udhëheqësi të kishës në një drejtim ose në një tjetër, por edhe mundet, dhe një mori e këtyre faktorëve së bashku shpesh ndikojnë nëse do të vazhdojmë ta shohim dikë si të krishterë, edhe kur ai mëkaton.

MËKATE TË DUKSHME, MËKATE TË RËNDA, NUK KA PENDESE

Duke qenë se Jezusi përdor Ligjin e Përtërirë 19 dhe Pali u thotë korintasve të “gjykojnë” dhe “të gjykojnë çështjet” (1 Korintasve 5:12; 6:2–5), kjo na udhëzon në të paktën dy mënyra të tjera. Së pari, Jezusi *dëshiron* që kishat të ushtrojnë gjykimin në mënyrën që e kemi përshkruar, edhe pse ai e ndalon një lloj gjykimi vetë-drejtësues apo hakmarrjen vetjake midis të krishterëve gjatë (Mateu 7:1–2).

Së dyti, proceset e gjykimit në një kishë, si në një sallë gjyqi, varen nga ajo që njerëzit mund të shohin me sy ose të dëgjojnë me veshë. Perëndia nuk u ka dhënë të krishterëve sy me rreze X për të përshkuar zemrat. Ai u ka dhënë të krishterëve — siç u ka dhënë të gjithë qenieve njerëzore — sy, veshë dhe tru që mund të përdoren për të marrë parasysh frytin e jetës vetjake dhe për të ushtruar aftësi dalluese (1 Korintasve 5:12; shih Mateu 3:8; 7:16 – 20; 12:33; 21:43).

Është e sigurt se jobesimtarët po i përdorin sytë, veshët dhe trurin e tyre për të vëzhguar jetët e të krishterëve dhe për t'i vlerësuar; edhe të krishterët duhet të bëjnë të njëjtën gjë.

Kjo ka të bëjë me mbrojtjen e emrit të Jezusit, me dashurinë për mëkatarin, me faktin se jobesimtarët po vëzhgojnë dhe me të mirën e kishës.

Jezusi u jep kishave autoritetin për të bërë deklarata *publike* bazuar pikërisht në frytet *publike* ose të jashtme të jetës së njerëzve.

Me fjalë të tjera, unë besoj se mund të themi pak më shumë për mëkatet që duhet të disiplinohen nga një kishë, përtej rasisht “kur mëkati kalon kufirin nga e pritshmja te e papritshmja”. Kjo na ndihmon për të vendosur një lloj standardi minimal edhe nëse teorikisht nuk është i pagabueshëm. Disiplina formale e kishës duhet të ushtrohet me mëkatet që janë *të dukshme, të rënda* dhe kur *nuk ka pendesë*.

Së pari, një mëkat duhet të ketë një shfaqje *të jashtme*. Kishat nuk duhet të ngrenë kartonin e kuq të dëbimit sa herë që dyshojnë për lakmi ose krenari në zemrën e dikujt. Duhet të jetë diçka që mund të shihet me sy ose të dëgjohet me veshë.

Së dyti, një mëkat duhet të jetë *i rëndë*. Një kishë dhe udhëheqësit e saj nuk duhet të ndjekin çdo mëkat në stërhollim. Duhet të ketë vend në jetën e një kishe ku dashuria “të mbulojë një shumicë mëkatesh” (1 Pjetrit 4:8). Fatmirësisht, Perëndia nuk na disiplinon në mënyrë të dukshme sa herë që mëkatojmë.

Së fundi, duhet të jetë e qartë që *nuk ka pendesë* për një mëkat të dhënë. Personi i përfshirë është përballur me urdhrat e Perëndisë në Shkrime, por ai ose ajo refuzon të heqë dorë nga mëkati. Me sa duket, personi e çmon mëkatin më shumë se Jezusin.

Pak a shumë, të tre këta faktorë duhet të jenë të pranishëm përpara se një kishë të shkojë drejt shkishërimit.

DISIPLINA E KISHËS

PSE KA QASJE TË NDRYSHME NGA JEZUSI DHE PALI?

Ka edhe një çështje tjetër të ngatërruar që duhet ta kemi parasysh në lidhje me kohën kur duhet ushtruar disiplina. Një guralec mund të fillojë një ortek pështjellimi, nëse nuk jemi të kujdesshëm. Kjo është pyetja pse qasja e Palit te 1 Korintasve 5 duket sikur është ndryshe nga qasja e Jezusit te Mateu 18.

Kujtojmë se, te 1 Korintasve 5, Pali qorton një kishë se kishte lejuar një mëkat “të tillë që as nuk zihet në gojë ndër paganë, saqë një shkon me gruan e babait të vet” (1 Korintasve 5:1). Ai nuk i thotë kishës që ta paralajmërojë këtë njeri për të parë nëse ai do të pendohet. Ai thjesht u thotë atyre që ta “heqin” atë njeri nga mesi i tyre (v. 2). Nuk lë vend për asnjë provë të pendimit. Nuk ka asnjë bisedë mes këtij burri dhe pleqve të kishës. Ka vetëm një thirrje për veprim të menjëherëshëm: “Nxirreni të ligun” nga mesi juaj (v. 13). Jezusi, nga ana tjetër, i këshilloi kishat që të parashtronin disa paralajmërime përgjatë rrugës drejt shkishërimit, ku secili paralajmërim paraqet një mundësi përgjatë procesit.

Tundimi është t’i shpjegojmë qasjet e ndryshme duke thënë se Jezusi dhe Pali kanë në mendje lloje të ndryshme mëkati, që do të thotë se ne nga ana tjetër duhet të ndjekim procese të ndryshme sipas llojit të mëkatis për të cilin bëhet fjalë. Jezusi përdor shembullin e një mëkati të zakonshëm mes njerëzve, ndërsa Pali përdor një mëkat të rëndë. Edhe ne duhet të miratojmë procesin e parë për gjërat më të vogla dhe procesin e dytë për gjërat më të rënda.

Shkrimtarët që kanë shkruar mbi temën e disiplinës kishtarë në shekujt e tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë ndonjëherë shkonin në këtë drejtim. Ata vunë re dy gjëra në

lidhje me rastin e 1 Korintasve 5: së pari, mëkati ishte një turp publik (“nuk zihet në gojë ndër paganë”); së dyti, thirrja e Palit për shkishërim të menjëhershëm — pa dhënë paralajmërime — sugjeron se, në atë çast, Pali nuk ishte i shqetësuar nëse ai njeri ishte penduar, përsëri, për shkak të natyrës skandaloze e të turpshme të mëkatit. Emri i Jezusit kishte vlerë më të madhe dhe, për këtë arsye, kisha duhej të vepronte për të ruajtur emrin e Krishtit, edhe nëse individi ishte penduar.

Pa mëdyshje, unë bashkohen me shqetësimin për emrin e Krishtit, siç duhet ta bëjë të qartë i gjithë kuadri im për t’iu qasur disiplinës. Por nuk më duket bindës ky shpjegim historik për disa arsye. Fillimisht, vendimi nëse do të shkishërohet varet nga standardet e botës, të cilat nuk janë të shenjta dhe janë gjithmonë në ndryshim e sipër. Turpi i një shoqërie është simbol nderi në një shoqëri tjetër (mendon për abortin ose homoseksualitetin). Gjithashtu, shkishërimi i njerëzve për të cilët një kishë beson se janë të penduar do të nënkuptonte dorëzimin e të krishterëve në mbretërinë e Satanait. A nuk do të ishte kjo e padrejtë për të krishterin dhe e pandershme para syve të botës? Kishat nuk duhet t’i shkishërojnë njerëzit për të cilët beson se janë të krishterë. Të bësh një gjë të tillë është në thelb legaliste, sepse i bën kriteret për anëtarësimin në kishë jo “pendim dhe besim”, por “pendim, besim dhe moskryerje të filan mëkati”.

Qasja e Palit te 1 Korintasve me siguri na hap një portë dalje që nuk është qartësisht e dukshme te Mateu 18 — dera e shkishërimit të menjëhershëm. Dhe kjo është me të vërtetë një derë që do ta përdorim më shpesh për mëkatet “vërtet të mëdha”. Por duhet të kujtojmë që të mos përqendrohemi verbërisht te

DISIPLINA E KISHËS

“rëndesa” e një mëkati. Mbani mend, vendimi për të shkuar drejt shkishërimit ka të bëjë gjithmonë me shqyrtimin e dinamikës midis mëkatit dhe qëndrimit të përgjithshëm pendestar të një personi. Nuk na nevojitet një peshore mëkati, por një ekuilibër midis mëkatit dhe pendimit. Në fund të fundit, të krishterët e penduar mëkatojnë. Pyetja është gjithmonë, pse ky mëkat do të kundërpeshonte mendimin tonë të pendimit të posaçëm dhe të përgjithshëm? Përgjigjja e kësaj pyetjeje kërkon që t’i shikojmë gjithmonë të dyja anët e ekuilibrit me ndjeshmëri baritore dhe sipas rrethanave.

Pra, cilat janë kriteret e shkishërimit të menjëhershëm? Një shqyrtim më i kujdesshëm i 1 Korintasve 5 dhe 6 do të na ndihmojë ta gjejmë përgjigjen. Merrni parasysh tekstet e mëposhtme:

5:1–2 Kudo po dëgjohet se ndër ju ka kurvëri, madje një kurvëri të tillë që as nuk zihet në gojë ndër paganë, saqë një shkon me gruan e babait të vet. Dhe ju u krekosët e madje nuk vajtuat, që të hiqet nga mesi juaj ai që ka kryer një punë të tillë.

5:4–5 Në emër të Zotit tonë Jezu Krisht, mbasi të mblidheni ju bashkë me frymën time, me fuqinë e Zotit tonë Jezu Krisht, vendosa që ti dorëzohet ky njeri në dorë të Satanit për prishjen e mishit, që t’i shpëtohet fryma në ditën e Zotit Jezus.

5:9–11 Ju kam shkruar në letër, të mos përziheni me kurvarë, dhe aspak me kurvarët e kësaj bote, ose me lakmuesit ose me cubat, ose me idhujtarët, sepse atëherë duhet të dilni nga bota. Por tani ju shkrova të mos përziheni me atë, të ashtuquajturin vëlla, që është kurvar, ose lakmues ose idhujtar, o shpifës, o pijanec ose cub; me një të tillë bile as të mos hani bashkë..

5:12 A nuk i gjykoni ju të brendshmit??

5:13 Prandaj nxirreni të ligun nga vetja juaj.

6:9–11 A nuk e dini ju se të padrejtët nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë? Mos u gënjeni: as kurvarët, as idhujtarët, as shkelësit e kurorës, as të zhburrëruarit, as homoseksualët, as vjedhësit, as lakmuesit, as pijanecët, as përqeshësit, as grabitësit nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë. Dhe të tillë ishit disa nga ju; por u latë, por u shenjtëruat, por u shfajësuar në emër të Zotit Jezus dhe me anë të Frymës së Perëndisë tonë.

Mëkati i këtij njeriu të 5:1 mund të jetë vërtet “turp publik” ose “vërtet i keq”, por nuk është kjo çështja. Përkundrazi, Pali po parashtron dy kategori njerëzish në këto tekste: ata që janë zakonisht të penduar dhe ata që nuk janë. Ata me një qasje të zakonshme pendese bëjnë pjesë brenda kishës; ata që nuk kanë një qasje të zakonshme pendese nuk janë pjesë e kishës, sepse nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë.

Mund të jetë më e lehtë për ta parë këtë, nëse zhvendosemi nga fundi në fillim nëpër tekstet e mësipërme. I fundit i tregon qartë dy kategoritë: janë “të padrejtët” që nuk do ta trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë dhe kisha, e cila përbëhet nga individë që janë ndryshuar: “Dhe të tillë ishit disa nga ju”. Nga ana e të padrejtëve, Pali nuk përshkruan thjesht mëkate të veçanta, ai përshkruan njerëz që *përkufizohen* nga ato mëkate. Ai nuk përdor mbiemra, por përdor emra: “kurvarët”, “shkelësit e kurorës”, “idhujtarët”, “shpifësit”, “pijanecët” dhe “grabitësit” (1 Korintasve 6:9– 11). Këto mëkate i karakterizojnë këta njerëz. Kështu janë ata. I njëjti karakterizim është i dukshëm në fjalinë e fundit të

DISIPLINA E KISHËS

kapitullit 5: “Prandaj nxirreni të ligun nga vetja juaj” (5:13). Ky njeri është “i lig”. Një person i tillë, thotë vargu që vjen pak para tij, nuk i përket kishës (5:12).

Nuk është e vështirë të kuptosh se Pali dëshiron t’i lidhë listat në kapitullin 5 dhe 6, përderisa rendit të njëjtat lloje mëkatarësh: kurvarët, shkelësit e kurorës, lakmitarët, idhujtarët, përqeshësit, pijanecët ose mashtruesit (5:9 –11). (Nuk duhet të mendojmë se kjo është një listë shteruese. Kapitulli 6 madje shton disa kategori të tjera. Është një listë tipike.) E theksoj, kisha nuk duhet të ketë përbashkësi me njerëz që janë vazhdimisht të papenduar: “Ju kam shkruar në letër, të mos përziheni me kurvarë” (v. 9).

Pikërisht nga ky lloj është edhe njeriu në kapitullin 5: vazhdimisht i papenduar. Ai duhet t’i dorëzohet Satanit për shkatërrimin e mishit të tij, sepse mishi i tij ia sundon jetën (5:5). Kisha nuk i ka dënuar veprimet e tij, por i ka miratuar (5:2). Megjithatë, ai është pa mëdyshje kurvar (5:1).

Me pak fjalë, Pali thotë që ky njeri të përjashtohet, sepse e karakterizon *mospendesa*. Shenjat e tanishme tregojnë se ai nuk do të trashëgojë mbretërinë e Perëndisë, dhe për këtë arsye, kisha duhet ta dëbojë tani, në mënyrë që shpirti i tij të paralajmërohet dhe të shpëtohet. A kishte Pali më shumë informacion se ne për këtë burrë? Ndoshta. Nuk është plotësisht e qartë për ne se si Pali arriti në këtë përfundim për atë njeri, por te ky përfundim doli: ai nuk është i krishterë. Ai është “i lig” (5:13). Ai i përket kategorisë së “të padrejtëve” (6:9).

Në këtë pikë, dallimet midis qasjes së Jezusit te Mateu 18 dhe qasjes së Palit te 1 Korintasve 5 duhet të jenë më të dukshme. Qëndrimet e Palit për këtë njeri fillojnë pak a shumë

aty ku përfundon procesi i Jezusit. Pali fillon me rastin e një mospendese të palëkundur. Prosesi i Jezusit është me qëllim që të përcaktohet nëse një person është apo jo i papenduar dhe këmbëngul në mospendesë – për të përcaktuar atë që Pali e merr si të kryer.

Një tjetër ndryshim mes dy pjesëve qëndron në faktin se sa gjerësisht njihet informacioni dhe sa dakordësi ka ndër njerëzit për këtë gjë. Tek Mateu 18, një person mendon se ka një mëkat, por më pas i duhen dy ose tre të tjerë që të pajtohen me të se ashtu është. Pas kësaj, ai ka nevojë që e gjithë kisha të pajtohet me atë qëndrim. Nga ana tjetër, te 1 Korintasve 5, e gjithë kisha e di se çfarë po ndodh. Përsëri e them, kjo pjesë fillon pikërisht aty ku përfundon Mateu 18.

Pra, kishat nuk duhet të trajtojnë thjesht mëkatet mesatare duke përdorur modelin e Mateut 18 dhe mëkatet vërtet të mëdha duke përdorur modelin 1 Korintasve 5. Përkundrazi, kishat duhet t'i shikojnë gjithmonë të dyja anët e baraspeshimit mes “mëkatit dhe penesës”. Edhe kur mëkati i një personi duket i madh, kisha ende duhet të bindet se personi është i papenduar dhe ngul këmbë në të vetën. Madje, një kishë mund të mos jetë e bindur në çastin kur zbulohet mëkati. Anëtarët ende mund ta ndjejnë nevojën për të bërë disa biseda dhe për t'i dhënë personit një nxitje ose paralajmërim.

Nuk është e vështirë të imagjinosh situata në të cilat një anëtar i kishës është fajtor për një nga mëkatet e renditura te 1 Korintasve 5 ose 6, por kisha vendos me të drejtë të zhvillojë një proces si te Mateu 18. Përfytyroni, për shembull, që dikush në kishën tuaj ka kryer një akt apo edhe akte të shumta dehjeje ose forma të ndryshme imoraliteti seksual. Unë besoj

DISIPLINA E KISHËS

se në disa raste ka mundësi për një sërë paralajmërimesh, si te Mateu 18, përpara se të ndodhë shkishërimi.

Atëherë, çfarë kuptojmë nga vëzhgimi i Palit: mëkati i këtij njeriu “nuk lejohet as nga paganët”? Nuk mund të mohohet se mëkati i këtij njeriu është turp i madh publik, por për mua fjalët e Palit tingëllojnë si një goditje tronditëse në kokë që synon t’i zgjojë korintasit. Nuk po e shohin atë që duhet ta shohin lehtë dhe qartë. Fjalët e Palit nuk tingëllojnë si ato të një teologu që përpiket të krijojë një kategori krejt të veçantë mëkati që i ndryshon të gjitha rregullat për anëtarësimin në kishë dhe shkishërimin. Nëse do të ishte ashtu, mendoj se do të parashtronte më shumë se një shprehje të shkëputur.

NJË RRËFIM PENDESE QË S’MUND T’I ZËSH BESË

Ja edhe një mënyrë tjetër për të parë të gjithë rastin te 1 Korintasve 5. Pa dyshim, disa mëkate janë aq të qëllimshme (siç është një model i tejzgatur abuzimi ose vrasjeje) ose të papranueshme (si sulmet seksuale, plaçkitja ose zhvatja) saqë fjalët e shpejta për të kërkuar falje do të ishin të pabesueshme. Jo se mëkate të tilla nuk mund të falen, apo se një person mund të mos pendohet menjëherë. Por duhet të kalojë pak kohë dhe fryti i pendimit të shfaqet bindshëm përpara se kisha të mund të shpallë me përgjegjësi faljen (shih shembullin te Veprat e Apostujve 8:17–24). Një kishë nuk mund t’i besojë me përgjegjësi fjalët e një anëtari që ka jetuar me dashje në një mëkat të vazhdueshëm. Mund të themi se natyra e disa mëkateve “ia pamundëson” një kishë të vazhdojë të pohojë apo pranojë qëndrimin e përgjithshëm pendestar të personit, dhe kisha nuk ka zgjedhje tjetër veçse ta zhbëjë pohimin e saj

të paktën për një kohë. Mëkati rëndon shumë në anën e vet të peshores duke e ulur atë poshtë dhe duke e zhvlerësuar dëshminë e pendimit. Të gjitha provat pozitive minohen menjëherë, sepse mëkati përfshin kaq shumë mashtrime.

Ka disa mëkate që me të vërtetë nuk do të prisnim t'i bënte një i krishterë. Dhe t'i bësh ato do të thotë që dikush ndoshta nuk është i krishterë, ose të paktën kështu do ta trajtojë kisha individin, derisa të fitohet edhe një herë besimi i kishës. Ndoshta Pali e shikonte në këtë mënyrë një burrë që flinte me gruan e babait të tij.

Vite më parë jam takuar rregullisht me një të ri, i cili vitin e kaluar, siç mora vesh, ishte arrestuar për një formë të turpshme të veprimtarisë kriminale. Madje doli edhe në lajmet vendore. Ai ishte përfshirë fshehurazi në këtë veprimtari për më shumë se një vit, ndërsa shërbente aktivisht në kishën e tij. Kur kisha mësoi për mëkatin e këtij burri nëpërmjet arrestimit të tij, veproi me shpejtësi për ta hequr nga anëtarësia. Ky burrë qante dhe thoshte se i vinte keq, por ngaqë kishte bërë një jetë të dyfishtë të papranueshme, kisha nuk mund t'u besonte fjalëve të tij për pendim, të paktën për ca kohë. Kisha zgjodhi të vinte në provë pendimin e tij jo përpara aktit të shkishërimit, por më pas. Unë besoj se kisha kishte të drejtë ta bënte këtë. Veprimi i këtij burri ishte një kërcënim si për delet e tjera, ashtu edhe për dëshminë e Krishtit në botë, duke e bërë të gjithë gjënë edhe më të ngutshme. Kisha kishte të drejtë ta disiplinonte me shpejtësi, sepse "të padrejtët nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë" (1 Korintasve 6:9).

Në fund të fundit, unë besoj se ndërthurja e Mateut 18 dhe 1 Korintasve 5 jep idenë që kishat duhet të arrijnë në një

DISIPLINA E KISHËS

nga tre përfundimet e mëposhtme përpara se të vendosin se është koha për të vepruar:

- Kur një kishë bindet se një person është vërtet i penduar, nuk duhet të vazhdojë me asnjë formë disipline (dhe nuk mund të mendojë për as edhe një përjashtim nga ky parim).
- Kur një kishë bindet se një person dallohet për mospendesë të vazhdueshme (jo vetëm çështje e përkohshme), duhet të vazhdojë me shkishërimin.
- Kur një mëkat është aq i qëllimshëm, i neveritshëm dhe tregues i një dyfytirësie të rëndë, saqë kjo ia bën të pamundur kishës ta pohojë a pranojë rrëfimin e pendesës, të paktën derisa të kalojë ca kohë dhe të rifitohet besimi, kisha duhet të vazhdojë me shkishërim, duke vendosur për të vënë në provë pendesën pas shkishërimit.

DËLIRËSI APO SKAMJE NË FRYMË

Nëse disiplina e kishës është mënyra e duhur e veprimit sa herë që një përfaqësues i Jezusit nuk arrin ta përfaqësojë, a duhet që kishat të presin përsosmëri morale?

Në disa aspekte, ky është pikërisht standardi që shpall Jezusi. Tek Mateu 5, ai na thotë se drejtësia e një të krishteri duhet ta tejkalojë atë të skribëve dhe farisenjve, përndryshe ai ose ajo nuk do të hyjë kurrë në mbretërinë e qiejve (Mateu 5:20). Më vonë në atë kapitull, ai na thotë se një i krishterë duhet të jetë i përsosur siç është i përsosur Ati qiellor (v. 48). Kishat duhet të përpiqen ta përfaqësojnë përsosmërinë e Jezusit me të vërtetë dhe më së miri!

Por Jezusi ishte edhe shumë realist dhe i kuptueshëm, prandaj Mateu 5 fillon me të ëmblat lumturi:

Lum skamësit në frymë, sepse e tyre është mbretëria e qiejve.

Lum ata që vajtojnë, sepse ata do të ngushëllohen.

Lum ata që janë zemërbutë, sepse ata do ta trashëgojnë tokën.

Lum ata që janë të uritur dhe të etur për drejtësi, sepse ata do të ngopen.

Lum ata që janë të mëshirshëm, sepse ata do të gjejnë mëshirë.

Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse ata do ta shohin
Perëndinë.

Lum ata që përpiqen për paqen, sepse ata do të quhen bij të
Perëndisë.

Lum ata që janë përndjekur për hir të drejtësisë, sepse e tyre është
mbretëria e qiejve (Mateu 5:3-10).

Kush e përfaqëson mbretërinë e qiejve në tokë? Kush do ta shohë Perëndinë dhe do të quhet bir i Perëndisë? Në një farë kuptimi, janë ata që duken dhe veprojnë si Ati i tyre qiellor, siç bëjnë përgjithësisht bijtë. Edhe Ati hyjnor edhe Biri hyjnor janë të mëshirshëm, me zemër të pastër dhe paqebërës. Dhe Biri hyjnor u përndoq për hir të drejtësisë. Kishat, gjithashtu, duhet të kërkojnë t'i njohin e shpallin bijtë që i mishërojnë të gjitha këto gjëra. Por në një botë mëkatare, bijtë e Perëndisë janë njëkohësisht edhe ata që e njohin skamjen a varfërinë e tyre frymërore, që vajtojnë për mëkatën e tyre, që me butësi heqin dorë nga kërkesat e tyre dhe që janë të uritur dhe të etur për drejtësi, e cila ata e dinë mirë se u mungon. Prandaj, kishat nuk duhet të habiten sa herë që anëtarët e tyre që përfaqësojnë Jezusin mëkatojnë; por duhet të jenë thellësisht të kujdesshëm ndaj qëndrimit të anëtarëve ndaj mëkatit. A vajtojnë? A kanë uri dhe etje për drejtësi?

Me fjalë të tjera, përfaqësuesit e vërtetë të Jezusit do të

njihen për dy gjëra: gjithnjë e më të pastër dhe gjithnjë e më të varfër në frymë mes papastërtisë së mbetur (shih gjithashtu 2 Korintasve 7:11). Kishat, në punën e tyre për ushtrimin e çelësave të mbretërisë, duhet t'i kërkojnë të dyja këto.

Një herë i kërкова këshillë ish-pastorit tim se si të mbaja qëndrim ndaj një miku që kishte ndërmarrë hapa praktik drejt një lidhje kurorëshkelëse. Fatmirësisht, u kap në kohë, para se të kryhej plotësisht. Pastori im më këshilloi: “Nuk është për t’u habitur që ky njeri u tundua drejt këtij mëkati. Pyetja e vërtetë është, si do të jetë qëndrimi i tij ndaj qortimit tënd? Është pikërisht përgjigjja e tij ndaj korrigjimit që do të zbulojë se ku qëndron vërtet zemra e tij”.

SI E USHTRON DISIPLINËN KISHA?

Disiplina zyrtare publike funksionon më mirë në një kulturë kishtarë ku disiplina joformale dhe private mirëpritet dhe praktikohet. Nëse përpiqeni të flakëroni shpatën e madhe dhe të mprehtë të shkishërimit përpara se anëtarët ta kuptojnë nevojën e tyre të përgjithshme për të qenë të përgjegjshëm e llogaridhënës ndaj njëri-tjetrit, ju po kërkonit luftë.

Përgjegjshmëria a llogaridhënia brenda një kishe janë rrjedhojë e natyrshme e ungjillit dhe kjo llogaridhënie duhet të praktikohet pa përjashtim në gjithë jetën e një kishe, si publikisht ashtu edhe privatisht. Por kur njerëzit nuk janë mësuar të japin llogari për mëkatin e tyre, sigurisht që është më e lehtë të fillohet me llogaridhënien private sesa me atë publike.

Llogaridhënia publike duhet të jetë një rezultat i asaj që po ndodh tashmë në jetën private të anëtarëve të kishës.

Unë kam një mik pastor që po përpiqej t'i bindte pleqtë e tjerë që të sillnin një rast disipline përpara kishës. Një burrë e kishte lënë gruan e tij, por pleqtë nuk ishin të sigurt nëse kisha ishte gati të përjashtonte dikë, dhe kështu lëvizën ngadalë — ndoshta shumë ngadalë. Kur pleqtë më në fund rekomanduan

DISIPLINA E KISHËS

shkishërimin, në thelb kisha u përgjigj: “Ka ardhur koha. Ne e dinim se duhej të bënim diçka në këto raste”. Me fjalë të tjera, pleqtë kishin bërë një punë të mirë për të ushqyer kulturën e duhur për disiplinë brenda kishës.

Disiplina formale e kishës funksionon më mirë kur anëtarët tashmë dinë të korrigjojnë dhe të pranojnë korrigjim me dashuri. Ata e bëjnë këtë gjë në shtëpitë e tyre. E bëjnë gjatë drekës. E bëjnë me butësi, me kujdes dhe gjithmonë duke pasur parasysh të mirën e personit tjetër. Ata nuk parashtrojnë fjalë korrigjuese me egoizëm - vetëm për të “hequr përgjegjësinë e vet”.

Këtu kemi pesë parime të tjera për mënyrën e ushtrimit të disiplinës së kishës, bazuar në atë që shohim në Dhiatën e Re.

PROCESI DUHET TË PËRFSHIJË SA MË PAK NJERËZ TË JETË E MUNDUR

Një parim i qartë që del nga Mateu 18:15–20 është se Jezusi dëshiron që procesi i korrigjimit të mëkatit të përfshijë sa më pak njerëz, por mjaftueshëm sipas nevojës për të sjellë pendim. Nëse një takim kokë më kokë sjell pendim, mirë. Nëse duhen dy ose tre të tjerë, atëherë lëreni me kaq. Një çështje duhet t’i parashtrohet gjithë kishës vetëm kur të gjitha rrugët e tjera janë shteruar.

Procesi i Mateu 18, natyrisht, jep idenë se mëkati në fjalë nuk njihet nga një rreth i gjerë, tani për tani. Mëkatet që janë tashmë publike nga natyra, si në 1 Korintasve 5, mund të kërkojnë që udhëheqësit e kishës t’i thonë diçka të gjithë kishës. Një situatë e ngjashme vërehet te Filipianëve 4, kur Pali, përpara gjithë kishës, i lutet Evodisë dhe Sintikës që të pajtohen me njëra-tjetrën (Filipianëve 4:2–3). Me sa duket, kisha e dinte tashmë për mosmarrëveshjen.

Ndonjëherë, mëkati ka pasoja publike që duhet të trajtohen publikisht, edhe nëse privatisht individit dëshmon se është penduar. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur një grua mbetet shtatzënë jashtë martese. Udhëheqësit e kishës mund ta përcaktojnë nëse ajo dhe partneri i saj (nëse ai është në kishë) janë vërtet të penduar dhe për këtë arsye të mos shkojnë drejt disiplinës formale. Prapëseprapë, mund ta trajtojnë çështjen me butësi me kishën (1) në mënyrë që të mund të mësojnë pozitivisht për një pikëpamje të krishterë për seksualitetin përtej dhe kundrejt shembullit të çiftit dhe (2) në mënyrë që udhëheqësit të mund të dëshmojnë për hirin e Perëndisë në pendimin e çiftit, duke i bërë thirrje edhe kishës që t'i përqafojë e t'u shërbejë çiftit dhe fëmijës së tyre. Të pëlqen apo jo, duke mos thënë asgjë në një situatë të tillë, i mëson kishës se mëkati nuk është gjë e madhe, dhe e lë kishën të hamendësojë dhe të përgojojë çiftin. Madje, të mos thuash asgjë, mund të krijojë mosbesim dhe përçarje.

Dy përparësitë që mbështetin parimin e mbajtjes së procesit të disiplinës me sa më pak njerëz janë dëshira për pendimin e mëkatarit dhe dëshira për të mbrojtur emrin e Jezusit.

PROCESIN DUHET TA UDHËHEQIN UDHËHEQËSIT E KISHËS

Mëkati është mashtues dhe i koklavitur. Prandaj, jo pa arsye Pali shkruan: “Vëllezër, në qoftë se dikush bie në ndonjë faj, ju që jeni frymëror, lartësojeni me frymë butësie. Por ki kujdes veten tënde, se mos tundohesh edhe ti” (Galatasve 6:1). Pali e di se delet më të reja mund të mashtrohen lehtësisht, ose të tundohen, ose të bashkohen me mëkatarin në mëkat, ose të paktën të binden nga argumentet e mëkatarit se përse mëkati

DISIPLINA E KISHËS

është i pranueshëm. Prandaj, Pali i përgjërohet “frymërorit” që të prijë në këtë aksion shpëtimi.

Kur Pali thotë “ju që jeni frymëror” nuk do të thotë domosdoshmërisht pleqtë e kishës, përndryshe do të kishte thënë “ju pleqtë”. Kjo jep idenë që anëtarët bëjnë mirë të përfshijnë vëllezër dhe motra më të mëdhenj dhe më të urtë në besim, kur një takim fillestar kokë më kokë nuk jep fryt. Në përgjithësi, ndoshta do të jenë pleqtë e kishës ata që thirren për këshillë dhe më pas për të udhëhequr procesin e disiplinës, veçanërisht kur procesi zgjerohet në qarqe gjithnjë e më të gjera.

Përderisa Perëndia ua ka dhënë pleqve mbikëqyrjen e të gjithë kishës, sigurisht që do të rekomandoja që çdo mëkat që paraqitet përpara gjithë kishës duhet së pari t’u paraqitet pleqve.

KOHËZGJATJA E PROCESIT VARET NGA SA KOHË DUHET PËR T’U BINDUR SE KA MOSPENDESE TË VAZHDUESHME

Një nga pyetjet më të vështira në ushtrimin e disiplinës me siguri duhet të jetë, a është tani koha për të vazhduar drejt nivelit tjetër? Ndonjëherë Shkrimi e paraqet procesin e disiplinës si të ngadalshëm, siç është Mateu 18, i cili kërkon të paktën tre paralajmërime përpara se një person të shkishërohet. Ndonjëherë e paraqet atë si lëvizje të shpejtë, si në 1 Korintasve 5 ku Pali bën thirrje për largim të menjëhershëm. Dhe më pas është Titit 3:10, i cili duket sikur është diku në mes. Ai kërkon dy paralajmërime përpara se të vijohet drejt përjashtimit.

Siç e pamë në kapitullin 3, ndryshimi kryesor midis Mateut 18 dhe 1 Korintasve 5 është se përfaqësojnë dy faza të ndryshme në procesin e përgjithshëm të shkishërimit. Letra e Parë drejtuar Korintasve kapitulli 5, fillon aty ku mbaron Mateu

18, me përcaktimin e mospendesës karakterizuese ndaj një mëkati apo një modeli mëkati që është i njohur nga e gjithë kisha. Kur një kishë e përcakton dhe bindet se një individ është i papenduar dhe vijon i tillë, kjo duhet të pasohet me shkishërim.

Prandaj, nga pikëpamja teorike, është mjaft e thjeshtë të përshkruhet se sa duhet të zgjasë procesi i disiplinës: sado kohë që i duhet kishës për të arritur në përfundimin se një individ e karakterizon mospendesa. Anëtarët e kishës mund të shikojnë provat dhe të arrijnë në përfundimin brenda një minute. Ata mund të kalojnë muaj duke shoshitur provat dhe duke u përfshirë në biseda të panumërta në përpjekje për të arritur në një bindje të qartë dhe një mendje të përbashkët. Pyetja “sa kohë” nuk është e vështirë për arsye teorike; është e vështirë për arsye të jetës reale. Ne nuk mund t’i shohim zemrat e njerëzve dhe e ndiejmë barrën për të qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm sa herë që na kërkohet t’i shqyrtojmë frytet dhe të vendosim për një çështje aq të rëndësishme siç është bindja e kishës nëse mund të vazhdojë të dëshmojë se dikush i përket mbretërisë së Perëndisë. Është për të qeshur se, meqenëse mëkatet e përmasave mesatare nuk peshojnë aq shumë kundrejt anës së pendimit të peshores, procesi priret të ecë më ngadalë. Merrni si shembull varësinë nga substancat. Nuk e zhbën menjëherë rrëfimin e besimit të një personi, por ngre një pikëpyetje dhe e vendos kishën në pozitën e nevojës për të bërë punën e ngadaltë dhe të kujdesshme të provës për pendim. Ky është një mësim tjetër që mund të mësojmë nga zgjerimi i rrethit që paraqet Jezusi te Mateu 18. Sa herë që rrethi i njerëzve të përfshirë bëhet pak më i gjerë, mëkatari ballafaqohet edhe një herë me pyetjen: “A je i sigurt se ende dëshiron të rrih rob i këtij mëkati?”

DISIPLINA E KISHËS

Njerëzit ndonjëherë mund ta mashtrojnë veten duke besuar se mund të përqafojnë edhe Jezusin *edhe* mëkatin e tyre të parapëlqyer. Duhet disa përballje në përshkallëzim për t'i ndihmuar ata të kuptojnë: “Jo, nuk mundem më. Është ose njëra, ose tjetra”.

Disa vargje përpara udhëzimit të Jezusit te Mateu 18 rreth disiplinës kishtare, ai na jep si ndihmë për të përcaktuar nëse një individ karakterizohet nga mospendesa: a do të ishte i gatshëm personi të priste një dorë ose të nxirrte një sy në vend që të përsëriste mëkatin (Mateu 18:8–9)? Pra, a është personi i gatshëm të bëjë gjithçka që duhet për të luftuar kundër mëkatit? Njerëzit e penduar, zakonisht, janë të zellshëm e të gatshëm për ta flakur tej mëkatin e tyre. Këtë e bën Fryma e Perëndisë brenda tyre. Kur kjo të ndodhë, mund të pritet të shihet një gatishmëri për të pranuar këshilla nga jashtë. Do të ketë një gatishmëri për të prishur rehatinë e orareve të tyre, një gatishmëri për të rrëfyer gjëra të sikletshme, një gatishmëri për të bërë sakrifica financiare ose për të humbur miq ose për t'u dhënë fund marrëdhënieve të dëmshme.

Nga ana tjetër, sa më i madh ose më i hapur të jetë mëkati ose modeli i mëkatit, aq më shumë peshon kundër anës së pendimit në peshore.¹ Kjo e zhvlerëson më shpejt rrëfimin e besimit nga ana e këtij personi dhe mund ta shtyjë kishën të veprojë më shpejt. Ka një ndryshim, për shembull, midis zbulimit se dikush po shkel kurorën bashkëshortore në mënyrë

1 Çfarë është një mëkat “më i madh”? Është një mëkat i cili e shkatërron më shpejt dhe më dukshëm mëkatarin, kishën, emrin e Jezusit dhe të tjerët më tej. Për shembull, tjetërsimi dhe vjedhja e shumave të mëdha bën më shumë dëm sesa vjedhja e një artikulli në dyqan. Nga ana tjetër, vrasja bën më shumë dëm sesa tjetërsimi dhe vjedhja e shumave të mëdha.

të vazhdueshme dhe zbulimit se dikush ka varësi ndaj alkoolit. Të dyja mëkatet do ta minojnë besueshmërinë e rrëfimit të besimit të një personi, por, guxoj të them, që mëkati i parë do ta bëjë këtë më shpejt se i dyti.

Në mënyrë tipike, mëkatet më të mëdha shoqërohen nga një formë rreziku ose një tjetër, duke e bërë të gjithë situatën më të ngutshme. Ekziston rreziku i skandalit publik dhe dëmit që mund t'i bëhet emrit të Krishtit (1 Korintasve 5). Ekziston rreziku i ndarjes dhe dëmit që mund t'i bëhet kishës (Titit 3:10). Ekziston rreziku i mësimave të rreme dhe, përsëri, dëmi që mund t'i bëhet kishës, veçanërisht deleve më të dobëta (shih 1 Timoteut 1:20; 2 e Gjonit 10–11). Tani, një kishë nuk duhet të shkojë drejt shkishërimit vetëm për shkak të rreziqeve, por prania e rrezikut tregon seriozitetin e mëkatit dhe dëshmon se përse kisha nuk duhet të pohojë e pranojë më rrëfimin e besimit të një personi. Kjo do të thotë se rreziku (dëmtimi i emrit të Krishtit; kërcënimi i ndarjes ose mësimi i rremë; dëmtimi i deleve të tjera) nuk duhet parë si *bazë* e disiplinës, por është një *dëshmi* përforcuese që e nxit kishën drejt një akti të shpejtë disiplinimi në rrjedhën e duhur të veprimit. Kjo duhet ta rritë ndjesinë e ngutjes për një kishë, në mënyrë që mbledhjet dhe shqyrtimet e nevojshme të bëhen më shpejt.

Shkurtimisht, kohëzgjatja e procesit përcaktohet tërësisht nga koha që duhet për të bindur palët e përfshira se një person është i penduar ose i papenduar. Kisha duhet të shqyrtojë rrethanat e mëkatit në njërën anë të peshores dhe të gjitha provat e tjera të pendimit në anën tjetër. Ndonjëherë do të shfaqen informacione të reja që do ta lëvizin peshoren në një drejtim ose në tjetrin. Por kur kisha është e bindur se i ka të gjitha informacionet

DISIPLINA E KISHËS

përkatëse në të dyja anët e peshores dhe se peshorja nuk po lëviz më, ajo është e thirrur të veprojë në drejtim të cilësdo anë që është më e rëndë. Ky proces mund të zgjatë një minutë, ose edhe një vit.

INDIVIDËVE DUHET T’U JEPET E DREJTA E MUNDËSISË SË PAFAJËSISË

Siç e kemi vërejtur tashmë, Jezusi përshkruan një proces gjyqësor të kujdesshëm te Mateu 18: “që çdo akuzë të mund të vërtetohet nga dëshmitë e dy ose tre dëshmitarëve” (v. 16). Akuzat duhen vërtetuar. Duhet të paraqiten dëshmi. Dëshmitarët duhet të përfshihen. Kjo do të thotë që të krishterët lëvizin ngadalë dhe me kujdes, por do të thotë gjithashtu se kishat duhet t’u qasen çështjeve të disiplinës me parimin e sallës së gjyqit “i pafajshëm derisa të provohet fajësia”.

Ky parim nuk zbatohet vetëm në çështjet e disiplinës formale, por ndikon edhe në mënyrën se si një i krishterë duhet të përballlet me një vëlla ose motër veçmas. Njerëzve duhet t’u jepet e drejta e mundësisë së pafajësisë. Akuzat duhet të paraqiten me pyetje. Duhet kërkuar qartësi përpara se të shprehemi me siguri.

Në fushën e disiplinës, si në çdo fushë të jetës, “çdo njeri të jetë i shpejtë në të dëgjuar, i ngadalshëm në të folur dhe i ngadalshëm në zemërim” (Jakobi 1:19).

UDHËHEQËSIT DUHET TA PËRFSHIJNË DHE UDHËZOJNË KISHËN

Traditat e grupimeve të ndryshme kishtare kanë mënyra të ndryshme për të përfshirë të gjithë kishën në procesin e disiplinës formale. Unë personalisht rekomandoj përfshirjen

e kishës si një parim biblik, bazuar te Mateu 18 (ku Jezusi e përfshin “kishën”) dhe 1 Korintasve 5 (ku Pali udhëzon të gjithë kishën të marrë përgjegjësinë). Por për ata që ende nuk janë të bindur nga analiza ekzegjetike e këtyre pjesëve, prapëseprapë, rekomandoj të kërkojnë mënyra për ta përfshirë kishën, sepse ky është një mandat teologjik dhe baritor. Teologjikisht, Pali i thotë çdo pjese të trupit që të ketë dhembshuri dhe të bëhet një me përvojat e çdo pjese tjetër të trupit, qofshin këta anëtarë që gëzojnë apo anëtarë që vajtojnë (1 Korintasve 12:21–26; shih Efesianëve 4:16). Disiplina e kishës, veçanërisht në fazat e saj përfundimtare, është një ngjarje thellësisht domethënëse në jetën e një trupi, dhe, në sajë të bashkimit e lidhjes sonë të përbashkët në Krishtin, çdo anëtar është pjesë e saj. Nga ana baritore, është një ngjarje e rëndësishme, pjesë e së cilës duhet të bëhet patjetër çdo anëtar. Të gjithë do të mësojnë. Të gjithë do të paralajmërohen dhe nxiten. Të gjithë mund të kenë diçka për të dhënë.

Në ato kisha që ka vendimmarrje me votë kishë, kishës do t'i kërkohet të votojë (në disa kontekste) ose të arrijë në një konsensus (në kontekste të tjera) mbi aktin përfundimtar të shkishërimit, një aktivitet që duket se ka një shembull paraprak në Shkrimin e Shenjtë. Vini re fjalën “shumicë” te 2 Korintasve 2:6.

Në kisha të tjera, ku vendimmarrja është ndryshe, kishës mund të mos i kërkohet të përfshihet në vendimin përfundimtar për të përjashtuar një anëtar, por udhëheqësit e kishës të çdo lloj qasjeje (besoj) duhet ta përfshijnë kishën në të paktën katër mënyra të tjera. Së pari, udhëheqësit e kishës duhet t'ia “tregojnë kishës” përpara se të përjashtojnë dikë (Mateu 18:17).

DISIPLINA E KISHËS

Duke e marrë me mend se një anëtar nuk është në një situatë që kërkon largim të menjëhershëm, Jezusi duket se parashikon një kalim kohe midis informimit të kishës dhe aktit përfundimtar të heqjes së anëtarësisë: “ ... thuaja kishës; dhe në qoftë se refuzon edhe ta dëgjojë kishën, le të jetë për ty...”. Me sa duket, ky hap u jep anëtarëve të kishës, të cilët tashmë kanë një marrëdhënie me individin e papenduar, mundësinë për ta dalluar pendimin e tij ose të saj. Për më tepër, kjo e përgatit kishën për aktin përfundimtar të largimit, nëse ndodh. Kjo u jep atyre një mundësi për të vepruar dhe për të bërë pyetje përpara se të shpallet një vendim përfundimtar.

Së dyti, udhëheqësit e kishës duhet t’i tregojnë kishës pasi të disiplinojnë dikë (nëse nuk e kanë përfshirë kishën në vendim, gjë që mendoj se duhet ta bëjnë). Kisha duhet të informohet për vendimin për të përjashtuar një individ (nëse nuk është e përfshirë). Shkrimi u thotë të krishterëve se marrëdhëniet e tyre duhet të ndryshojnë dukshëm me individët e përjashtuar (siç jepen hollësi në pikën tjetër); prandaj, besimtarëve duhet t’u thuhet për përjashtimin e një individi.

Së treti, udhëheqësit e kishës duhet ta udhëzojnë dhe ta baritojnë kishën se si t’i shikojnë vendimet e tanishme ose aktet e mundshme të shkishërimit. Të krishterët e rinj shpesh janë të ndjeshëm ndaj simpatie naive dhe ndoshta edhe të gabuara (siç i thoshte ndonjëherë Perëndia popullit të Izraelit). Udhëheqësit i ndihmojnë ata të mos pengohen duke shpjeguar tekstet përkatëse biblike dhe duke qenë shembull se si duket një person me dhembshuri e zemërthyerje, por edhe i zjarrtë për të vërtetën.

Në këtë drejtim, udhëheqësit duhet të udhëzojnë gjithashtu anëtarët se si të ndërveprojnë me një individ që është përjashtuar.

Dhiata e Re e trajton këtë çështje në një sërë pjesësh të Shkrimit (1 Korintasve 5:9, 11; 2 Thesalonikasve 3:6, 14–15; 2 Timoteut 3:5; Titit 3:10; 2 Gjonit 10). Këshilla bazë që japin pleqtë e kishës sime është se prirja e përgjithshme e marrëdhënieve të dikujt me individin e disiplinuar duhet të ndryshojë dukshëm. Ndërveprimet nuk duhet të karakterizohen nga e zakonta dhe normalja, por nga biseda të qëllimshme rreth pendimit. Sigurisht që anëtarët e familjes duhet të vazhdojnë të përmbushin detyrimet familjare (shih Efesianëve 6:1–3; 1 Timoteut 5:8; 1 Pjetrit. 3:1–2).

Së katërti, udhëheqësit duhet t'i udhëheqin kishat drejt lutjes dhe shpresës së pendimit, gati për ta pranuar dhe për t'u pajtuar me mëkatarin. Dhe një udhëheqje e tillë ndodh përmes mësimi të kujdesshëm dhe shembullit vetjak. Nuk duhet të ketë asnjë dyshim në mendjen e ndokujt se si udhëheqësit ashtu edhe kisha në tërësi janë zemërthyer dhe nuk duan asgjë më shumë se pajtimin me anëtarin e përjashtuar.

QASJA E NJË KISHE

Lexuesit mund ta kenë vënë re se unë nuk kam dhënë një përvijim hap pas hapi për t'iu qasur një situatë të disiplinës kishtare. Pjesërisht kjo është për shkak se Shkrimi ofron disa mënyra për t'iu qasur disiplinës formale. Pjesërisht kjo vjen për shkak se politika të ndryshme kishtare përcaktojnë masa të ndryshme. Pjesërisht, kjo ndodh sepse udhëheqësit e kishës duhet të përdorin mençurinë për të dalluar se cilat parime shkrimore lidhen me këtë gjë dhe janë të zbatueshme.

Megjithatë, mund të shpjegoj se si funksionon procesi në kishën time. Në përgjithësi, ne ndjekim modelin e përcaktuar

DISIPLINA E KISHËS

te Mateu 18. Individëve u është mësuar që të fillojnë duke i trajtuar çështjet veçmas. Nëse nuk ka pendim kur takohen veç e veç, një plak ose ca pleq duhet të përfshihen, fillimisht individualisht dhe përfundimisht si një grup i tërë. Ndonjëherë pala fajtoare takohet me të gjithë pleqtë, megjithëse individët nuk janë gjithmonë të gatshëm ta bëjnë këtë. Më pas, pleqtë kalojnë mbase disa ditë apo edhe deri në disa muaj duke diskutuar nëse do ta çojnë çështjen para kishës. Nëse vendosin ta informojnë kishën, paraqesin informacionin përkatës vetëm në një takim privat të anëtarëve. Ata përmendin individin dhe përcaktojnë kategorinë e mëkatit pa dhënë shumë hollësi. Pleqtë shpjegojnë çdo çështje shtesë që është me vend për të synuar pendimin e individit dhe e nxitin kishën që të kërkojë me lutje pendimin e anëtarit. Ata shpjegojnë se, nëse asgjë nuk ndryshon në këtë situatë, ka shumë të ngjarë që pleqtë të shkojnë drejt shkishërimit të këtij individ në mbledhjen e ardhshme të anëtarëve, e cila zakonisht është dy muaj më vonë. Pastaj pleqtë mirëpresin pyetje nga anëtarët. Nëse ndodh mbledhja e radhës e anëtarëve dhe nëse pleqtë këmbëngulin në planin e tyre për ta përjashtuar individin, ata bëjnë një rekomandim për shkishërim, pyesin nëse ka ndonjë pyetje dhe vijnë me votim nga anëtarët. Nëse anëtarët votojnë për ta shkishëruar individin, më pas pleqtë e udhëzojnë kishën se si të ndërveprojnë me anëtarin tashmë të përjashtuar.

Nëse procesi zhvillohet saktësisht kështu, gjithmonë kërkojmë të zbatojmë parimet e mëposhtme:

- 1) Procesi duhet të përfshijë sa më pak njerëz që të jetë e mundur për të sjellë pendim.

- 2) Kur procesi shkon përtej një ose disa personave, udhëheqësit e kishës duhet ta udhëheqin procesin.
- 3) Kohëzgjatja e procesit varet nga koha e nevojshme për të vërtetuar se një person është i papenduar.
- 4) Individët duhet të kenë të drejtën e mundësisë së pafajësisë derisa provat të tregojnë të kundërtën.
- 5) Udhëheqësit duhet ta përfshijnë dhe ta udhëzojnë kishën sipas nevojës.

SI NDODH RIMËKËMBJA?

Nëse disiplina formale e kishës nënkupton heqjen nga anëtarësia e kishës dhe nga Darka e Zotit, çfarë përfshin rimëkëmbja? Dhe kur ndodh? Këto janë dy pyetjet që po shqyrtojmë tani: çfarë? dhe kur?

ÇFARË ËSHTË RIMËKËMBJA?

Pasi një person është përjashtuar nga kisha, rimëkëmbja është thjesht deklarata e kishës që shpall falje ndaj personit dhe ripohon shtetësinë e tij ose të saj në mbretërinë e Perëndisë.

Në letrën e dytë të Palit drejtuar kishës së Korintit, ai trajton një rast tjetër të disiplinës së kishës, por këtë herë ai përshkruan se si duket rimëkëmbja. Nuk jepen hollësi të mëkatit, por rimëkëmbja përshkruhet në këtë mënyrë:

Mjaft është për atë njeri ndëshkimi që iu bë nga shumica, por tani, përkundrazi, ju duhet më tepër ta falni atë dhe ta ngushëlloni, që ai njeri të mos gëlltitet nga trishtimi i tepërt. Prandaj ju lutem t'i shfaqni dashuri (2 Korintasve 2:6–8).

Shumica e kishës ishte pajtuar për ta ndëshkuar individin. Tani, Pali po u thotë atyre që ta falin, ta ngushëllojnë dhe ta ripohojnë dashurinë e tyre për të.

DISIPLINA E KISHËS

Thirrja për të falur individin, për më tepër, të kujton fjalët e Jezusit në Ungjillin e Gjonit, të cilat pranëvendosen me fjalët e tij për çelësat tek Ungjilli i Mateut: “Kujt do t’ia falni mëkatet, do t’i jenë falur, kujt do t’ia mbani, do t’i jenë mbajtur” (Gjoni 20:23). Jo shumë kohë pas kësaj deklarate, Jezusi e rimënkëmbi Pjetrin (Gjoni 21:15–17).

Kur një kishë vendos të rimënkëmbë e rikthejë një individ të penduar në përbashkësinë e saj dhe në Darkën e Zotit, nuk duhet të flitet më për një periudhë prove ose nënshtetësi të dorës së dytë. Përkundrazi, kisha duhet ta shpallë publikisht faljen e saj (Gjoni 20:23), ta pohojë dashurinë e saj për individin e penduar (2 Korintasve 2:8) dhe të festojë, ashtu siç festoi babai i birit plëngprishës (Luka 15:24).

Kisha ime dikur shkishëroi një individ për një situatë të ndërlikuar që përfshinte një sjellje pandershmërie të thellë dhe pa asnjë pendesë nga personi. Falë Zotit, erdhi një kohë kur u pendua dhe kisha ishte në gjendje të shpallte faljen e saj dhe personi të ripohonte përbashkësinë e saj me të. Ky është propozimi që pleqtë i parashtuan kishës:

Propozim: Pleqtë rekomandojnë me gëzim që anëtarët të pranojnë me mirënjohje ndaj Zotit pendimin e vëllait tonë, që t’i shprehim zyrtarisht faljen tonë për veprimet e tij ndaj nesh dhe që të rishpallim publikisht shprehjen tonë të përbashkësisë me të dhe dashurinë për të si vëllai ynë në Krishtin. Dhe ne i bëjmë të gjitha këto me falënderim të madh ndaj Perëndisë për besnikërinë e tij ndaj Fjalës së tij dhe ndaj atyre që e nderojnë atë me bindjen e tyre.

Kisha e pohoi njëzëri. Ishte një rast gëzimi.

A do të thotë domosdoshmërisht që rimëkëmbja e rikthimi janë përfshirje edhe një herë në anëtarësinë e kishës? Në shumicën e rrethanave, unë do të thosha “po”. Pendimi i nevojshëm për rikthim do të tregohet, ndër të tjera, nga një gatishmëri për t’u ribashkuar me një kishë dhe për t’iu nënshtuar mbikëqyrjes së saj. Por në fund të fundit besoj se rimëkëmbja është si puna e pagëzimit. Pagëzimi, zakonisht, por jo domosdoshmërisht, është përfshirje në anëtarësinë e një kishë (mendon për eunukun etiopas te Veprat e Apostujve 8:38–39). Rimëkëmbja, në të njëjtën mënyrë, zakonisht, por jo domosdoshmërisht, do të thotë rikthim në anëtarësinë e një kishë. Individit në shembullin që solla unë, në fakt, jetonte në një vend tjetër, kur kisha votoi propozimin e mësipërm. Ai i kishte dërguar një letër kishës, kishte rrëfyer mëkatën e tij dhe kishte pyetur se çfarë mund të bënte për të rivendosur marrëdhënien. Pas disa shkëmbimesh, ky propozim ishte përfundimi i çështjes.

KUR DUHET TË NDODHË RIMËKËMBJA?

Kur duhet të bëhet rimëkëmbja e personit në një kishë? Përgjigjja e thjeshtë është, kur mëkatari pendohet dhe kisha është e bindur se pendimi është i vërtetë, sepse anëtarët shohin fryte në jetën e individit. Rimëkëmbja ndodh kur kisha është e gatshme të qëndrojë edhe një herë përpara kombeve dhe të garantojë për besimin e individit.

Ndonjëherë dëshmia e pendimit është bardh e zi: një burrë që ka braktisur gruan kthehet. Ndonjëherë provat do të mbeten disi gri: një person i kapur në një cikël varësie mund të mos jetë plotësisht fitimtar mbi varësinë, por ka shumë më tepër fitore

DISIPLINA E KISHËS

tani sesa në të kaluarën, dhe ka një zell të ri në luftimin e asaj varësie.

Provat e nevojshme për pendim do të duken ndryshe nga mëkati në mëkat dhe nuk do të jetë gjithmonë e lehtë të dallos nëse pendimi është i vërtetë. Pleqtë e kishës sime dikur u përballën me një dilemë të tillë. Një individ të cilin kisha e kishte disiplinuar po tregonte disa prova pendimi, por jepte edhe shenja se zemra e tij ishte ende e ngurtë. Ndërsa pleqtë diskutonin nëse do t'i rekomandonin kishës rimëkëmbjen e këtij njeriu, të gjithë mund t'i shihnim të dyja anët dhe të gjithë e ndiem peshën e fjalëve të Palit për të mos e lënë këtë burrë të pushtohej nga pikëllimi i tepërt. Në votimin përfundimtar, shtatë votuan kundër rimëkëmbjes ndërsa gjashtë të tjerë votuan pro.

Është e mundur, pa dyshim, që ne si pleq të kemi bërë gabim, ashtu si çdo vendim që merr një njeri apo një kishë mund të jetë gabim. Por anëtarët si të shumicës ashtu edhe të pakicës i besuan Perëndisë se do të vepronte përmes diskutimeve tona të papërsosura dhe disi të ndara. Falënderimi i takon Perëndisë që përdor grupe pleqsh që provojnë të bëjnë diçka dhe procese të gabueshme si tonat.

Mençuria në vlerësimin e provave të pendimit kërkon baraspeshimin e kujdesit me dhembshurinë. Dhe kjo do të thotë që procesi shpesh duhet të vazhdojë ngadalë — por jo shumë ngadalë. Në kapitullin 3 tregova historinë e një miku tim që u shkishërua nga kisha e tij për një formë të turpshme të veprimtarisë kriminale. Falë Zotit, ai hoqi dorë menjëherë nga aktiviteti kriminal, pasi u zbulua, e kjo ishte shenjë e mirë. Por mëkatet e tjera të lidhura me atë gjë vijuan, e kjo

ishte shenjë e keqe. Ai ishte i gatshëm të takohej me dy nga pleqtë e kishës dhjetëra herë për këshillim — shenjë e mirë. Por pjesëmarrja e tij në kishë dhe këshillimi ishin të rralla — shenjë e keqe. Deri në momentin e shkrimit të këtij kapitulli, pastorët e kishës po punojnë për të baraspeshuar kujdesin me dhembshurinë, për të ecur ngadalë, por jo shumë ngadalë. Pastori kryesor i kësaj kishe më shkroi kohët e fundit: “Ne kemi ende shpresë se Zoti do ta rimëkëmbë! Patëm shpresuar se do të ndodhte më shpejt, për të mos e dëshpëruar atë. Por nuk kemi mundur të ecim aq shpejt sa do të dëshironim. Ju lutemi, lutuni që ai ta kërkojë me zell Zotin”.

Siç thashë më herët, do të ishte mirë të kishim një libër rregullash për raste si këto: “Kur përballeni me këtë, bëni atë”. Por duket se Zoti synon që kishat e tij të mësojnë se çfarë do të thotë t’i besosh urtësisë që ai premton të japë edhe në dilemat më të vështira, duke na kujtuar edhe një herë se sa të varur jemi prej Tij.

A KANË LIDHJE KISHAT E TJERA?

Ka një pyetje të fundit që ia vlen të merret parasysh kur bëhet fjalë për disiplinën dhe rimëkëmbjen. A janë të lidhura kishat e tjera me vendimin e një kishe për të shkishëruar një individ? Pra, a mund ta marrë një kishë si anëtar dikë që është disiplinuar nga një kishë tjetër?

Traditat e ndryshme të grup-kishave të ndryshme i përgjigjen kësaj pyetjeje ndryshe. Disa tradita ekzistojnë, pjesërisht, të bazuara në bindjen se kisha institucionale shtrihet përtej kishës vendore, pikërisht në mënyrë që një gjë e tillë të mos ndodhë. Veprimet dhe vendimet e një peshkopi duhet të konsiderohen si të detyrueshme, në një farë mase, nga një peshkop tjetër.

DISIPLINA E KISHËS

Por nuk janë vetëm katolikët romakë dhe anglikanët për të cilët kjo është e vërtetë. Disa baptistë kanë argumentuar se, kur një kishë e shkishëron një individ, individit është ende nën autoritetin e asaj kishe, të paktën derisa të zhbëjë vendimin. Ndërkohë, një kishë tjetër baptiste nuk duhet të uzurpojë autoritetin e kishës së parë duke e pranuar individin si anëtar.

Sipas vlerësimit tim, ky argument është i gabuar. Kishat kanë autoritetin për të pritur individë të disiplinuar nga një kishë tjetër. Mund të mos tregohen të urtë nëse e bëjnë. Dhe me siguri do të ishin të mençur po të hetonin veprimin e kishës së parë. Por në analizën e fundit, Jezusi i ka dhënë çdo kishe autoritetin e çelësave për të lidhur dhe zgjidhur, dhe vendimet e një kishe nuk janë të detyrueshme për një tjetër.

Kur një kishë shkishëron dikë, ajo ia dorëzon Satanit (1 Korintasve 5:5). Kjo do të thotë, heq pohimin e saj se individit i përket mbretërisë së Perëndisë, ku sundon autoriteti shëlbues i Perëndisë. Përkundrazi, ajo deklaron se personi duhet t'i përkasë mbretërisë së Satanit, ku sundon Satani (Mateu 4:8–9; Gjoni 12:31; 14:30). Dhe kisha nuk ka më shumë autoritet mbi anëtarin e shkishëruar sesa ka mbi çdo jo të krishterë tjetër në mbretërinë e Satanit. Prandaj, Jezusi thotë ta trajtoni atë si një që nuk i përket bashkësisë së besëlidhjes së Perëndisë¹, “le të jetë për ty si pagan ose tagrambledhës (Mateu 18:17).

¹ Por a nuk duhet që t'i trajtojnë individët e disiplinuar ndryshe nga jo të krishterët (p.sh., “me një të tillë bile as të mos hani bashkë” (1 Korintasve 5:11)? Po. A nuk është kjo një formë e autoritetit të vazhdueshëm? Jo. Është një formë autoriteti që ushtrohet mbi vetë anëtarët e kishës, ashtu si një nënë u thotë fëmijëve të saj të mos shoqërohen me një turmë të caktuar në shkollë. Autoriteti është mbi fëmijët, jo mbi turmën e gabuar. Duke u thënë anëtarëve të saj që të mos shoqërohen me një anëtar të shkishëruar, kisha po i mbron anëtarët e vet dhe po shpall se rrëfimi i besimit nga ana e atij individit është mashtrim.

A po rekomandoj që kishat të veprojnë plotësisht në mënyrë autonome nga njëra-tjetra? Aspak. Kishat e Dhiatës së Re janë qartësisht të ndërruar. Ato kujdesen që kishave të tjera t'u plotësohen nevojat, të marrin mësim të mira dhe të punojnë së bashku për të vërtetën (shih Veprat e Apostujve 11:28–30; Kolosianëve 4:16; 3 Gjonit 5–8). Ato gjithashtu paralajmërojnë njëra-tjetrën për mësues të rremë dhe personazhe të pakëndshëm (1 Gjonit 4:1–3; 3 Gjonit 9–10). Një pjesë e një ndërrarësie të tillë duhet të përfshijë ndihmën e ndërsjellë në pranimin dhe largimin e anëtarëve. Prandaj, bisedat ndërmjet kishave për çështje disipline duhet të ndodhin herë pas here dhe brenda kufijve të maturisë. Por në të njëjtën kohë, çdo kishë është përfundimisht përgjegjëse përpara Zotit për të marrë vendimet e veta.

Pjesa 2

**ZBATIMI I KORNIZËS:
RASTE STUDIMORE**

Unë i kam krijuar “rastet studimore” të mëposhtme duke përdorur elementë të situatave të jetës së përditshme me të cilat jam përfshirë, ose të paktën për të cilat kam dëgjuar. Edhe aty ku përdor elementë të jetës së përditshme, i kam ndryshuar hollësitë në mënyra të ndryshme, duke përfshirë përdorimin e personazheve përgjithësues të “Xhoit” dhe “Xhillit”.

Për të shmangur përsëritjen dhe për të kursyer hapësirë, kam lënë mënjatë shpjegimet e hollësishme, por e drejtoj lexuesin te kapitulli në të cilin shtjelloj parimin që po zbatohet. Referenca do të shfaqet në kllapë, si p.sh., (kap. 3) ose (hyrje).

Nuk e marr si të mirëqenë se vendimet e marra në vijim përfaqësojnë gjithmonë “fjalën e fundit”. Disa prej tyre mund të jenë të gabuara. Megjithatë, ato përfaqësojnë përpjekjen më të mirë të kishës sime ose të një kishë tjetër për të zbatuar kornizën e ungjillit të përshkruar në kapitujt 1 deri në 4.

Çdo skenar përshkruhet në kontekstin e një modeli kishë të udhëhequr nga pleqtë. Kjo do të thotë se pleqtë e udhëheqin procesin e disiplinës sapo të arrijë një nivel të caktuar, por kisha ka fjalën e fundit në përcaktimin nëse shkishërimi duhet të ndodhë, i cili realizohet me votim, vetëm në një mbledhje anëtarësh.

KURORËSHKELËSI

SITUATA

Xhoi ishte përfshirë në mënyrë aktive në shërbimin e përkujdesjes në kishën e tij, madje duke ndihmuar në udhëheqjen e kësaj shërbese. Miqtë e tij të ngushtë, të cilët ishin pleq në kishë, kishin filluar të bisedonin me Xhoin për dyshimet e tij në lidhje me besimin e krishterë. Një ditë, gruaja e Xhoit foli me një nga pleqtë dhe i tha se Xhoi, së fundmi, ishte përfshirë në të paktën një lidhje jashtëmartesore, ndoshta edhe më shumë se një. Dy pleq u takuan me të disa herë veçmas, si për tradhtinë bashkëshortore ashtu edhe për dyshimet, por pa dobi. Xhoi pranoi se veprimet e tij ishin “të gabuara”, por përgjigjet e tij ndaj pyetjeve nëse ai do të vazhdonte të takohet me gruan tjetër ishin të mjegullta dhe të paqarta. Disa javë më vonë, Xhoi u tha dy pleqve se po e linte gruan e tij dhe se kishte kryer punë me martesën e tij. Brenda disa ditësh, ai u largua.

A duhet shkishëruar Xhoi? Nëse po, sa shpejt?

VLERËSIMI I MËKATIT

Tradhtia bashkëshortore është një mëkat i rëndë që e vë menjëherë në dyshim besimin e një personi. Disa mund të

DISIPLINA E KISHËS

thonë se e minon atë plotësisht. Është një akt i rëndësishëm tradhtie që edhe jo të krishterët zakonisht e shohin si të gabuar, siç dëshmohet nga fakti se politikanët ndonjëherë humbasin detyrën, nëse kapen në tradhti bashkëshortore. Tradhtia bashkëshortore e keqpërfaqëson Jezusin rëndë, e Ai nuk ka qenë kurrë jobesnik ndaj nuses së tij. Tradhtia bashkëshortore shkatërron martesat, fëmijët, kishat dhe miqësitë.

Me fjalë të tjera, tradhtia bashkëshortore nuk është një mëkat në të cilin një individ bie në mënyrë naive ose pa vetëdije. Është një mëkat moskokëçarës dhe i qëllimshëm, që zbulon një zemër shumë të ngurtë dhe të vetë-mashtruar. Nuk është e paimagjinueshme që, në disa rrethana, tradhtia bashkëshortore mund të çojë në shkishërim të menjëherëshëm. Ky do të ishte rasti, për shembull, nëse do të bëhej shpejt e qartë se kishte pasur një marrëdhënie të tillë të vazhdueshme, dhe jo një rast i shkëputur, ose nëse do të ishte menjëherë e dukshme se individi dëshiron të vazhdojë me atë mëkat.

VLERËSIMI I PENDIMIT

Nëse një kurorëshkelës kapet, siç ishte rasti i Xhoit, mund të pritët që ai të përgjigjet duke u vetëmbrojtur, të paktën në fillim, edhe nëse është i krishterë. Në fund të fundit, zemra duhet të jetë bërë shumë e ngurtë, përderisa ka shkuar kaq larg. Megjithatë, zemra e një të krishteri duhet të shkrihet mjaft shpejt, kur përballet për imoralitetin seksual, ndoshta brenda disa ditësh, e pse jo brenda disa orësh. Është e pritshme që një kurorëshkelës i penduar të karakterizohet, sipas fjalëve të Palit, nga pikëllimi i perëndishëm dhe i sinqertë, gatishmëria

për t'u shkëputur nga mëkati, indinjata ndaj mëkatit, frika, malli, zelli dhe shumë ndjesi të tjera (2 Korintasve 7:11).).

Megjithatë, që në fillim, Xhoi ishte i mjegullt. Nuk ishte e qartë se donte të vijonte me mëkatin, por nuk ishte e qartë as se donte të hiqte dorë prej tij. Në dy javët e para, kur vetëm disa pleq e dinin për situatën, Xhoi dukej se ishte i pavendosur se cilën rrugë do të zgjidhte. Për këtë arsye, ata zgjodhën të mos vepronin menjëherë.

FAKTORË TË TJERË

Edhe dyshimet e Xhoit për besimin luajtën një faktor në vendimin e pleqve për të mos vepruar menjëherë. Ai madje kishte filluar të luante me idenë se nuk ishte i krishterë, gjë që do të kishte ndikuar në mënyrën se si ata do ta trajtonin situatën (shih dallimin që bën Pali midis shoqërimit me kurvarët në botë dhe me kurvarin “të ashtuquajturin vëlla”, 1 Korintasve 5:9–11). Ata menduan se dyshimet dhe kurorëshkelja ishin të lidhura, por nuk ishte e qartë se cila erdhi e para.

VENDIMI

Sapo Xhoi njoftoi se po e prishte martesën dhe tregoi vendosmërinë e tij duke u larguar, pleqtë e dalluan dhe përcaktuan se ai karakterizohej nga mospendesa (kap. 3). Xhoi ishte paralajmëruar vazhdimisht, por ishte i vendosur të ndiqte mëkatin e tij dhe jo Jezusin. Ai e dinte se çfarë po bënte. Prandaj, të dy pleqtë hodhën hapin, me mbështetjen e gjithë bordit të pleqve, për shkishërimin e menjëhershëm të Xhoit (kap. 3 dhe 4). Trupi i kishës e miratoi.

AI QË KA VARËSI

SITUATA

Xhilli kishte varësi kumarin. Ajo ishte rritur në një shtëpi ku prindërit e saj luanin kumar e bixhoz për zbavitje dhe nuk kishin pasur kurrë ndonjë pasojë të madhe. Ata madje i jepnin asaj edhe lek xhepi për lojërat e fatit në udhëtimet familjare në Las Vegas. Por në kolegji, lojërat e fatit për Xhillin u bënë si gangrenë. Ajo shkonte në kazino. Iu bashkua disa grupeve të kumarit e bixhozit në internet. Kishte aplikacione për kumar e bixhoz në celularin e saj.

Kur Xhilli u bë e krishterë, pas kolegjit, e pakësoi lojën e kumarit në mënyrë dramatike, kryesisht sepse ajo ishte e shpërqendruar nga besimi i saj i ri. Më pas, më shumë se një vit më vonë, filloi të luante më shpesh kumar e bixhoz. Në fillim, miqtë e saj të krishterë, edhe vetë disi të papjekur, i shihnin historitë e saj të lojërave të fatit si humor, por nuk kaloi shumë kohë para se të kuptonin se ajo kishte një problem të madh. Njëri prej tyre u përball drejtpërdrejt me Xhillin dhe ajo e pranoi se kumari apo bixhozi mund të ishin problem i madh, nëse bëhej në mënyrë të papërgjegjshme, por u shpreh se e kishte këtë gjë nën kontroll.

Shpejt, Xhilli u martua. Brenda një viti, loja e kumarit për

DISIPLINA E KISHËS

Xhillin po bëhej çështja përcaktuese në martesë. Në fillim, kaloi në mbrojtje, kur burri i saj u përball me të, duke i vënë atij në dukje mëkatën e tij dhe faktin se ai kishte vënë para në lojërat e basketbollit në kolegji, kur ata ishin të lidhur. Por pas një episodi të keq të humbjes së disa mijëra dollarëve, ajo u pendua; pranoi se i kishte sëmundje lojërat e fatit dhe vendosi të hiqte dorë. Miq nga kisha u përfshinë për llogaridhënie.

Kaluan muaj. Përgjegjësia dhe llogaridhënia ishte e rreptë në fillim, por më pas u dobësua. Xhilli filloi të luante përsëri kumar dhe problemi u përshkallëzua shpejt. Për herë të parë që doli jashtë, ajo rrezikoi me baste të larta dhe humbi një shumë parash më të madhe se kurrë më parë. Të nesërmen u përpoq të nxirrte veten nga gropa duke vënë baste edhe më shumë, por ra edhe më thellë. Kjo u pasua me një thyerje tjetër që përfshiu lot dhe premtime të reja, madje edhe premtimin për të zhvilluar takime me këshilltarin e kishës. Por, në muajt në vijim, cikli u përsërit disa herë.

Më në fund, një natë, një nga pleqtë e kishës mori një telefonatë nga bashkëshorti i Xhillit: Xhilli ishte ndaluar nga policia pas një sherri në gjendje të dehur me një oficer policie jashtë detyrës. Ajo kishte qenë në një kazino, kishte humbur mijëra dollarë, ndihej e mjeruar, kërkoi ngushëllim te alkooli, u bë luf-tarake dhe përfundoi duke e goditur me grushte oficerin, i cili po përpiqej ta qetësonte. Ai nuk e kishte arrestuar, por e kishte vendosur në “zonën e ndalimit” të kazinosë dhe i kërkoi të shoqit ta merrte.

Të nesërmen në mëngjes, Xhilli ishte tmerrësisht e tur-përuar, në dukje e penduar, por edhe paksa vetëmbrojtëse. Ishte e turpshme, po, por një pjesë e saj donte të thoshte se ky

mëkat nuk ishte aq i keq. Ajo arsyetonte se përderisa kazinotë kishin një “zonë ndalimi” ishte dëshmi se mëkati i saj ishte mjaft i zakonshëm. Përveç kësaj, oficeri tregoi mëshirë për të; a nuk do të bënin të njëjtën gjë edhe miqtë e saj të krishterë? A duhet që një kishë të shkishërojë një si puna e Xhillit që ka varësi dhe tregon disa shenja pendimi për të dhe pasojat e saj?

VLERËSIMI I MËKATIT

Të krishterët mund të mos pajtohen nëse bastet e vogla prej një ose dy dollarësh janë mëkat. Por shumica e të krishterëve do të pajtoheshin se vënia e basteve në shuma më të mëdha parash, sidomos në mënyrë të zakonshme, është një administrim i dobët i burimeve që Perëndia na ka dhënë. Është shumë e sigurt se ky lloj zakoni nxitet nga një dëshirë idhujtarie, për të marrë diçka pa dhënë asgjë. Për më tepër, një zakon i tillë ka shumë të ngjarë ta pengojë një të krishterë që të japë bujarisht për kishën ose për nevojtarët. Dhe sigurisht që tregon një dështim për ta dashur të afërmin si veten (kush do ta nxiste të afërmin e tij të luante kumar me shuma të mëdha parash?).

Mëkati i Xhillit ishte qartësisht i vazhdueshëm dhe robërues. Ndjenja e rrezikut ishte argëtuese, por edhe siguronte një arratisje nga realiteti dhe e bënte të ndihej e rëndësishme (ajo e pranoi vetë këtë gjë), sikur fitimi i basteve tregonte pushtetin e saj mbi rastësinë dhe mbi botën. Është e qartë se ajo kishte krijuar një idhull me ndjesinë e mposhtjes së rrezikut, si dhe për të marrë diçka pa i kushtuar asgjë. Po aq shqetësues, në mos edhe më shumë, ishte fakti që Xhilli kërkoi strehim tek dehja, kur idhulli numër 1 e la në baltë. Për më tepër, natyra publike e dehjes së saj dhe sjellja e saj e

DISIPLINA E KISHËS

dhunshme tregonin se ajo kishte një mungesë të plotë të respektit për dëshminë e saj të krishterë dhe një zemër mjaft të ngurtësuar.

VLERËSIMI I PENDIMIT

Në kohën e telefonatës, procesi i disiplinës ndaj Xhillit kishte vite që vijonte. Paralajmërimet ia kishin bërë. Strukturat e llogaridhënies ishin krijuar, por Xhili i shpërfilli të gjitha. Ndonjëherë dukej e penduar, por në mënyrë të përsëritur i kthehej mëkatit të saj, si një qen që kthehet te të vjellat e tij (Fjalët e Urta 26:11). Çdo herë e më shumë, problemi dukej se përkeqësohej, si demoni që dëbohet vetëm për t'u kthyer me shtatë vëllezër (Mateu 12:44–45).

Falë Zotit, Xhili kishte vendosur shpeshherë ta luftonte mëkatën e saj dhe premtoi ta bënte këtë pas këtij episodi më të fundit. Të nesërmen, ajo ndiente shumë keqardhje. Por, kur pleqtë e diskutuan çështjen, u ffilluan se nuk duhej patjetër një zemër e rilindur për të pasur keqardhje për një mbrëmje ku humbi mijëra dollarë, u deh, goditi një oficer policie dhe u ndalua.

Tri hollësi dukeshin veçanërisht shqetësuese: natyra e përshkallëzuar e lojërave të fatit, ajo që zbuloi episodi më i fundit i dehjes dhe i grindjeve publike për ngurtësinë e zemrës së saj, dhe fakti që premtimet e saj për të ndryshuar ishin premtime që të gjithë i kishin dëgjuar më parë. Një nga pleqtë e përshkroi episodin si “fija e fundit”. Dhe të gjithë pleqtë u pajtuan se fjalët e saj nuk ishin më të besueshme (kapitujt 3 dhe 4). Asnjë nga strukturat “normale” të llogaridhënies

dhe këshillimit baritor nuk kishin dhënë fryt dhe gjërat po përkeqësoheshin.

Edhe burri i saj aq pak u besonte fjalëve të saj për pendesë në këtë pikë, saqë u tha pleqve se do ta mbështeste vendimin për ta shkishëruar gruan e tij, jo sepse nuk e donte atë, por pikërisht sepse e donte (hyrja).

VENDIMI

Mbrëmjen e së dielës pas telefonatës së policit, pleqtë rekomanduan shkishërimin e menjëhershëm të Xhillit për shkak të bixhozit robërues dhe dehjes publike. Ishte hera e parë që shumë njerëz në kishë po dëgjonin për të dhe disa pyesnin veten nëse një paralajmërim nga e gjithë kisha do të kishte qenë më i mirë përpara shkishërimit. Por pleqtë shpjeguan se modeli i tejzgjatur i ngjarjeve, i shenjuar nga natyra mjaft e turpshme e grindjes së saj në gjendje të dehur me një oficer policie, e vendosi kishën në një pozicion pamundësie për ta pohuar e pranuar pendesën e Xhillit, pa e cenuar integritetin e tyre, të paktën për një periudhë kohe. (kap. 3). Shpresojmë që të jetë në gjendje ta tregojë pendimin e saj në muajt në vijim, kohë në të cilën ata mund të ripranojë me gëzim dhe me përgjegjësi rrëfimin e saj për besim (kap. 5).

Bashkëshorti i Xhillit kërkoi qëllimisht për të marrë pjesë në mbledhjen e anëtarëve. Ai donte që kisha të dinte se ai i mbështeste pleqtë. Ai gjithashtu donte që Xhilli ta dinte se ai bashkoej me vendimin e kishës, në mënyrë që asgjë të mos minonte fuqinë e sinjalit që do t'i dërgonte gruas së tij një akt shkishërimi.

Kisha votoi për të hequr Xhillin nga anëtarësia me vetëm një votë kundërshtuese.

SHKELËSI I LIGJIT

QË DEL NË LAJME

SITUATA

Pleqtë dhe kisha morën vesh të martën në mëngjes nga lajmet vendore se Xhoi ishte arrestuar me akuzën se kishte vjedhur nga kompania e tij. Gjatë pesë viteve, thuhet në raportin e lajmeve, Xhoi kishte arritur të vidhte disa qindra mijëra dollarë. Xhoi u vetëshpall i pafajshëm, si para gjykatës, ashtu edhe në një bisedë private me një plak kishe.

A kërkon natyra publike e mëkatit të Xhoit që kisha ta shkishërojë atë menjëherë?

VLERËSIMI I MËKATIT

Të vjedhësh qindra mijëra dollarë gjatë disa viteve ndërsa je anëtar i kishës tregon vendosmëri të thellë në mëkatin e dikujt dhe një zemër thellësisht të ngurtësuar dhe të pander-shme. Një mëkat i tillë është i qëllimshëm dhe shumë i rëndë.

VLERËSIMI I PENDIMIT

Nën dritën e qëllimshmërisë së mëkatit, kohëzgjatjes së tij dhe natyrës së tij të dyfishtë, një kishë mund të vendosë në

DISIPLINA E KISHËS

mënyrë të arsyeshme se nuk është në gjendje ta pohojë dhe miratojë rrëfimin për besim të një individi kësisoj, dhe për këtë arsye, mund të ndër marrë hapin e shkishërimit të menjëhershëm. Një individ i tillë *mund* të pendohet, por kisha do ta kishte të vështirë të përcaktonte nëse ishte penduar me të vërtetë. Me shumë gjasa, mëkati i përvetësimit dhe dyfytërsia që e shoqëruan do të tregonin për mospendesë të vazhdueshme (kap. 3 dhe 4).

Por kjo analizë e merr si të mirëqenë se Xhoi ishte fajtor, por ai u vetëshpall i pafajshëm. Për më tepër, gjykata nuk kishte vendosur ende. Pleqtë nuk donin që të merrnin një vendim gjyqësor si kishë pa qenë të informuar sa gjykata (kap. 1). Aq më pak do të donin të shkishëronin një njeri që gjykata mund ta shpallte të pafajshëm në fund të procesit.

VENDIMI

Meqenëse kisha e dinte tashmë situatën nga gazetatat, pleqtë e dinin se do t'u duhej t'i thoshin diçka kishës. Prandaj, pleqtë u pajtuan mbi këto pika:

- 1) të presin vendimin e gjykatës përpara se të bëjnë një rekomandim zyrtar;
- 2) t'i thonë kishës se kjo ishte mënyra e tyre e veprimit;
- 3) t'i bënin thirrje kishës për t'u lutur dhe për të treguar dashuri për Xhoi dhe familjen e tij gjatë kësaj kohe;
- 4) madje e nxitën privatisht Xhoi që të vazhdonte të merrte pjesë në mbledhjet e Ditës së Zotit, por, nëse e dinte se ishte fajtor, të mos merrte pjesë në Darkën e Zotit. Ata menduan se, nëse ishte fajtor, do ta shpërfillte këtë këshillë, por gjithsesi kishin nevojë t'ia parashtronin atij.

KALLAMI I THYER

SITUATA

Xhilli u rrit nga një nënë e pamartuar, e cila kishte shumë partnerë, disa prej të cilëve e kishin keqtrajtuar atë dhe Xhillin. Me dëshirën e madhe për një figurë të qëndrueshme mashkullore, Xhilli, gjithashtu, krijoi një model në adoleshencën e hershme duke kryer marrëdhënie me burra dhe duke i lejuar që ta përdornin keqas. Ajo zhvilloi edhe sjellje të vetëprerjes dhe bulimisë.

Në kolegji, Xhilli gjeti miq në një grup studentor të krishterë, të cilët dukej se kujdeseshin për të. Diku gjatë rrugës ajo filloi ta quante veten e krishterë dhe u pagëzua. Kisha e saj e predikonte ungjillin, por pjesa më e madhe e predikimit ishte e cekët dhe kisha mundësonte pak ose aspak llogaridhënie. Shumica e të pranishmëve, përfshirë edhe Xhillin, mbetën të panjohur dhe të papërfshirë. Xhilli shpejt u kthye në sjelljet e saj të vjetra të mëkatit seksual dhe vetëprerjes.

Pas kolegjit, filloi të shkonte në një kishë të re ku mësohej me besnikëri Bibla dhe theksohej anëtarësimi. Ajo u anëtarësua. Mbeti kryesisht në periferi të kishës së re, por u bashkua me një grup të vogël me gra të tjera ku, me kalimin e kohës, e

DISIPLINA E KISHËS

kuptoi dhe e pranoi se sa e vetmuar ishte dhe, disi për habinë e saj, rrëfeu mëkatën e saj seksual.

Një ditë, mbërriti në zyrën e pastorit së bashku me një anëtare të grupit të vogël mbështetës dhe rrëfeu me lot në një nivel të frikshëm të aktivitetit seksual gjatë periudhës disa mujore.

A duhet të shkishërohet Xhilli? A duhet të peshojnë rrethanat e prejardhjes së saj në vendim?

VLERËSIMI I MËKATIT

Në përgjithësi, kurvëria e vë në pikëpyetje rrëfimin e besimit për një të krishterë, veçanërisht kur kurvëria ka qenë sjellje e vazhdueshme ose mënyrë jetese, siç kishte qenë puna me Xhillin. Në ditët e para si e krishterë, nuk e kishte ditur me shumë qartësi se kjo gjë ishte e gabuar, por kisha e saj nuk dukej se e merrte seriozisht mëkatën. Udhëheqësi i grupit studentor bënte shaka të rastësishme dhe anëtarët e tjerë të grupit studentor kishin sjellje jo të hijshme. Ajo i përdori këto gjëra si përligje për të ngurtësuar ndërgjegjen e saj.

Megjithatë, në kishën e re, pati një rritje në vetëdije për hipokrizinë dhe rëndesën e mëkatit të saj. E prapëseprapë, sjelljet seksuale dhe nevojat emocionale kishin qenë të thella. Vetëprerja i jepte një ndjenjë të përkohshme shfajësimi nga faji i mëkatit seksual.

VLERËSIMI I PENDIMIT

Sado shqetësues të ishte modeli i mëkatit të Xhillit, hapat e saj të parë të pendimit ishin shpresëdhënëse (kap. 3). Së pari, ajo vetë e nxori mëkatën në dritë; nuk u zbulua nga dikush

tjetër. Së dyti, ajo i kishte thënë grupit të saj të vogël dhe më pas, me turp të madh në vetvete, një pastori të cilin e njihnte vetëm pak dhe të cilin e respektonte nga larg. Së treti, ra dakord me kërkesën e tij që të takohej me një këshillues nga kisha. Së katërti, tha se do të parapëlqente që ai të mos u tregonte pleqve, por do të respektonte vendimin e tij, nëse ai do të vendoste për ta bërë këtë gjë, duke e ditur se do të vepronte për të mirën e saj. Përmes gjithë kësaj gjëje, Xhilli nuk dukej vetëmbrojtëse (kap. 3). Dukej se vajtonte vërtet për të kaluarën dhe dëshironte një të ardhme ndryshe.

Vetëprerja ishte shqetësuese, sepse shfaqte një kuptim të dobët të ungjillit. Megjithatë, vendosmëria e saj për t'i nxjerrë në dritë si prerjen ashtu edhe mëkatin seksual, pavarësisht se sa do t'i kushtonte, fliste shumë për pendimin e saj.

FAKTORË TË TJERA

Prejardhja familjare e Xhillit luajti një rol shumë të madh në mënyrën se si pastori e vlerësoi këtë situatë. Nëse një grua që ishte rritur në kishë dhe në një familje të shëndoshë dhe që kishte qenë aktive në shërbimin e kishës do të kishte rrëfyer këtë nivel mëkati, vlerësimi i tij mund të kishte qenë ndryshe.

VENDIMI

Pastori vendosi t'ia paraqesë situatën të gjithë bordit të pleqve, por nuk do të rekomandonte shkishërim. Ai ua tregoi historinë e Xhillit edhe për t'u siguruar për përgjigjen e tij, por edhe që pleqtë të dinin më mirë se si të kujdeseshin për këtë kallam të thyer e të lënduar. Asnjë veprim zyrtar nuk u ndërmor.

ANËTARI QË MUNGON

SITUATA

Xhoi iu bashkua kishës në janar, për gjashtë muaj mori pjesë në takime në mënyrë të çrregullt dhe më pas filloi të mos vinte më fare. Gjatë kohës që mori pjesë, vinte vonë në kishë, largohej herët dhe nuk krijoi asnjë marrëdhënie me njerëzit. Një plak kishe arriti të hante drekë me të në shkurt dhe u përpoq të planifikonte edhe takime të tjera. Por Xhoi tërhiqej në minutën e fundit nga çdo takim i caktuar prej tyre, zakonisht duke thënë: “Sapo më doli diçka në punë. Më fal!” Askush tjetër në kishë nuk dukej se e njihte Xhoin.

Në shtator, ky plak kishe kuptoi se nuk e kishte parë Xhoin në kishë që nga qershori dhe vendosi të lidhej me të përsëri. Ai i dërgoi Xhoit një mesazh zanor. Disa javë më vonë, i dërgoi edhe një tjetër së bashku me një mesazh me postë elektronike. Nuk mori përgjigje për asnjë nga mesazhet e tij. Kaluan edhe disa muaj të tjerë dhe Xhoi as nuk u pa e as nuk u dëgjua kund. Kishin mbetur edhe një ose dy mesazhe për t’ia dërguar. Në këtë pikë, plaku ua shpjegoi situatën pleqve të tjerë, dy prej të cilëve ishin të gatshëm ta telefononin ose t’i dërgonin Xhoit një mesazh me postë elektronike. Disa mbledhje më vonë, mes pleqve doli

DISIPLINA E KISHËS

përsëri emri i Xhoit dhe të gjithë pohuan se nuk e kishin parë as kishin dëgjuar prej tij për më shumë se tetë muaj.

A duhet shkishëruar Xhoi? Nëse po, për çfarë mëkati?

VLERËSIMI I MËKATIT

Mëkati i Xhoit mund të përshkruhet në disa mënyra. Ai mund të përshkruhet si shkelës i besëlidhjes së tij me kishën, në të cilën premtoi të merrte përgjegjësinë për këtë kishë vendore. Ai mund të përshkruhet si një njeri që thotë se e do Perëndinë, ndërkohë që i urren vëllezërit dhe motrat e tij në kishë duke i shpërfillur plotësisht (1 Gjonit 4:20–21). Ndoshta më shkoqur, Xhoi nuk po i bindej urdhrit të Hebrenjve 10:24–25, i cili thotë: “Dhe le të kujdesemi për njeri tjetrin, për t'u nxitur për dashuri dhe vepra të mira, pa hequr dorë nga të mbledhurit bashkë tonin, sikurse kanë zakon disa, por të nxisim njeri tjetrin, aq më tepër se e shihni ditën që po afrohet”. Autori i Hebrenjve i urdhëron të krishterët të takohen rregullisht në mënyrë që ta nxitin dhe t'i japin zemër njëri-tjetrit për dashuri dhe vepra të mira, që është një mënyrë tjetër për t'i plotësuar dy pikat e para më lart. Autori më pas tregon për ditën e gjykimit si nxitje se përse duhet bërë kjo gjë. Me fjalë të tjera, ai e merr me të vërtetë shumë seriozisht këtë mëkat.

Mëkati i mospjesëmarrjes nuk është aq i dukshëm sa tradhtia bashkëshortore. Sidoqoftë, është një mëkat që shpesh fsheh një mëkat tjetër, ose të paktën çon në një mëkat tjetër. Për më tepër, kombe si Shtetet e Bashkuara janë plot me të krishterë thjesht me emër, të cilët japin një dëshmi e emër të keq për ungjillin, sepse kishat nuk kanë marrë përgjegjësinë për mospjesëmarrësit e tyre.

Më tej, nëse anëtarësimi në kishë është pranimi dhe njohja publike nga ana e kishës për rrëfimin e besimit të një individi, mospjesëmarrja ia bën të pamundur kishës për ta përmbushur përgjegjësinë e saj. Kisha nuk mund të thotë më me sinjeritet dhe ndershmëri se po e mbikëqyr dishepullimin e një personi të tillë. Prandaj, shkishërimi i kthen gjërat në shinat e duhura. Është mënyra e kishës për të thënë: “Ne nuk mund të japim llogari për këtë individ, prandaj nuk do ta pohojmë më zyrtarisht rrëfimin e besimit të tij” (kap. 2).

VLERËSIMI I PENDIMIT

Meqenëse Xhoi nuk pranoi t’u përgjigjej mesazheve dhe telefonatave të pleqve, nuk kishin asnjë mënyrë për ta matur frytin e pendimit, përveçse të thoshin se nuk kishte pendesë.

VENDIMI

Megjithatë, pleqtë vendosën të mos shkonin drejt shkishërimit të menjëhershëm. Përkundrazi, vendosën t’ia “tregojnë kishës”, nëse përdorim gjuhën e Mateut 18 (kap. 1). Prandaj, në mbledhjen e ardhshme të anëtarëve, e paraqitën emrin e Xhoit përpara kishës dhe shpjeguan se, nëse nuk do të ndryshonte asgjë, në mbledhjen e ardhshme të planifikuar, e cila sipas rregullit do të mbahej pas dy muajsh, do të shkonin drejt shkishërimit të tij për arsye mospjesëmarrjeje. Ata nxitën këdo që kishte një marrëdhënie me Xhoin që t’i telefononte ose t’i dërgonte një mesazh me postë elektronike. Gjithashtu, pleqtë e shfrytëzuan rastin për t’i mësuar kishës pse është kaq e rëndësishme pjesëmarrja në mbledhjet e kishës.

Ata e shtynë hapin për shkishërim edhe për dy muaj për të

DISIPLINA E KISHËS

paktën pesë arsye (kap. 4). Së pari, kjo u dha më shumë kohë, në përputhje me logjikën e Mateut 18, për të provuar pendimin e Xhoit. Së dyti, u dha miqve të Xhoit — në rast se kishte ndonjë mik për të cilin pleqtë nuk ishin në dijeni — mundësinë për t'u bashkuar me ta në përpjekjet e tyre për ta ftuar Xhoin në pendim. Së treti, do të hiqte faktorin e tronditjes që vjen në mënyrë të pashmangshme në rastet e shkishërimit të menjëhershëm. Satani shpesh e përdor këtë tronditje për të minuar çdo besim që delet më të reja dhe të papjekura kanë te udhëheqësit e tyre. Së katërti, ishte një masë e fundit për gjurmimin e kësaj deleje të humbur. Së pesti, i dha kishës një mundësi për t'u lutur së bashku për Xhoin.

Dy muaj më vonë, askush nuk kishte dëgjuar gjë nga Xhoi. Prandaj, pleqtë vijuan me shkishërimin e tij dhe kisha e pranoi njëzëri.

NJË JOANËTAR QË MERR PJESË RREGULLISHT DHE ËSHTË PËRÇARËS

SITUATA

Xhilli dhe burri i saj kishin njëzet vjet që shkonin në kishën e tyre. Për shumicën e asaj kohe, kisha nuk e praktikoi zyrtarisht anëtarësimin dhe as Xhilli dhe as burri i saj nuk ishin anëtarësuar ndonjëherë. Megjithatë, të dy ishin të përfshirë në mënyrë aktive në çdo gjë, nga organizimi i vakteve për nënat e reja deri te mësimdhënia në shkollën e së dielës. Dhe të dielave mungonin shumë rrallë.

Xhilli ishte edhe një përgojëse e thekur. Ajo ishte gjithmonë e para të mësonte për vështirësitë martesore të një çifti, problemet financiare të një tjetri dhe vështirësitë e një tjetri me adoleshentët rebelë.

Kur erdhi një pastor i ri dhe filloi të zbatonte një regjim më të kujdesshëm të anëtarësimit kuptimplotë në kishë, shumica e kishës e pranoi me kënaqësi. Megjithatë, Xhilli dhe burri i saj nuk ishin dakord. Ata e kundërshtuan idenë e detyrimit për të nënshkruar çdo gjë që lidhej me krishterimin e

DISIPLINA E KISHËS

tyre. Ata argumentonin se “kisha është një familje” dhe “kush do t’i detyronte anëtarët e familjes të nënshkruajnë një formular për të thënë se ishin pjesë e familjes?”

Gjatë disa viteve, pastori i ri bëri një sërë ndryshimesh të tjera që Xhillit dhe bashkëshortit të saj nuk i pëlqyen, si zbatimi i një politike që vetëm anëtarët mund të mësonin në shkollën e së dielës ose të drejtonin shërbesa të caktuara si mikpritja e mundësuar nga kisha. Pakënaqësia e këtij çifti po rritej përherë e më shumë, veçanërisht e Xhillit.

Një ditë, Xhilli pa pastorin në një prej rreshtave të dyqanit ushqimor duke folur me një grua të re dhe tërheqëse që nuk ishte gruaja e tij. Xhilli rrinte larg, por mendoi se e pa atë duke prekur shpatullën e gruas dhe se ajo grua iu përgjigj me një britmë të lehtë ose qeshi. Ajo nuk ishte e sigurt. Por ajo filloi t’u thoshte shoqeve të saj se ishte e shqetësuar për pastorin, se ai mund të kishte një lidhje dhe se kishte nevojë për lutje. Këto thashetheme filluan të përhapeshin shumë, dhe më në fund fjala arriti te pleqtë.

Në fillim, Xhilli nuk donte ta trajtonte drejtpërdrejt çështjen me pastorin ose me pleqtë e tjerë. Por kur dy pleq i thanë asaj t’i ndalonte thashethemet dhe t’u kërkonte falje shoqeve e miqve të saj, ajo vendosi të përballej zyrtarisht me pastorin dhe gruan e tij. Në atë kohë, Xhilli kishte folur kaq shumë për këtë gjë sa vërtet besonte se ai kishte një lidhje. Pleqtë e pyetën nëse ajo mund të sillte një dëshmitar tjetër për të vërtetuar akuzën e saj (1 Timoteut 5:19). Ajo nuk e kishte të mundur, megjithatë nuk pranoi të pendohej. Kur pleqtë e paralajmëruan Xhillin për mundësinë e shkishërimit për shpifje dhe përçarje,

ajo tha se ata nuk kishin autoritet ta shkishëronin pasi ajo nuk ishte anëtare.

A mundet një kishë të shkishërojë një jo-anëtar? Cilat janë kriteret për të përcaktuar kur shpifja dhe përçarja e dikujt e kanë kaluar kufirin dhe kërkojnë patjetër ndërhyrje dhe vepër nga kisha?

VLERËSIMI I MËKATIT

Bazuar në provat, Xhilli dukej se ishte fajtorë për të paktën tri mëkate: shpifje, përçarje dhe kundërshtim për t'iu nënshtruar pleqve. Jezusi dhe apostujt e përshkruajnë shpifjen si të keqe dhe kërkojnë që të krishterët ta shkulin atë (Mateu 15:19; Efesianëve 4:31; 1 Pjetrit. 2:1). Në fund të fundit, ajo mund të shkatërrojë emrin dhe ndoshta jetën e një vëllai ose motre të krishterë dhe të sjellë përçarje në kishë. Pali paralajmëron gjithashtu se ata që shkaktojnë përçarje duhet të paralajmërohen dy herë dhe pastaj të përjashtohen (Titit 3:10). Përçarja merret shumë seriozisht, me të vërtetë. Së fundi, Shkrimi i urdhëron të krishterët t'u nënshtrohen udhëheqësve të tyre (Hebrenjve 13:17).

Akuzat e Xhillit bazoheshin në ndodhinë të dyqani ushqimor dhe një ose dy hollësi të tjera të rastësishme pa rëndësi. Megjithatë, dy pleq e hetuan çështjen në heshtje, por zbuluan se akuzat ishin krejtësisht të trilluara. Ata i kërkuan të hiqte dorë nga akuzat në të paktën katër raste, por ajo kundërshtoi.

VLERËSIMI I PENDIMIT

Pas bisedave që vijuan për gjashtë deri në tetë javë, u bë e qartë se Xhilli nuk do të tërhiqej. Në fakt, ajo dukej se ngurtësohej

DISIPLINA E KISHËS

në pozicionin e saj me çdo bisedë që bëhej dhe filloi ta zburonte përshkrimin e saj të asaj që dëshmoi në dyqanin ushqimor. Miqtë që fillimisht kishin qenë bashkë me të në shqetësimet e saj filluan të largoheshin prej saj. Kjo dukej se e zemëroi më tej dhe, si rrjedhojë, filloi të merrej me anëtarët më të rinj e më të papjekur në kërkim të aleatëve.

Shkurtimisht, vitet e përfshirjes dhe shërbimit të Xhillit në kishë ishin argument se Xhilli ishte e krishterë, por muajt e fundit dukej se e minuan këtë (kap. 3). Pleqtë njëzëri u pajtuan se ajo po i kryente të tri mëkatet e përshkruara më sipër dhe për këto nuk kishte absolutisht asnjë provë pendimi. Fryti ishte i keq dhe po përkeqësohej përherë e më shumë.

FAKTORË TË TJERË

Faktori ndërlikues në këtë situatë ishte se Xhilli nuk ishte anëtare e kishës. Teknikisht, ajo ishte e saktë: nuk i ishte nënshtruar kurrë zyrtarisht autoritetit të kishës, dhe kështu kisha nuk kishte autoritet formal për ta shkishëruar (kapitulli 2 dhe 3).

Në të njëjtën kohë, ajo ishte e njohur dhe e pëlqyer nga shumica e kishës për shkak të përvojës së saj të gjatë në kishë. Aq më tepër, shumë njerëz thjesht mendonin se ishte anëtare. Madje, disa ndiheshin si borxhli ndaj saj për mënyrën se si ishte kujdesur për ta, si për shembull nënat e reja për të cilat ajo kishte siguruar ushqim. Në njëfarë kuptimi, ajo bënte gjithçka që mendohej të bëhej nga një anëtar, përveç mëkatit të saj. Ndërthurja e pjesëmarrjes, marrëdhëniet me njerëzit dhe marrjes së Darkës së Zotit nga ana e saj, u dëshmoi si të brendshmëve ashtu dhe të huajve se kisha e kishte pohuar dhe pranuar rrëfimin e besimit të saj.

VENDIMI

Shpifja dhe përçarja mund të jenë të vështira për t'u matur, por pleqtë ishin të vendosur t'i trajtonin veprimet e saj si të tilla pasi ato plotësonin disa kriteret:

- Ajo po bënte akuza të cilat nuk mund t'i vërtetonte as me prova, as me një dëshmitar tjetër.
- Ajo kundërshtoi t'i ndalonte akuzat, kur iu kërkua.
- Ajo po tundonte anëtarët e tjerë të dyshonin, të spiunonin dhe madje të kritikonin udhëheqjen.
- Ajo po rekrutonte në mënyrë aktive përçarës të tjerë.
- Aktiviteti i saj ishte bërë një shpërqendrim i dukshëm në jetën e kishës. Shpesh dilte në bisedat midis anëtarëve. Kjo gjë po ua harxhonte kohën pleqve të kishës. Dhe anëtarët pranuan se kjo po ndikonte për keq te qasja e tyre për të dëgjuar predikimet.

Prandaj, pleqtë dolën me përcaktimin se kjo grua ishte një ujk dhe se Bibla i udhëzon qartë barinjtë që ta paralajmërojnë grigjën kundër ujqërve — qofshin anëtarë ose joanëtarë (Veprat e Apostujve 20:28–31; shih 2 Pjetrit 2; Zbulesa 2:20–29). Prandaj, ata e udhëzuan privatisht që të mos merrte pjesë në Darkën e Zotit derisa të pendohej publikisht dhe e paralajmëruan kishën për shpifjen dhe përçarjen e saj në një mbledhje anëtarësh. Ata gjithashtu i thanë kishës që të mos e trajtonte atë si të krishterë dhe të mos mashtrohej nga mënyrat e saj intriguese dhe shkatërruese.

Meqenëse nuk ishte anëtare, pleqtë vendosën të mos bënin thirrje për asnjë veprim nga kisha dhe as nuk do të përdornin fjalën “shkishërim” (kap. 2). Përkundrazi, ata i thanë kishës se veprimet e pleqve duhet të lexoheshin si akte udhëzimi dhe

paralajmërimi, gjërat të cilat ata kishin autoritetin t'i bënin duke ditur se çfarë do të thotë të jesh mbikëqyrës (Veprat e Apostujve 20:28–31).

AI QË JEP DORËHEQJE NGA ANËTARËSIA PËR TË SHMANGUR DISIPLINËN

SITUATA

Xhoi vendosi të ndahej nga gruaja e tij pas njëzet vitesh martesë. Ai kishte përparuar shumë financiarisht dhe gjërat që blinte e pasqyronin gjithnjë e më shumë këtë fakt. Kur u përball për divorcin, thoshte se ai dhe gruaja e tij ishin “larguar nga njëri-tjetri në mënyrë të pakthyeshme” dhe “thjesht po banonin në të njëjtën banesë të përbashkët”. Gruaja e Xhoit e pranoi me keqardhje këtë cilësim, por nuk donte të ndahej.

Disa nga miqtë e tij, iu lutën Xhoit që të mos e ndiqte këtë shteg veprimi. Përfundimisht ata përfshinë një nga pastorët, i cili përdori fjalët “disiplinë kishtare” diku gjatë takimit të tyre që zgjati rreth dyzet e pesë minuta. Një javë më vonë, Xhoi dërgoi një letër dorëheqje në zyrën e kishës. Ai njëkohësisht dorëzoi të gjitha dokumentet e nevojshme për divorcin.

A duhet shkishëruar Xhoi? A mundet një anëtar i kishës të shmangë disiplinën e kishës duke hequr dorë nga anëtarësia e tij/saj?

DISIPLINA E KISHËS

VLERËSIMI I MËKATIT

Të krishterët nuk pajtohen nëse Jezusi dhe Pali e lejuan divorcin për çështje të tilla si tradhtia dhe braktisja (shih Mateu 19:9; 1 Korintasve 7:15), por shumica e të krishterëve pajtohen se një i krishterë nuk mund ta shkurorëzojë në mënyrë legjitime bashkëshortin a bashkëshorten për arsyt që dha Xhoi. Një veprim i tillë do të ishte një shkelje e besëlidhjes së martesës të vendosur nga Perëndia dhe, për këtë arsye, është mëkat.

Më tej, një mëkat i tillë, veçanërisht kur vijon pavarësisht disa paralajmërimeve, është i qartë, i qëllimshëm dhe i rëndë. Duket qartë se ky mëkat e zhvlerëson menjëherë rrëfimin e besimit të një personi të tillë.

VLERËSIMI I PENDIMIT

Pendimi në një rast të tillë do të ishte bardh e zi: mos kërko ndarje. Megjithatë Xhoi nuk tregoi shenja kthimi nga hapat që kishte ndërmend të merrte.

FAKTORË TË TJERË

Xhoi u përpoq të shmangte shkishërimin duke hequr dorë nga anëtarësia e kishës. A ishte kjo e ligjshme? Jo. Të krishterët janë të porositur dhe të thirrur, si çështje bindjeje ndaj Krishtit, t'i nënshtrohen pohimit, pranimit dhe mbikëqyrjes së kishave vendore (kap. 2). Njerëzit u bashkohen kishave me pëlqimin e kishës dhe ata japin dorëheqjen me pëlqimin e kishës. Kjo do të thotë se një person nuk mund të shkojë në një kishë dhe të thotë: “Unë jam anëtar tani”. Kishat, pavarësisht se cilës qasje drejtimi a vendimmarrjeje i përkasin, kanë njëfarë mënyre

për të provuar dhe më pas për të pohuar e pranuar rrëfimin e besimit të një personi. Jezusi i dha kishës apostolike çelësat e mbretërisë pikërisht për këtë qëllim. Vërtet anëtarësimi në kishë është “vullnetar” për aq sa Jezusi nuk na detyron të zgjedhim një kishë në vend të një kishe tjetër, por ai na detyron të zgjedhim një kishë. Dhe ashtu si një person nuk mund ta “anëtarësojë” veten, ai nuk mundet as ta “çanëtarësojë” veten. Anëtarët e kishës nuk munden që thjesht ta shmangin kërcënimin e kishës për disiplinë me dorëheqjen e tyre (kap. 2); përfundimi i kësaj marrëdhënieje të ngjashme me besëlidhjen kërkon pëlqimin e të dyja palëve.¹ Lejimi i një veprimi të tillë do të minonte vetë qëllimin e Jezusit për t’u dhënë kishave vendore çelësat e mbretërisë për të ushtruar disiplinë. Do të ishte e barabartë me lejimin e një kriminelit të arrestuar të heqë dorë nga shtetësia për të shmangur ndjekjen penale dhe dënimin.

VENDIMI

Pleqtë vendosën se nuk do t’i kërkonin kishës të vepronte për dorëheqjen e tij. Përkundrazi, ata i kërkuan kishës që ta shkishëronte Xhoin me arsyetimin e divorcit. Meqenëse veprimet e Xhoit, pas paralajmërimeve të shumta, ishin tregues të mospendimit tipik dhe meqenëse hapat e tij drejt divorcit ishin tashmë një fakt i kryer dhe ligjor, ata i kërkuan kishës që ta shkishëronte Xhoin menjëherë (kap. 3 dhe 4). Kisha ra dakord dhe votoi për ta përjashtuar Xhoin nga anëtarësia dhe Darka e Zotit.

¹ Për një trajtesë më të gjatë mbi këtë pikë, shihni artikullin tim “The Preemptive Resignation – A Get Out of Jail Free Card?”, te 9Marks, seria Nëntor/Dhjetor 2009, <https://www.9marks.org/article/preemptive-resignation-get-out-jail-free-card>.

AI QË SHPALL SE ËSHTË JOBESIMTAR

SITUATA

Xhilli u rrit në një familje jofetare. Në kolegji ajo u diplomua në filozofi dhe e përshkruante veten si agnostike. Pastaj u bë deiste. Mandej u përfshi shkurtimisht me Zen Budizmin. Më vonë filloi të takojë me një të krishterë dhe vendosi të bëhej e krishterë. Pas kolegjit, çifti u martua dhe u bashkua me një kishë.

Pesë vjet pas martesës, Xhilli filloi të vinte në dyshim besimin e saj dhe përfundimisht vendosi që, edhe nëse Jezusi ekzistoi si një figurë historike, ai me siguri nuk u ngrit nga të vdekurit. Pas disa takimeve me një plak për të diskutuar dyshimet e saj, ajo vendosi se ishte më mirë të hiqte dorë nga besimi, të hiqte dorë nga anëtarësia e saj në kishë dhe të mos e quante veten të krishterë.

A duhet ta shkishërojë kisha dikë që nuk pohon më se është i krishterë?

VENDIMI

Pasi Xhilli mori vendimin e saj, pastori e paralajmëroi dhe e nxiti të pendohej, por ai nuk u rekomandoi pleqve të tjerë

DISIPLINA E KISHËS

shkishërimin e saj, as pleqtë nuk ia rekomanduan asamblesë një gjë të tillë. Përkundrazi, ata njoftuan se Xhilli kishte hequr dorë nga besimi dhe po e quante veten një jobesimtare dhe se po e hiqnin emrin e saj nga lista e anëtarëve, jo si një akt shkishërimi, por sipas kërkesës së saj.

Arsyetimi i tyre: Jezusi u ka dhënë kishave vendore autoritet mbi të krishterët, jo mbi ata që nuk janë të krishterë (kap. 2). Prandaj, kisha nuk kishte autoritet të mirëfilltë për të vepruar këtui. Më tej, Pali tha se gjykimi i kishës do të ushtrohej mbi “të ashtuquajturin vëlla” (1 Korintasve 5:11), dhe ajo nuk e mbante më këtë emërtim.

Sigurisht, shumë situata të shmangies madhore doktrinare dhe të mohimit të besimit do të kërkonin shkishërim, siç i shpjegon Pali Timoteut (1 Timoteut 1:18–20). Dhe sigurisht efektet e përjetshme të vendimit të Xhillit nuk janë më pak të tmerrshme sesa parashikon Pali për ata që mohojnë “besimin dhe ndërgjegjen e mirë”, duke mbytur kështu besimin e tyre (v. 19). Megjithatë, situata që Pali trajton me Timoteun përfshinte blasfemi aktive (v. 20), e cila, pothuajse sipas përkufizimit, përfshin përpjekjen për të mashtruar në mënyrë aktive anëtarët e kishës. Dhe situata e Xhillit nuk ishte e tillë.

Prandaj, pleqtë thanë se nga ana e kishës nuk kishte asnjë veprim që duhej të ndërmerrej, ashtu siç nuk duhet të ndërmerret asnjë hap kur një anëtar vdes. Në të dyja rastet, anëtarësimi, si të thuash, shuhet. Ata e udhëzuan kishën që t’i qaseshin Xhillit në miqësi, ta trajtonin si çdokënd tjetër që nuk është i krishterë duke e mirëpritur në shtëpitë e tyre dhe duke e ungjillëzuar.

ANËTARI I FAMILJES

SITUATA

Gruaja e Xhoit u shkishërua kohët e fundit për shkak të varësisë së saj ndaj lojërave të fatit (shih rastin studimor të kapitullit 7). Xhoi u pajtua me vendimin e kishës. Por pas vendimit, teksa lexonte Biblën, zbuloi se Pali thotë “me një të tillë bile as të mos hani bashkë” (1 Korintasve 5:11).

Gruaja e Xhoit ishte thellësisht e mërzhitur nga vendimi i kishës dhe u ndie e përbuzur nga vendimi i tij për të votuar bashkë me kishën. Por ajo nuk e kishte ndërmend ta linte burrin dhe ai nuk kishte plane ta linte gruan (shih 1 Korintasve 7:12–14). Megjithatë, tani ai ishte në mëdyshje nëse duhej të mos hante fare me të.

Si duhet ta trajtojë një anëtar i familjes individin që është përjashtuar?

VENDIMI

Në një takim privat, një plak i shpjegoi Xhoit se ai ishte ende i detyruar nga shkrimet e shenjta ta donte, t'i shërbente dhe të kujdesej për gruan e tij, madje duke dhënë jetën e tij për të siç bëri Krishti për kishën (shih 1 Korintasve 7:14–15; Efesianëve 5:25–30). Plaku bëri dallim midis martesës si institucion i

DISIPLINA E KISHËS

krijimit dhe i hirit të përbashkët dhe kishës vendore si institucioni i hirit të veçantë dhe shpëtues.

Fakti që gruaja e Xhoit ishte përjashtuar nga kisha nuk i shfuqizonte përgjegjësitë e tij martesore.

Në përgjithësi, shpjegoi plakun, anëtarët e familjes së një individi të disiplinuar duhet të vazhdojnë të përmbushin detyrimet biblike të jetës familjare (p.sh., Efesianëve 6:1–3; 1 Timoteut 5:8). Dhe me siguri kjo përfshinte detyrën e fëmijëve për të ngrënë me prindërit e tyre, ose detyrën e burrave ndaj grave të tyre.

Megjithatë, akti i shkishërimit nga ana e kishës nënkuptonte se një barrë e re iu vu Xhoit edhe mbi mënyrën se si ai duhej të ndërvepronte me gruan e tij. Qëllimi i Palit në urdhërimin e anëtarëve të kishës që të mos hanin me anëtarët e shkishëruar shërbeu për të paktën tri qëllime: t'i mbronte të krishterët nga fara e mëkatit; t'i mbronte anëtarët e përjashtuar nga të menduarit se kisha i konsideronte si besimtarë; dhe të mbronte dëshminë e kishës në shoqëri. Në ditët e kishës së hershme, të haje bukë me një individ nënkuptonte miqësi, kujdes dhe mbrojtje (prandaj, udhëheqësit fetarë e kundërshtuan të ngrënë të Jezusit me mëkatarët dhe taksambledhësit). Dhe Pali nuk donte që anëtarët e kishës të përfshiheshin me anëtarët e shkishëruar në asnjë mënyrë që do të komunikonte këtë lloj shoqërie të përbashkët të krishterë.

Në këtë mënyrë, Xhoi do të duhej të gjente ekuilibrin që njëkohësisht të pohonte dashurinë e tij për gruan, edhe në mënyrë romantike, dhe t'i shërbente asaj në çdo gjë, duke u siguruar gjithashtu që ai të mos thoshte ose të bënte asgjë që do ta shtynte atë të mendojë se Xhoi e trajton atë si të ishte e krishterë. Përkundrazi, atij do t'i duhej të vazhdonte ta nxiste atë drejt pen-dimit dhe besimit.

Pjesa 3

FILLIMI

PARA SE TË DISIPLINONI, MËSONI

Mark Dever, pastor me përvojë dhe mbështetës i njohur i disiplinës kishtare, e fillon një artikull mbi temën e disiplinës kishtare me këto fjalë të papritura: “‘Mos e bëni këtë’. Kjo është gjëja e parë që u them pastorëve, kur zbulojnë se disiplina e kishës është në Bibël. Unë them: ‘Mos e bëni! Të paktën jo që tani’”.¹

Pse ky person, i cili e quan disiplinën e kishës një nga shenjat e një kishe të shëndetshme, do të fillonte me këtë këshillë? Dever ka ndërmend një pastor që dëgjon për disiplinën për herë të parë. Në fillim, ideja tingëllon qesharake për këtë pastor, por më pas ai shikon të gjitha tekstet shkri-more dhe i mbushet mendja. Ai e kupton se ka qenë i pakuj-deshtëm. Ai nuk po e ruan kishën dhe emrin e Krishtit. Ai nuk i ka dashur delet e tij apo fqinjët e tyre jo të krishterë. Bindja kthehet në vendosmëri dhe pastori imagjinat vendos të ndërmarrrë hapa. Dever vazhdon:

¹ Mark Dever, “‘Don’t Do It!’ Why You Shouldn’t Practice Church Discipline”, te 9Marks, seria Nëntor/Dhjetor 2009, <https://www.9marks.org/article/dont-do-it-why-you-shouldnt-practice-church-discipline>.

DISIPLINA E KISHËS

Pikërisht në këtë pikë, shpesh duket se lind një vendosmëri e acartë. “Unë do ta udhëheq këtë kishë që të jetë biblike në këtë pikë, edhe nëse është gjëja e fundit që bëj!” Dhe shumë shpesh, ashtu ndodh.

Në jetën paqësore të një kishe të pafajshme, e cila ka qëllime të mira dhe i beson Biblës, godet rrufeja e disiplinës së kishës! Mund të jetë në një predikim. Mund të jetë në një bisedë midis pastorit dhe një dhjaku. Mund të jetë një lëvizje e nxituar në një mbledhje të anëtarëve. Por diku godet, zakonisht e shoqëruar me zell të madh dhe një lumë vargësh nga Shkrimet.

Më pas, ndërmerret një veprim i sinqertë.

Më pas vjen përgjigja: si rrjedhojë ka keqkuptime dhe ndjenja të lënduara. Hidhen kundërakuza. Mëkati sulmohet dhe mbrohet. Përmenden emra. Acarim ka sa s’mban më! Simfonia e kishës vendase shndërrohet në një kakofoni argumentesh dhe akuzash. Njerëzit bërtasin, “Ku do të ndalet kjo gjë?” dhe “Pra, ti mendon se je i përsosur?”²

Morali i historisë, natyrisht, është se duhet të ndërmerren një sërë hapash përgatitorë përpara se pastorët të vër-sulen drejt ushtrimit të disiplinës formale të kishës. Në këtë kapitull do të shqyrtojmë se mbi çfarë duhet të japin mësim pastorët. Në kapitullin tjetër do të shqyrtojmë disa çështje organizative që duhen vendosur e zbatuar mirë.

JEPNI MËSIM MBI SHENJTËRINË DHE PENDIMIN

Nëse ideja e disiplinës së kishës do të ketë sadopak kuptim për një kishë, ajo duhet të ketë një kuptim të fortë të ungjillit dhe çfarë do të thotë të jesh i krishterë, siç e diskutuam

² Po aty.

në parathënie dhe në kapitullin 2. Të jesh i krishterë nuk do të thotë vetëm të marrësh një vendim një herë; ka të bëjë me një besim dhe pendim që sjell një model krejtësisht të ri vendimesh. Ka të bëjë me nënshtrimin ndaj Krishtit si Zot.

Perëndia synon e dëshiron që populli i tij të duket ndryshe nga bota. Ai synon që ata të jetojnë një jetë të shenjtë dhe të luftojnë kundër mëkatit. Ky është kuptimi i pendimit. Pendim nuk do të thotë se njeriu ka reshtur së kryeri mëkat, por do të thotë se i ka shpallur luftë mëkatit. Një kishë duhet t'i kuptojë këto gjëra përpara se të pritët që ajo ta kuptojë si duhet disiplinën e kishës.

JEPNI MËSIM MBI ANËTARËSINË

Një kishë nuk do të jetë e gatshme ta nxjerrë dikë *jashtë* nga kisha nëse nuk e kuptojnë se ka një *hyrje* dhe një *dalje*. Bibla është e qartë: ka nga ata që janë “anëtarë” të trupit të Krishtit (1 Korintasve 12:27) dhe nga ata që janë “të jashtëm” (1 Korintasve 5:12). Nëse një kishë nuk e kupton këtë, ideja për të nxjerrë dikë “jashtë” do të tingëllojë mjaft qesharake.

Më shkoqur, një kishë duhet të kuptojë se anëtarësimi në kishë nuk është si anëtarësimi në një klub apo në ndonjë organizatë vullnetare. Bëhet fjalë për nënshtetësinë në një mbretëri në të cilën pranohemi dhe njihemi si ambasadorë nga përfaqësuesi i ngjashëm me ambasadën e mbretit, kisha vendore. Si individë, të krishterët, pasi janë bindur se kanë besuar në Krishtin, nuk e kanë autoritetin të qëndrojnë përpara botës dhe të thonë: “Hej botë, unë jam me Jezusin”, duke pagëzuar veten dhe duke marrë Darkën e Zotit vetëm. Jo! Kisha e ka këtë autoritet, nëpërmjet fuqisë së çelësave.

DISIPLINA E KISHËS

Çfarë është anëtarësimi në kishë? Anëtarësimi në kishë është pohimi e pranimi publik i kishës për rrëfimin e besimit të Jezusi nga ana e një të krishteri dhe është vendimi i individit t'i nënshtrohet mbikëqyrjes së kishës. Kur kisha juaj fillon ta kuptojë këtë, ideja e disiplinës së kishës do të fillojë të ketë shumë më tepër kuptim.

Kjo do t'i ndihmojë njerëzit edhe të kuptojnë pse nuk e kanë autoritetin të japin dorëheqjen nga anëtarësia e tyre, kur kërcënohen me disiplinë. Njerëzit i bashkohen një kisha me autoritetin e kishës dhe dalin nga kisha po me autoritetin e kishës.

JEPNI MËSIM MBI DISHEPULLIMIN

Siç e pamë në kapitujt e hershëm, dishepullimi dhe disiplinimi përfshijnë si mësimdhënie ashtu edhe korrigjim. Dhe ky dishepullim do të ndodhë si privatisht ashtu edhe në bashkësi.

Prandaj, kishat duhet të kuptojnë se pjesë e të qenit dishepull i Krishtit është të dish se si të korrigjohesh dhe të mësohesh nga dishepujt e tjerë të Krishtit. Pastorët duhet t'i nxitin anëtarët e kishës që të ndërtojnë marrëdhënie me njëri-tjetrin, marrëdhënie në të cilat korrigjimi dhe udhëzimi janë normale. Ata duhet t'u mësojnë atyre se një person i themeluar mirë mbi ungjillin mëson si ta pranojë korrigjimin dhe si ta bëjë atë butësisht me të tjerët; burrat e moshuar me burra të rinj, gratë e moshuara me gra më të reja.

Kur kjo lloj llogaridhënieje përqafohet nga marrëdhëniet e njerëzve në kishë, disiplina formale e kishës ka më shumë kuptim. Kur kjo gjë nuk ndodh, propozimi për të shkuar drejt një akti zyrtar discipline do të duket si rrufe në qiell të hapur.

JEPNI MËSIM MBI VETËMASHTRIMIN

Dishepullimi ekziston pjesërisht sepse njerëzit, duke përfshirë të krishterët, janë të prirur për vetëmashtrim. Kjo është arsyeja pse apostujt vazhdimisht i paralajmërojnë të krishterët: “Mos u gënjeni” (1 Korintasve 6:9; Galatasve 6:7; Jakobi 1:16). “Askush të mos e mashtrojë vetveten”, thotë Pali (1 Korintasve 3:18). Dhe diku tjetër: “Njerëzit e këqij dhe mashtrues do të shkojnë keq e më keq, duke gënjyer dhe duke u gënjyer vetë” (2 Timoteut 3:13). Është e lehtë të thuash se nuk kemi mëkat dhe kështu “mashtrojmë veten”, thotë Gjoni (1 Gjonit 1:8). Edhe vetë dëshirat tona janë “mashtrore” (Efesianëve 4:22).

Të krishterët që harrojnë se janë të prirur për vetëmashtrim, tashmë janë bërë krenarë dhe po shkojnë me shpejtësi drejt fariseizmit të mbytur në vetëdrejtësi. Zgjidhja: pranojeni disiplinën. Kërkojeni korrigjimin. Mirëpritni qortimin. Kjo është udha e përulësisë dhe urtësisë.

Në një farë mase e mënyre, kishat vendore ekzistojnë për të na mbrojtur nga vetja. Vëllezërit dhe motrat rreth nesh, të cilët na duan dhe janë të përkushtuar për të mirën tonë, janë ata që na ndihmojnë t'i shohim gjërat që ne nuk mund t'i shohim te vetja jonë. Nuk jemi ekspertë kur vjen puna për shqyrtimin e vetvetes.

Ky është një mësim që pastorët duhet të japin javë pas javë në kohët e mira, në mënyrë që kur të vijnë kohët e kryengritjes nga dikush, kisha të jetë gati për të.

JEPNI MËSIM MBI DISIPLINËN

Kisha duhet të mësohet rreth disiplinës së kishës nëpërmjet teksteve më të spikatura mbi këtë temë, si Mateu 18 dhe 1

DISIPLINA E KISHËS

Korintasve 5. Predikimet, grupet e vogla dhe buletinet e kishës janë të gjitha forume të natyrshme për këtë lloj mësimi.

Por pastorët duhet të mësojnë gjithashtu se si të zbatojnë pasazhe të tjera të Shkrimit për temat e anëtarësimit dhe disiplinës (aty ku është e përshtatshme). Për shembull, pjesa e Shkrimit mbi të qenët i shenjtë sepse Perëndia është i shenjtë, te letra e parë e Pjetrit, ka zbatime të qarta vetjake, por ka edhe zbatime si bashkësi: Nëse *populli* i Perëndisë duhet të jetë i shenjtë, ne si kishë duhet të tregojmë kujdes se kë pranojmë dhe kë përjashtojmë nga anëtarësia e kishës.

Ose merrni parasysh pjesët te Ungjilli dhe letrat e Gjonit rreth dashurisë që çon në bindje. Pjesë të tilla nuk kanë vetëm zbatime vetjake, por edhe si bashkësi: Si të mësojmë ta duam njëri-tjetrin më mirë në kishën tonë? Duke e ndihmuar njëri-tjetrin për t'iu bindur Krishtit dhe duke e korrigjuar me ndjeshmëri njëri-tjetrin, kur nuk bindemi. Të korrigjosh një vëlla të pabindur në Krishtin, kur bëhet me motivet e duhura, është një akt dashurie. A e besoni këtë?

Në fakt, pothuajse çdo tekst në Bibël mbi shenjtërinë, pendimin, kthimin, nënshtrimin dhe dishepullimin, për të mos përmendur tekstet që prekin temat e gjera të historisë shpenguese, si p.sh. vendosja e kufijve për Izraelin apo edhe mërgimi, mund të zbatohet edhe në lidhje me disiplinën.

Pastorët duhet t'i mësojnë anëtarët e kishës edhe për qëllimet e disiplinës. Kishat nuk duhet të ushtrojnë disiplinë për hir të ndëshkimit, por për hir të dashurisë së ungjillit. Ne pamë në kapitullin 1 se disiplina shërben për të nxjerrë në pah mëkatin kanceröz, për të paralajmëruar kundër një gjykimi më të madh, për të shpëtuar mëkatarin, për të mbrojtur

anëtarët e tjerë të kishës dhe për të paraqitur një dëshmi të mirë për Krishtin – të gjitha këto janë akte dashurie.

JEPNI MËSIM MBI DASHURINË

Në thelbin e saj, disiplina e kishës ka të bëjë me dashurinë. Zoti i disiplinon ata që i do (Hebrenjve 12:6). E njëjta gjë vlen edhe për kishën e tij.

Problemi është se shumica e njerëzve sot kanë një pikëpamje të zbutur për dashurinë: dashuria është e tillë që na bën të ndihemi të veçantë. Ose kanë një pikëpamje romantike për dashurinë: dashuria të lejon të shprehesh pa u gjykuar. Ose ata kanë një pikëpamje konsumatore: dashuri është të gjesh personin a gjënë e përshtatshme për ty. Në mendjen e njerëzve, dashuria ka fare pak të bëjë me të vërtetën, shenjtërinë dhe autoritetin.

Por kjo nuk është dashuria sipas Biblës. Në Bibël, dashuria është e shenjtë. Nuk kërkon përfitim vetjak. Dashuria sjell bindje. Ajo nuk kënaqet me të keqen, por gëzohet në të vërtetën (1 Korintasve 13:6).

Jezusi na thotë se nëse i zbatojmë urdhërimet e tij, do të qëndrojmë në dashurinë e tij (Gjonit 15:10). Dhe Gjoni na thotë se nëse e zbatojmë fjalën e Krishtit, dashuria e Perëndisë do të përsoset në ne (1 Gjonit 2:5). Si e ndihmojnë anëtarët e kishës njëri-tjetrin të qëndrojnë në dashurinë e Krishtit dhe të shohin përsosmërinë e dashurisë së Perëndisë te njëri-tjetri? Kjo ndodh kur e ndihmojmë njëri-tjetrin t'i bindemi dhe ta zbatojmë fjalën e Tij, përmes udhëzimit, mësimit dhe korrigjimit.

Një kishë që e kupton dashurinë biblike ka shumë mundësi ta kuptojë edhe disiplinën e kishës.

PARA SE TË DISIPLINONI, ORGANIZOHUNI

Përgatitja e një kishë për të ushtruar disiplinën e kishës shpesh përfshin më shumë sesa mësimdhënie. Mund të kërkojë edhe disa ndryshime organizative. Më lejoni të përmend katër çështje organizative.

SIGUROHUNI QË I KENI DOKUMENTET E KISHËS NË RREGULL

Disa kisha kanë akte nënligjore. Disa kanë kushtetuta. Disa kanë deklarata besimi dhe besëlidhje të kishës. Çfarëdo që mund të ketë një kishë, kishat në kontekstet perëndimore do t'u shërbejnë anëtarëve të tyre duke u siguruar që dokumentet të shpjegojnë (1) atë që pritet nga anëtarët për sa i përket besimit dhe sjelljes; (2) si funksionojnë strukturat e autoritetit të kishës; (3) çfarë të pritet për pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve në rrethana të zakonshme; (4) si funksionon disiplina e kishës për rrethana të jashtëzakonshme.

Është një akt dashamirësie t'u bësh njerëzve me dije se për çfarë standardesh do të përgjigjen përpara se t'i disiplinosh ata. Një deklaratë besimi u bën atyre të ditur se çfarë pritet të besojnë.

DISIPLINA E KISHËS

Një besëlidhje u bën atyre të ditur se si pritet të jetojnë. Një kush-tetutë u mundëson atyre të dinë se si funksionojnë anëtarësimi dhe disiplina.

Dokumente të tilla nxitin edhe unitetin. Dokumentet për të cilat njerëzit janë pajtuar dhe kanë bërë marrëveshje e ruajnë kishën nga grindjet mbi metodat ose rregullat sa herë që lind një mosmarrëveshje.

SIGUROHUNI QË KENI BAZA TË RREGULLTA LIGJORE

Sigurimi i dokumenteve të rregullta të një kishe ndihmon edhe në krijimin e bazave të duhura ligjore për ushtrimin e disiplinës së kishës në një shoqëri plot grindje dhe procese gjyqësore. Kishat në përfundim janë përballur me padi gjyqësore për disiplinën e kishës.¹

Një nga mënyrat më efektive për të parandaluar padi të tilla është miratimi i politikave të qarta biblike që përshkruajnë në mënyrë gjithëpërfshirëse se si kisha juaj do të ushtrojë disiplinë ndaj anëtarëve të papendur. Dhe një nga mbrojtjet më efektive ndaj çdo padie është pëlqimi i shprehur i një personi të informuar mirë. Për të siguruar këtë mbrojtje, një kishë duhet të jetë në gjendje t'i dëshmojë një gjykatë se personi që ankohet për një gabim ishte në fakt plotësisht i vetëdijshëm për politikat dhe procedurat e kishës dhe me vetëdije i pranoi të gjitha si detyrime.

Përveçse duhet t'i bëjë të qarta procedurat e disiplinës në kushtetutë ose në aktet nënligjore, një kishë duhet të mësojë

1 Shihni artikullin e Ken Sande, "Informed Consent: Biblical and Legal Protection for Church Discipline", 9 Marks, seria Shtator/Tetor 2009, <https://www.9marks.org/article/informed-consent-biblical-and-legal-protection-church-discipline>.

në mënyrë të qartë e të drejtpërdrejtë për procedurat e saj të disiplinës në kurset e anëtarësimit në kishë.

Një burim i shkëlqyer për këto çështje është Peacemaker Ministries: www.peacemaker.net.

ORGANIZONI LISTËN E ANËTARËSISË SË KISHËS

Ushtrimi i disiplinës kishtare kërkon që kishat të dinë se kush është *kisha*. Disa vite më parë, një miku im pranoi postin e pas-torit kryesor në një kishë ndërkombëtare në Lindjen e Mesme. Kur arriti atje, gjashtëqind njerëz ishin të pranishëm, por nuk kishte asnjë listë të vërtetë të anëtarësimit. Kishte një listë të vjetër me numra telefoni me rreth njëqind emra dhe asgjë më shumë. Kur foli me mua, ai e përmblodhi situatën kështu: “Nuk e dinim kush ishim”. As ai dhe askush tjetër në kishë nuk e dinte se kush kishte pranuar të kishte përgjegjësi dhe llogaridhënie para trupit të kishës. Kisha kishte qenë besnike në predikim. Ajo nuk kishte qenë besnike në punën e saj të ushtrimit të çelësave nëpërmjet pagëzimit, Darkës së Zotit ose disiplinës së kishës. Po sikur miku im të kishte guxuar të sillte një rast disipline para kishës në atë pikë? Procesi do të ishte zbërthyer në shumë pika: individë që akuzoheshin mund të thoshte se nuk ishte nën autoritetin e kishës; udhëheqës të tjerë të kishës mund të pajtoheshin me të; dhe pjesëmarrësit e tjerë nuk do ishin të sigurt nëse do të merrnin pjesë në marrjen e vendimit apo jo.

Kisha të tjera kanë një problem të ndryshëm nga miku im në Lindjen e Mesme. Ato kanë listat formale të anëtarësimit që e tejkalojnë shumë numrin e pjesëmarrjes; treqind të pranishëm por një mijë në lista. Kur është kështu, është e vështirë

DISIPLINA E KISHËS

të ushtrosh disiplinë me ndershmëri e drejtësi. Si mundet një kishë të disiplinojë një individ për mospjesëmarrje, ndërsa i lë të qetë rreth 699 të tjerë?

Me pak fjalë, udhëheqësit e kishës, në shumicën e rrethanave, duhet të organizojnë listat e anëtarësimit të kishës së tyre përpara se të ushtrojnë disiplinë. Lista e anëtarëve duhet të përbëhet kryesisht nga njerëz që janë të pranishëm në mbledhjet javore të kishës (natyrisht që ka përjashtime për ata që nuk mund të lëvizin, ushtarakët me shërbim të përkohshëm, etj).²

SIGUROHUNI QË UDHËHEQËSIA ËSHTË NË NJË MENDJE

Së fundi, është e rëndësishme të siguroheni që udhëheqja e një kishë në tërësi është në një mendje në lidhje me disiplinën e kishës, si në parim ashtu edhe në çdo rast të caktuar praktike. Nëse një pastor ose plak drejton akuzën, ndërsa të tjerët ulen e rrinë duarkryq, sepse dyshojnë ose parimin ose zbatimin e veçantë, si rrjedhojë, do të ketë përçarje në kishë. Prandaj, nëse një pastor duhet ta mësojë të gjithë kishën rreth disiplinës, siç e diskutuam në kapitullin e fundit, ai patjetër duhet të sigurohet se i ka mësuar udhëheqësit e tjerë së pari.

Hapat drejt disiplinës së kishës mund të prodhojnë diskutime të paqëndrueshme. Për raste të tilla, një drejtues me siguri dëshiron të qëndrojë krah për krah me udhëheqës të pjekur që bashkëndajnë bindjet e tij.

2 Për udhëzim se si duhet bërë kjo gjë, shihni dy artikuj nga Matt Schmucker, "Cleaning Up the Rolls" dhe "Cleaning Up the Rolls – Part 2", 9Marks, <https://www.9marks.org/article/cleaning-rolls> dhe <https://www.9marks.org/article/cleaning-rolls-part-2-care-list>. Shihni edhe nga Mark Dever "Why We Disciplined Half Our Church", LeadershipJournal.net, 1 tetor, 2000, <https://www.christianitytoday.com/pastors/2000/fall/16.101.html>.

PËRFUNDIM

A jeni gati për të filluar? Lista e gjërave për të cilat pastori duhet të sigurohet

Kur pastorët e kishave që janë të panjohura për mua pyesin nëse duhet të vijojnë me hapin e disiplinës, unë i pyes për hollësitë e vetë situatës, por edhe i ftoj të shohin një listë që ngjan shumë me nëntitujt nga dy kapitujt e fundit. Përmes telefonit ose personalisht, zakonisht ngre pyetje si:

LISTA E GJËRAVE PËR TË CILAT PASTORI DUHET TË SIGUROHET SA I TAKON DISIPLINËS SË KISHËS

Mësimdhënia

- 1) A ka kisha juaj një kuptim të ungjillit që përfshin pendimin, bindjen dhe sundimin e Krishtit mbi besimtarët?
- 2) A praktikon kisha juaj anëtarësim të kujdesshëm? A e kupton anëtarësia juaj autoritetin e kishës dhe thirrjen për të ndihmuar njëri-tjetrin të qëndrojnë të përgjegjshëm e llogaridhënës në besim? A e ushtrojnë anëtarët e kishës një përgjegjësi dhe llogaridhënie të tillë veçmas me njëri-tjetrin?
- 3) A e kuptojnë ata se dishepullimi i krishterë përfshin edhe mësimin edhe korrigjimin?

PËRFUNDIM

- 4) A e kuptojnë ata se janë të prirur për t'u vetëmashtruar dhe se Perëndia i dashurisë dhe urtësisë ka vendosur të krishterë të tjerë në jetën e tyre pikërisht për këtë qëllim?
- 5) A e keni mësuar kishën mbi disiplinën? Një herë, apo në shumë raste? A kanë pasur mundësi edhe mësues të tjerë të japin mësim për këtë, qoftë përmes kurseve në shkollën e së dielës apo në grupe të vogla? A duket se kisha e përqafton disiplinën si biblike?

Struktura

- 6) A e pasqyrojnë dokumentet tuaja të kishës praktikën e disiplinës? A janë mësuar anëtarët të presin disiplinë kur bashkohen me kishën? A janë mësuar t'i afrohen një plaku e të flasin, nëse ndryshojnë mendje për ndonjë çështje në deklaratën e besimit? A e dinë ata se do të mbajnë përgjegjësi dhe do të jenë llogaridhënës për të jetuar sipas parimeve të shkrimeve të shenjta?
- 7) Pra, a ka kisha juaj bazat e duhura ligjore — a mund të vendosni të keni pëlqimin e secilit pas një informimi të qartë?
- 8) A pasqyrojnë listat tuaja të anëtarësimit ata të cilëve po u predikoni të dielën?
- 9) A e kuptojnë bashkudhëheqësit tuaj disiplinën? A pajtohen me të dhe a e kuptojnë rëndësinë e saj?

Situata specifike

- 10) Nëse kjo është hera e parë që kisha ushtron disiplinë, a është ky një rast mjaft i thjeshtë? Pra, a është mëkati në fjalë ai për të cilin prisni që e gjithë kisha të pajtohet se është shumë i rëndë për një person që është përfaqësues i Jezusit?

SHTOJCA

Gabime që bëjnë pastorët në ushtrimin e disiplinës

Pastorët ndonjëherë bëjnë gabimet e mëposhtme në lidhje me disiplinën formale të kishës.

- 1) Ata nuk e mësojnë kishën e tyre se çfarë është disiplina e kishës dhe pse duhet ta ushtrojnë atë.
- 2) Ata nuk ushtrojnë anëtarësim kuptimplotë, i cili përfshin (1) mësimin e njerëzve se çfarë nënkupton anëtarësimi përpara se të anëtarësohen; (2) nxitjen e pjesëmarrësve të rastësishëm për t'u bashkuar; (3) marrjen në pyetje me shumë kujdes të të gjithë atyre që duan të anëtarësohen; (4) kujdesin e mbikëqyrjen e rregullt për gjithë grigjën; dhe (5) mbajtjen e një liste të përditësuar të anëtarësimit që pasqyron me saktësi se kush është i pranishëm në mbledhjen javore.
- 3) Ata nuk e mësojnë kishën e tyre për kthimin në besim sipas Biblës, veçanërisht nevojën për pendim.
- 4) Ata nuk i mësojnë anëtarët e rinj, ndërsa hyjnë në kishë, për mundësinë e disiplinës së kishës dhe se dorëheqja për të shmangur disiplinën nuk funksionon.
- 5) Ata nuk sigurohen që dokumentet publike të kishës (aktet nënligjore, kushtetuta, aktet e themelimit, etj.) të trajtojnë procedurat e disiplinës së kishës, e si rrjedhojë, e lënë kishën të zbuluar ndaj rrezikut të padive ligjore.

- 6) Ata nuk i ndjekin hapat e Mateut 18 ose 1 Korintasve 5, në varësi të rrethanave. Në një situatë të ngjashme si te Mateu 18, për shembull, ata nuk e fillojnë procesin duke u përballur me mëkatin veçmas.
- 7) Ata gjykojnë gabim për shpejtësinë me të cilën duhet të shkojnë drejt disiplinës formale, ose duke u zvarritur ose duke nxituar në gjykim.
- 8) Ata nuk ia mësojnë dhe shpjegojnë kishës në mënyrë të qartë e të duhur pse është i nevojshëm një akt i caktuar disiplinimi.
- 9) Ata i tregojnë kishës shumë hollësi rreth një mëkati të veçantë për të cilin po rekomandojnë disiplinë, duke vënë në siklet anëtarët e familjes dhe duke u bërë shkas që delet më të dobëta të pengohen e të bien.
- 10) Ata i trajtojnë proceset e disiplinës kishtarë tërësisht si një proces ligjor me pak vëmendje për baritimin e zemrës së individit të papënduar.
- 11) Ata i kushtojnë pak vëmendje dallimeve midis llojeve të mëkatarëve dhe se si kjo mund të ndikojë në kohëzgjatjen që një kishë duhet të durojë një model mëkati përpara se të vazhdojë në fazat pasuese të disiplinës (shih 1 Thesalonikasve 5:14).
- 12) Ata harrojnë se edhe ata vetë jetojnë prej mëshirës së ungjillit, dhe për këtë arsye, e ushtrojnë disiplinën nga një qëndrim i vetë-drejtësisë. Gabime të tjera pasojnë nga kjo sjellje e gabuar, të tilla si një ton tepër i ashpër dhe një qëndrim krejt i ftohtë.
- 13) Ata nuk arrijnë ta duan vërtet mëkatarin . . . duke mos iu lutur Zotit për pendimin e tij ose të saj.
- 14) Ata kërkojnë shumë nga një kallam i thyer. Me fjalë të tjera, kushtet e tyre për pendim janë shumë të larta për dikë që ka qenë thellësisht i skllavëruar në kthetrat e mëkatis.
- 15) Ata nuk arrijnë ta udhëzojnë siç duhet kishën se si të ndërveprojnë me mëkatarin e papënduar, si p.sh., si të sillen me të në situata shoqërore dhe si të përpiqen e ta nxitin atë për pendim.

- 16) Ata nuk e ftojnë individin e disiplinuar që të vazhdojë të ndjekë shërbesat e kishës, në mënyrë që ai ose ajo të mund të vazhdojë të dëgjojë Fjalën e Perëndisë (gjithmonë kur nuk ka kërcënim për dëmtim kriminal). Gjithashtu, ata nuk e informojnë kishën se të gjithë duhet të shpresojnë që individi i disiplinuar të vazhdojë të marrë pjesë.
- 17) Ata e vendosin përgjegjësinë për udhëheqjen e procesit të disiplinës tërësisht mbi supet e një njeriu, pastorit kryesor, duke tunduar kështu individë në kishë të akuzojnë pastorin se po hakmerret personalisht.
- 18) Ata nuk arrijnë të kenë përfshirje të mjaftueshme të pleqve në jetën e kishës, kështu që pleqtë nuk janë të vetëdijshëm për gjendjen e deleve. Ky dështim i disiplinës formuese do ta dobësojë në mënyrë të pashmangshme gjendjen e kishës për ta ushtruar mirë disiplinën korrigjuese.
- 19) Ata nuk e mësojnë Fjalën e Perëndisë besnikërisht javë për javë.
- 20) Ata e lejojnë kishën t'i qaset një rasti disiplinimi me një frymë të gabuar ndëshkimi, në vend që të tregojnë dashuri të qëllimshme, kur e paralajmërojnë mëkatarin e papenduar për ndëshkimin përfundimtar të Perëndisë.
- 21) Ata e ushtrojnë disiplinën mbi baza jobiblike (lojë letrash, vallëzim, etj.).
- 22) Ata e ushtrojnë disiplinën për çfarëdo arsye tjetër por jo për të mirën e individit, të mirën e kishës, të mirën e komunitetit që vëzhgon dhe të mirën e lavdisë së Krishtit.



Seria "Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme"

A ËSHTË KISHA JOTE E SHËNDETSHME?

9Marks ekziston për të pajisur udhëheqësit e kishave me një vizion biblik dhe me burime praktike, për ta shfaqur lavdinë e Perëndisë ndër kombe përmes kishave të shëndetshme.

Për këtë qëllim, ne duam të shohim kishat të karakterizuara nga këto nëntë shenja shëndeti:

1. Predikimi shtjellues
2. Teologjia biblike
3. Një kuptim biblik i ungjillit
4. Një kuptim biblik i kthimit në besim
5. Një kuptim biblik i ungjillëzimit
6. Anëtarësia biblike në kishë
7. Disiplina biblike në kishë
8. Dishepullimi biblik
9. Udhëheqësia biblike e kishës

Në organizatën "9Marks", ne shkruajmë artikuj, libra, vlerësime librash, si dhe një revistë "online". Ne organizojmë konferenca, regjistrojmë intervista dhe prodhojmë materiale të tjera për t'i pajisur kishat që ta shfaqin lavdinë e Perëndisë.

Vizitoni faqen tonë të internetit për të gjetur materiale në më shumë se 40 gjuhë të ndryshme dhe për t'u abonuar për revistën tonë falas "online". Shihni një listë të plotë të të gjitha faqeve tona në gjuhë të huaja në adresën: www.9marks.org/international/.

Shqip: al.9marks.org | Anglisht: 9marks.org

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Leeman, Jonathan

Disiplina e kishës : si e ruan kisha emrin e Jezusit / Jonathan Leeman ; përkth. Arben Bushgjokaj ; red. Linda Bushgjokaj.

- Tiranë : IGNIS, 2025.

146 f. ; 12,7 x 17,78 cm. - (Si të ndërtojme kisha të shëndetshme).

Tit. origj.: Church Discipline : How the Church Protects the Name of Jesus.

9Marks ISBN: 979-8-89218-152-5

1. Feja kristiane

2. Kisha

27 -72

DISIPLINA E KISHËS ËSHTË THEMELORE PËR TË NDËRTUAR NJË KISHË TË SHËNDETSHME.

Pra, si e ushtrojmë saktësisht disiplinën e kishës?

Jonathan Leeman na ndihmon të përballemi me shumëllojshmërinë e pafundme të rrethanave dhe mëkateve për të cilat nuk ka asnjë rast studimor shkrimor, mëkate që nuk shfaqen në asnjë listë dhe kanë nevojë për një kuadër biblik për t'u korrigjuar me dashuri ashtu siç duhet.

Këtu kemi një udhëzues bashkëkohor dhe të përmbledhur që paraqet një kornizë teologjike për të kuptuar dhe zbatuar masat disiplinore në kishën vendore, së bashku me disa shembuj të situatave të jetës reale dhe përgjigjet përkatëse.

“Nga ana ekzegjetike i saktë, ka lidhje të natyrshme me praktikën dhe është i mbushur me raste studimore të jetës reale se si duhet të merren kishat me një shumëllojshmëri të gjerë situatash. Shumë i rekomanduar!”

CRAIG BLOMBERG, Profesor i nderuar i Dhiatës së Re, Denver Seminary

“Ky libër është një vepër teologjike e jashtëzakonshme, e pashoqe në llojin e vet. Unë besoj se kjo do të jetë vepra përcaktuese mbi disiplinën e kishës dhe pleqtë tanë po planifikojnë ta përdorin këtë libër si udhërrëfyesin tonë”.

J. D. GREER, Pastor kryesor, The Summit Church, Durham, North Carolina

JONATHAN LEEMAN (MDiv, Southern Baptist Theological Seminary) është anëtar në kishën *Capitol Hill Baptist* në Uashington, DC, dhe autor i *The Church and the Surprising Offense of God's Love*. Ai shërben edhe si drejtor i redaktimeve për *9Marks Ministries* dhe është redaktor i buletinit elektronik të tyre.

*Ky vëllim është pjesë e serisë “Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme” nga shërbesa “9Marks”.

